

VËLLIMI XXVI /KORRIK-SHTATOR/ 2024

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2024**

BULETINI ZYRTAR



PËRMBAJTJA

Nr.1090, Datë 01.07.2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË MEGAPHARMA SHPK NGA SHOQËRIA T-MEDSS SHPK, Z.ROBERT ÇINA DHE ZNJ.MONIKA HAMZARAJ”.

Nr.1091, Datë 01.07.2024

"PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E PRODHIMIT DHE SHITJES SË CIMENTOS GRI DHE TË BARDHË DHE GJOBITJEN E NDËRMARRJES ANTEA CEMENT SHA PËR ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE".

Nr.1092, Datë 11.07.2024.....

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, HONEST BEER SHPK, NGA ORTAKËT THEMELUES TË SAJ, Z.SOKOL KRAJA DHE Z.ADNAN HOXHA".

Nr.1093, Datë 11.07.2024.....

"MBI MIRATIMIN E UDHËZUESIT "PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.9121/2003 "PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS" PËR MARRËVESHJET KOLEKTIVE NË LIDHJE ME KUSHTET E PUNËS SË PERSONAVE TË VETËPUNËSUAR ".

Nr.1094, Datë 11.07.2024.....

"PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME POGRADEC SH.A".

Nr.1095, Datë 11.07.2024.....

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, NGA SHOQËRITË GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA DHE ALB-STAR SHPK".

Nr.1096, Datë 11.07.2024.....

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET SHITBLERJES SË 34% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË GRABOVA HYDROPOWER SHPK, NGA SHOQËRIA GJOKA KONSTRUKSION SHA".

Nr.1097, Datë 11.07.2024

"PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA DHE GJOKA KONSTRUKSION SHA, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQËNDRIMIT TË REALIAZUAR NËPËRMJET SHITBLERJES SË 34% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË GRABOVA HYDROPOWER SHPK, NGA SHOQËRIA GJOKA KONSTRUKSION SHA".

Nr.1098 Datë 29.07.2024.....

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQËNDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L. NGA SHOQËRITË VIKKA VTTI S.P.A. DHE SNAM S.P.A".

Nr.1099, Datë 29.07.2024.....

"KËRKESË PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT NGA ANA E NDËRMARRJES ARLIS ADMINISTRIM SHPK".

Nr.1100, Datë 29.07.2024.....

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQËNDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DS SMITH PLC NGA SHOQËRIA INTERNATIONAL PAPER COMPANY".

Nr.1101, Datë 29.08.2024.....

"PËR VAZHDIMIN E PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR MIDIS SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR KARTONIN JESHIL".

Nr.1102, Datë 29.08.2024.....

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQËNDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË CURA DOMO HOLDING GMBH NGA SHOQËRIA MAVIE NEXT GMBH".

Nr.1103, Datë 29.08.2024.....

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQËNDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË IMMEDICA PHARMA HOLDING AB NGA SHOQËRITË KKR DHE IMPLO NO 4 AB".

Nr.1104 Datë 29.08.2024.....

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQËNDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SEASIDE RESIDENCE V SHPK NGA SHOQËRIA BOLV-OIL SHA".

Nr.1105, Datë 29.08.2024.....

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQËNDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË

KONTROLLIT TË SHOQËRISË VITA RES DOO NGA SHOQËRIA RAUCH FRUCHTSAFTE GMBH".

Nr.1106, Datë 06.09.2024.....

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË PR-TELECOM TÁVKÖZLÉSI KERESKEDELMÍ ÉS SZOLGÁLTATÓ ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG DHE FILIALIT TË SAJ PR-WORK KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA "ANTENNA HUNGÁRIA" MAGYAR MŰSORSZÓRÓ ÉS RÁDIÓHÍRKÖZLÉSI ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG".

Nr.1107, Datë 06.09.2024

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË EDISON STOCAGGIO SPA NGA SHOQËRIA SNAM S.P.A".

Nr.1108, Datë 16.09.2024

"MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT "PËR REFERIMIN E ÇËSHTJEVE NË LIDHJE ME PËRQENDRIMET".

Nr.1109, Datë 16.09.2024

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË MARCEGAGLIA STEEL S.P.A DHE MANNI GROUP S.P.A".

Nr.1110, Datë 20.09.2024

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË GERMANI S.P.A DHE FILIALIT TË SAJ TRANSPORTI VECCHI ZIRONI S.R.L NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A DHE MEGRANI S.R.L".

Nr.1111, Datë 20.09.2024

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, ECO CLEANING SHPK, NGA ORTAKËT THEMELUES TË SAJ SHOQËRITË ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCCION SHPK DHE 2 T SHPK".

Nr.1112, Datë 20.09.2024

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË NSOLUTION SHPK NGA Z.ERMAL BEQIRI".

VENDIM

Nr. 1090, Datë 01 .07. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË MEGAPHARMA SHPK NGA SHOQËRIA T-MEDSS SHPK, Z. ROBERT ÇINA DHE ZNJ. MONIKA HAMZARAJ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01. 07. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë MEGAPHARMA SHPK nga shoqëria T-MEDSS SHPK, Z. Robert Çina dhe Znj. Monika Hamzaraj.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë MEGAPHARMA SHPK nga shoqëria T-MEDSS SHPK, Z. Robert Çina dhe Znj. Monika Hamzaraj.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë MEGAPHARMA SHPK nga shoqëria T-MEDSS SHPK, Z. Robert Çina dhe Znj. Monika Hamzaraj.

Referuar dokumentit “Kontratë për shitjen e kuotës”, nënshkruar më datë [.....], palët në marrëveshje janë:

Blerësi: T-MEDSS SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me ortak të vetëm Z.Sokol Ramizi dhe me objekt aktiviteti: tregtim i aparateve dhe pajisjeve mjekësore, laboratorike dhe spitalore; tregtim dhe instalim i sistemeve kompjuterike, elektronike dhe pajisjeve të tjera të automatizimit.

Shoqëria T-MEDSS SHPK gjithashtu, zotëron 50% të kuotave në shoqërinë LABOPHARMA SHPK, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregti import-eksport i produkteve farmaceutike, etj.

Z.Sokol Ramizi rezulton ortak në shoqërinë IBA SHPK, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me 50% të kapitalit. Shoqëria vepron si konsulent, këshilltar, zhvillues dhe tregtar i programeve dhe sistemeve kompjuterike, importon/eksporton paketat e programeve kompjuterike, sistemet e komunikimeve elektronike, sistemet e publikimit dhe përpunimit të të dhënave, sistemet industriale dhe pajisjet e tjera të automatizimit; zotëron, administron dhe drejton qendra të përpunimit të të dhënave kompjuterike dhe analiza statistikore.

Target : MEGAPHARMA SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: import-eksport, ri-eksport, ruajtje, shpërndarje, shitje me shumicë dhe pakicë të artikujve farmaceutik dhe para farmaceutik, produkteve ushqimore me origjinë shtazore, shtesave ushqimore dhe produkteve bimore, produkteve kozmetike, produkteve për mjekësi estetike, bimëve medicinale, barnave narkotike dhe psikotrope, pajisjesh mjekësore, dhe laboratorike, reagjentëve dhe kiteve, pajisjeve dhe materialeve laboratorike dentare, të licencuara nga organet e tjera kompetente në rastet kur kërkohet, detergjent, dezinfektant; servis dhe mirëmbajtje pajisjesh mjekësorë, pajisjesh dentare; dhënie me qera zyresh dhe ambientesh; çdo aktivitet ndihmës në përputhje me legjislacionin shqiptar i cili i shërben aktivitetit të saj kryesor.

Para transaksionit, shoqëria zotërohej me kuota të njëjta nga dy ortakët e saj, Z. Robert Çina dhe Znj. Monika Hamzaraj.

Shitësit:

Z. Robert Çina është person fizik, i cili zotëronte 50% të kuotave të shoqërisë target. Pas realizimit të shitjes nga ana e tij të 15% të kapitalit të shoqërisë target, është zotërues i 35% të kapitalit në shoqërinë MEGAPHARMA SHPK.

Znj. Monika Hamzaraj është person fizik, e cila zotëronte 50% të kuotave të shoqërisë target. Pas realizimit të shitjes nga ana e saj të 15% të kapitalit të shoqërisë target, është zotëruese e 35% të kapitalit në shoqërinë MEGAPHARMA SHPK.

II. Transaksioni

Më datë [.....], është nënshkruar “Kontratë për shitjen e kuotës”, ndërmjet shoqërisë T-MEDSS SHPK në cilësinë e blerësit dhe Z. Robert Çina dhe Znj. Monika Hamzaraj në cilësinë e shitësit, lidhur me shit-blerjen e kuotës që përfaqëson 30% të kapitalit bazë të shoqërisë target MEGAPHARMA SHPK.

Objekti i kësaj marrëveshje është përcaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave të transaksionit mbi shitjen 30% të secilës prej Kuotave, e cila përfaqëson pjesëmarrje në 15% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale prej ALL 60.000 secila, që secili prej shitësve zotëron në shoqërinë MEGAPHARMA SHPK në favor të blerësit, kundrejt çmimit total prej EUR 4,610,000, sipas kushteve, afateve dhe modaliteteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Referuar Nenit 3, “Kalimi i Pronësisë mbi Kuotën”, palët bien dakord se pronësia e blerësit mbi kuotën kalon menjëherë në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, duke u bërë menjëherë zotërues i 1(një) kuote, e cila do të përfaqësojë 30% të kapitalit bazë të shoqërisë MEGAPHARMA SHPK.

Kapitali bazë i shoqërisë MEGAPHARMA SHPK zotërohet nga 3(tre) ortakë:

- Ortaku Robert Çina është zotërues i një kuote, e cila përfaqëson 35% të kapitalit bazë të shoqërisë;
- Ortaku Monika Hamzaraj është zotëruese e një kuote, e cila përfaqëson 35% të kapitalit bazë të shoqërisë;
- Ortaku shoqëria T-MEDSS SHPK është zotëruese e një kuote, e cila përfaqëson 30% të kapitalit bazë të shoqërisë.

Referuar Ekstraktit të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, shoqëria MEGAPHARMA SHPK ka regjistruar ndryshimet si pasojë e kontratës për shitjen e kuotës me T-MEDSS SHPK dhe aktualisht ka një numër të përgjithshëm prej 3(tre) kuotash të zotëruara nga ortakët Z. Robert Çina, Znj. Monika Hamzaraj dhe T-MEDSS.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shitjes së barnave. *Treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i shitjes së barnave funksionon në zbatim të ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar. Ndërmarrjet që operojnë në prodhimin / tregtimin e barnave mjekësore pajisjen me Licenca profesionale për subjektet farmaceutike (fabrika, importues dhe tregtues me pakicë) për ushtrimin e veprimtarive respektive (fabrikim barnash, tregti me shumicë, farmaci) për barnat narkotike, psikotrope.

Oferta në treg për barna sigurohet nga prodhuesit vendas të barnave, si dhe nga ndërmarrjet importuese, për barna të prodhuara jashtë vendit. Tregtimi realizohet nëpërmjet shitësve me shumicë (importues/ depo primare dhe shpërndarës/depo sekondare) dhe shitës me pakicë (farmaci dhe agjenci të rrjetit të hapur).

Mbështetur në legjislacionin në fuqi, çmimi i shitjes së barnave, në të gjitha nivelet e tregimit, është i rregulluar dhe çmimi i shitjes me pakicë është i përcaktuar në pullën që i bashkëngjitet paketimit të barit.

Pas analizës së të dhënave të doganës për vitin 2022 mbi vlerën e barnave të importuara, rezultoi se importi i barnave realizohet nga një numër shumë i madh ndërmarrjesh importuese, (rreth 140 subjekte).

Ndërmarrjet me vlerën më të madhe të importit të barnave janë “Rejsi Farma” me 16.81 % të tregut, “Delta Pharma- AL” me 12.88 % dhe “Intermed” me 11.48%. Shoqëria MEGAPHARMA SHPK zotëron 6.45% në vlerën e barnave të importit.

Referuar palëve në transaksion si dhe shoqërive të lidhura me to, rezulton se shoqëria MEGAPHARMA SHPK ka realizuar të ardhura nga shitja me shumicë e barnave të importuara, si dhe është e integruar në tregun e shitjes me pakicë, nëpërmjet kuotave që ortakët e saj zotërojnë në shoqërinë Orange Farmaci SHPK.

Shoqëria T-MEDSS SHPK është e licencuar për tregtim të aparateve dhe pajisjeve mjekësore, laboratorike e spitalore, por nuk ka patur aktivitet dhe nuk ka realizuara të ardhura gjatë vitit 2022.

Nga të dhënat e DPD, na rezulton se shoqëria e kontrolluar nga T-MEDSS, Labopharma SHPK, gjatë vitit 2022 nuk ka realizuar importe të barnave, duke mos ndikuar në pjesën e tregut të shoqërisë target.

Shoqërinë IBA SHPK operon në një treg të ndryshëm nga ai i shoqërisë Target, duke mos patur për pasojë mbivendosjen e pjesëve të tregut.

Nga analiza e mësipërme, konstatohet se përqendrimi mund të krijojë mbivendosje tregjesh në nivelin e importit dhe shitjes me shumicë të barnave midis aktivitetit ekonomik të shoqërisë target dhe shoqërisë Labopharma SHPK, por pa konstatuar efekte për vitin 2022. Pjesa e vogël e tregut të shoqërisë target si dhe karakteristikat e strukturës së importit të barnave, pritet të mos sjellin efekte të ndjeshme për konkurrencën në këtë treg.

Shoqëria T-MEDSS, si dhe shoqëritë e kontrolluara prej saj nuk ushtrojnë aktivitet në tregun e

shitjes me pakice të barnave dhe për pasojë nuk do të ndikojë në pjesën e tregut të zotëruar nga shoqëria Orange Farmaci SHPK, në shitjen me pakicë.

Në tregun e shitjes me pakicë të barnave nuk do të krijohet mbivendosje midis aktiviteteve të palëve (blerës dhe target) në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në strukturat e tregut.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë MEGAPHARMA SHPK nga shoqëria T-MEDSS SHPK, Z. Robert Çina dhe Znj. Monika Hamzaraj.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1091, Datë 01. 07.2024

"PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E PRODHIMIT DHE SHITJES SË ÇIMENTOS GRI DHE TË BARDHË DHE GJOBITJEN E NDËRMARRJES ANTEA CEMENT SHA PËR ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01. 07. 2024 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë”.

Bazë ligjore: Neni 4 dhe 9, neni 24, shkronja d), neni 26, neni 43, pika 5, neni 74, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

1. Raportit mbi hetimin e thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë;
2. Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit të thelluar;
3. Pretendimet/shpjegimet e dhëna nga ndërmarrja Antea Cement SHA në seancën dëgjimore të zhvilluara pranë AK-së më datë 17/04/2024, si dhe të paraqitura me shkrim, në vijim të seancës dëgjimore me anë te shkresës nr. 89/5 prot., datë 17.04.2024, protokolluar pranë AK me nr. 235/5 prot., datë 17.04.2024, me lëndë, “Dorëzim dokumentacioni në shqip dhe anglisht në lidhje me argumentat e parashtruar nga ANTEA CEMENT SH.A gjatë seancës dëgjimore të datës 17.04.2024”;
4. Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi pretendimet e paraqitura me shkrim nga ndërmarrja: Antea Cement SHA në lidhje me seancën dëgjimore të realizuar më datën 17.04.2024.

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, gjatë vitit 2022 ka monitoruar tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit, shtrebbërimit apo pengimit të konkurrencës në këtë treg.
2. Komisioni i Konkurrencës, në përfundim të këtij monitorimi, me Vendimin nr. 895, datë 05.07.2022, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.
3. Referuar konkluzioneve të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 969, datë 24.03.2023, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë, për periudhën kohore nga 1 Janari 2019 deri në 31 Mars 2023.
4. Në vazhdim të procedurës, në zbatim të vendimit nr. 969, datë 24.03.2023 të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 468/18, datë 18.07.2022 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit të thelluar proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos.
5. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, gjatë periudhës së hetimit të thelluar janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003, zhvilloi më datë 17.04.2024 seancën dëgjimore me përfaqësues të ndërmarrjes Antea Cement SHA. Prapësimet e paraqitura nga ndërmarrja Antea Cement SHA në seancë dëgjimore, si dhe të paraqitura me shkrim në vijim të kësaj seance, janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës në marrjen e këtij vendimi.

II. RREGULLIMI LIGJOR I TREGUT

7. Ndërmarrjet të cilat kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në prodhimin e çimentos në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në

Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të pajisen me leje përkatëse minerare për shfrytëzimin e mineraleve ndërtimore të cilët përdoren si lëndë e parë për prodhimin e çimentos. Leja minerare jepet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në përputhje me ligjin nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, sipas procedurës së konkurrimit publik, për zonat e publikuara, sipas programit të veprimit dhe planit vjetor minerar dhe/apo shqyrtimit të plotësimit të kushteve të lejimit për zonat e hapura, sipas procedurës “I pari në kohë, i pari në të drejta”.

8. Gjithashtu prodhuesit dhe importuesit e çimentos në Shqipëri duhet të pajisen me leje mjedisore për instalimet e tyre të cilat mund të ndikojnë në shkarkimet dhe ndotjen tej normave të lejuara të mjedisit. Kushtet e dhënies së lejeve mjedisore janë përcaktuar në ligjin nr. 10 448, datë 14.07.2011, “Për lejet e mjedisit” .
9. Ndërmarrjet të cilat kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit të çimentos ndeshen me barriera të larta ligjore në hyrje, pasi për tu pajisur me leje përkatëse minerare për shfrytëzimin e mineraleve ndërtimore të cilët përdoren si lëndë e parë për prodhimin e çimentos, këto ndërmarrje duhet ti nënshtohen procedurës së konkurrimit publik (prokurim publik/ koncesion), për zonat e publikuara, sipas programit të veprimit dhe planit vjetor minerar; dhe/apo shqyrtimit të plotësimit të kushteve të lejimit për zonat e hapura, sipas procedurës “I pari në kohë, i pari në të drejta”.
10. Leja e shfrytëzimit e grupit të mineraleve ndërtimore ka afat vlefshmërie jo më të gjatë se 25 vjet nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe me të drejtë shtyrjeje, deri në 10 vjet, me kusht që kjo shtyrje afati të kërkohet nga zotëruesi i lejes, të paktën, 180 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë. Afati i aplikimit është preskluziv dhe, me kalimin e këtij afati, zotëruesi i lejes minerare humbet të drejtën e aplikimit për shtyrje të afatit të lejes së shfrytëzimit. Me kërkesë të subjektit kërkues apo të zotëruesit të lejes së shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore dhe nëse paraqitet një plan investimesh, zbatimi i të cilit vlerësohet me interes ekonomik apo shoqëror, kombëtar ose lokal, leja mund të jepet apo, përkatësisht, të zgjatet për një periudhë vlefshmërie deri në 99 vjet. Në këto raste ministri mund të negociojë një kontratë me kushte lehtësuese me kërkuesin apo zotëruesin e lejes minerare, dhe kontrata e shtyrja e afatit do të paraqiten për miratim në Kuvend.

III. ANALIZA E KONKURRENCËS

11. Metodologjia e përdorur në këtë hetim është realizuar në vijim të metodologjisë Strukturë-Sjellje-Performancë, Udhëzimi i AK “Mbi zbatueshmërinë e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës”, rasteve me të mira europiane të Autoriteve të ndryshme të konkurrencës dhe praktikave të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED).

III.1 Tregu përkatës

12. Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
13. Bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121/2003 dhe Udhëzimin nr. 76, datë 07.06.2008, “Për përcaktimin e Tregut Përkatës”, Tregu përkatës i produktit përcaktohet si: *“Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre”*.
14. Çimento mund të ndahet në dy lloje sipas destinacionit final të përdorimit:
 - *Çimento e bardhë* – ka në përmbajtjen e saj gëlqere dhe sasi të vogël hekuri dhe gips. Kjo lloj çimento përdoret për punë arkitekturore, për fasada apo skulptura;
 - *Çimento gri* – ka në përmbajtjen e saj klinker. Kjo lloj çimento është më e përdorur në ndërtim apo kryesisht në prodhimin e betonit. Çimento gri është e ndarë në disa klasa, duke filluar nga 32.5R, 42.5R dhe 52.5R.
15. Për sa i përket zëvendësueshmërisë në kuptim të *kërkesës*, llojet e çimentos gri dhe e bardhë kanë në përbërje të tyre elementë të ndryshëm, kanë përdorim të ndryshëm, si dhe kanë diferenca të konsiderueshme në çmim dhe për këto arsye nuk mund të zëvendësojnë njëri – tjetrin për nga funksioni që kryejnë. Produktet çimento që prodhohen, importohen dhe tregtohen, pra llojet e ndryshme të çimentos, janë homogjene midis ndërmarrjeve të ndryshme. Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e *ofertës* mund të themi se ndërmarrjet importuese mund të importojnë secilin nga llojet e çimentos, pra në import produktet çimento e bardhë dhe çimento gri janë të zëvendësueshëm nga ana e ofertës, pasi shitësit me shumicë të këtyre produkteve mund të importojnë secilin nga këto produkte. Ndërmarrjet prodhuese në vendin tonë prodhojnë vetëm çimento gri, ndërsa çimento e bardhë sigurohet vetëm nga importi. Tregu i importit është një treg i lirë për ndërmarrjet që importojnë çimento, pasi nuk ka barriera në hyrje.
16. Nga të dhënat e ndërmarrjeve rezulton se sasia e çimentos gri e marrë në analizë në tregun përkatës, përkatësisht çimento 32.5 R me thasë, çimento 42.5 R me thasë, çimento 42.5 R rifuxho, dhe çimento 52.5 R rifuxho, zë nga 97-100% të sasisë totale të shitur nga secila nga ndërmarrjet brenda vendit për vitet 2019-2022. Referuar pjesës që zë çimento gri 32.5R me thasë, çimento gri 42.5R me thasë, çimento gri 42.5R rifuxho, çimento gri 52.5 Rrifuxho, çimento e bardhë 52.5 me thasë dhe çimento e bardhë 52.5R rifuxho ndaj sasisë totale të çimentos që ofrojnë ndërmarrjet në treg, për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve

që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, tregu përkatës në këtë rast është tregu i importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri, i ndarë në nën tregje sipas produkteve:

- Nën tregu i importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento gri 32.5 R me thasë;
- Nën tregu i importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento gri 42.5 R me thasë;
- Nën tregu i importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento gri 42.5 R rifuxho;
- Nën tregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento gri 52.5 R rifuxho; si dhe
- Tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos së bardhë, i ndarë në nëntregje:
- Nën tregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento e bardhë 52.5 R me thasë;
- Nën tregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento e bardhë 52.5 R rifuxho.

17. Prodhimi, importi dhe shitja me shumicë e produktit çimento realizohet nga ndërmarrje, të cilat e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Pra, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

III.2 Struktura e tregut

18. Në tregun e çimentos në Shqipëri operojnë katër ndërmarrje prodhuese që janë: Antea Cement SHA, Elbasan Cement Factory SHPK, Fushe Kruja Cement Factory SHPK dhe Colacem Albania SHPK si dhe dy ndërmarrje importuese të produktit, përkatësisht ndërmarrjet: Eurotech Cement SHPK dhe Bërdica Cement SHPK.

19. Për sa i përket kapacitetit prodhues, për periudhën hetimore ndërmarrja Antea Cement SHA ka shfrytëzuar mbi xxx të kapacitetit prodhues, Colacem Albania ka shfrytëzuar mbi xxx të kapacitetit prodhues, ndërsa ndërmarrjet Fushë Kruja Cement SHPK dhe Elbasan Cement SHPK, për vitin 2021 vërehet se kanë një rënie të sasisë së prodhuar e cila reflektohet dhe në rënien e shfrytëzimit të kapacitetit prodhues në xxx. Ulja e sasisë së prodhuar nga ndërmarrjet Fushë Kruja Cement SHPK dhe Elbasan Cement SHPK reflektohet dhe në rënien e treguesit të shfrytëzimit të kapacitetit prodhues, i cili për vitin 2022 paraqitet xxx në total për të gjithë ndërmarrjet e prodhimit.

20. Nga të dhënat mbi sasinë totale të importuar dhe prodhuar të produktit çimento gri vërehet se importi i çimentos gri zë një pjesë shumë të vogël ndaj sasisë së prodhuar në vend (përfshirë sasinë e eksportuar) për çimento. Për vitin 2019, importi i çimentos gri zë rreth 5.5% të sasisë totale të prodhuar në vend. Për vitin 2020 sasia e importuar e çimentos është dyfishuar duke arritur në 11%. Për 2021 importi i çimentos gri zë rreth 7 % të sasisë totale të prodhuar, ndërsa për vitin 2022 importi i çimentos gri zë rreth 11% të sasisë totale të prodhuar.

21. Për të gjithë periudhën hetimore për produktin çimento gri ndërmarrja Eurotech Cement realizon pjesën më të madhe të importeve, e cila varion për vitin 2019 në xxx të importeve dhe për vitin 2022 në xxx. Gjatë kësaj periudhe vihen re hyrje të reja në importe të realizuar për këtë produkt si Bërdica Cement SHPK me rreth xxx dhe në vitin 2022 ndërmarrja Salillari SHPK ka arritur rreth xxx të importeve. Çimento gri e importuar zë xxx të kërkesës totale për çimento. Përgjatë gjithë periudhës hetimore, rreth xxx e çimentos gri importohet nga Turqia ku ndërmarrja Eurotech Cement importon rreth xxx dhe ndërmarrja Bërdica Cement importon rreth xxx të sasisë totale të importuar nga ky vend. Rreth xxx importohet nga Greqia ku ndërmarrja Eurotech Cement importon xxx të sasisë dhe më pak se xxx importohet nga Tunizia, Kosova dhe Mali i Zi nga ndërmarrjet e tjera në treg.
22. Çmimi mesatar i importit për çimenton gri pëson një rritje të menjëhershme në muajin mars 2022 dhe ka disa luhatje përgjatë kësaj periudhe deri në muajin nëntor 2022. Gjithsesi edhe pse çmimi CIF është rritur ka një rritje të konsiderueshme edhe të sasisë së importuar.
23. Sa i përket importeve sasia totale e importuar e çimentos së bardhë zë një pjesë shumë të vogël krahasuar me çimenton gri të prodhuar dhe importuar në vendin tonë. Për të gjithë periudhën hetimore kjo pjesë varion 4% deri në 4.5% të kërkesës totale për çimento. Përgjatë periudhës hetimore, rreth 89% e sasisë së çimentos së bardhë importohet nga Turqia ku ndërmarrja xxx zotëron një pjesë tregu të qëndrueshme prej xxx ndër vite. Gjithashtu çmimi mesatar i importit për çimenton e bardhë ka luhatje të dukshme përgjatë periudhës hetimore por trendi i çmimit vjen në rritje për vitin 2022-2023.
24. Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit, për vitin 2019 sasia e importuar e klinkerit është rreth 157,050 Ton, për vitin 2020 është 161,030 TON, për vitin 2021 është 180,185 TON, për vitin 2022 është 227,266 TON nga të cilat rreth xxx importohen nga ndërmarrja xxx, ndërsa për 3 muajorin e parë të vitit 2023 është rreth 65,160 TON nga të cilat vetëm xxx importohen nga ndërmarrja xxx dhe xxx nga ndërmarrja Antea Cement SHA. Çmimi mesatar i importit për Klinkerin pëson një rritje të konsiderueshme në muajin shkurt 2022 dhe në vazhdim.
25. Si dhe vihet re, vitet e fundit një valë e re ndërtimi ka nisur në vend që nga procesi i rindërtimit dhe shtimi të lejeve të ndërtimit, sidomos në kryeqytet. Sipas të dhënave të INSTAT, sipërfaqja e lejeve të ndërtimit të dhëna në Tiranë për banesa, shënoi një rritje të shpejtë duke filluar nga viti 2017, duke arritur në 2019-n, në më shumë se 1 milionë metra katror, niveli më i lartë që nga viti 2005. Në 2020-n, sipërfaqja e dhënë për leje ndërtimi për banesa shënoi një rënie prej gati 10% në raport me 2019-n, por sërish mbeti pranë niveleve më të larta. I njëjti konstatim vjen dhe si rezultat i rritjes së sasisë së çimentos se importuar dhe prodhuar. Studime të ndryshme konstatojnë se kërkesa për çimento është shumë joelastike ndaj çmimit pasi lidhet me ciklet ekonomike dhe industrinë e ndërtimit.

26. Në vitin 2019: çimento 42.5 R rifuxho ka qenë produkti më i shitur me një përqindje prej 55% të totalit të shitjeve, e ndjekur nga çimento 32.5 R me thasë me 33% të shitjeve. Ndërkohë, çimento 42.5 R me thasë dhe llojet e tjera të çimentos kishin përqindje më të ulët, përkatësisht 8% dhe 4%.
27. Për vitin 2020 çimento 42.5 R rifuxho vazhdoi të mbante pozicionin e saj si produkti më i shitur, por përqindja e saj u rrit në 56%, e ndjekur nga çimento 32.5 R me thasë me 30% të shitjeve, çimento 42.5 R me thasë dhe llojet e tjera të çimentos shënuan përqindje më të ulëta krahasuar me vitin e mëparshëm, me respektivisht 9% dhe 5%.
28. Për vitin 2021, çimento 42.5 R rifuxho vazhdoi të mbante pjesën më të madhe të tregut me një rritje në 62% të shitjeve, Përqindja e çimento 32.5 R me thasë u ul në 26%. Llojet e tjera të çimentos dhe çimento 42.5 R me thasë ruajtën përqindjet e tyre nga viti i kaluar.
29. Në vitin 2022 çimento 42.5 R rifuxho vazhdon të jetë produkti më i shitur duke rritur pjesën e tregut në 68%. Çimento 32.5 R me thasë pësoi një rënie në 21% të shitjeve. Për llojet e tjera të çimentos dhe çimento 42.5 R me thasë, përqindjet ruajtën përafërsisht të njëjta përqindje si vitin e kaluar.
30. Për periudhën janar - mars 2023, trendi vazhdon me çimenton 42.5 R rifuxho që mbetet produkti më i shitur me 67% të shitjeve.
31. Për periudhën hetimore, për sa i përket nëntregut të çimentos gri 32.5R me thasë, vërehet se operojnë 4 ndërmarrje ku ndërmarrja xxx zotëron mbi xxx të tregut, ndërmarrja xxx me xxx të tregut, ndërmarrja xxx për vitet 2019 – 2021 ka zotëruar xxx të tregut, ndërsa në vitin 2022 ka pësuar ulje për sa i përket pjesës së tregut në xxx. Ndërmarrja Elbasan Cement zotëron xxx të tregut.
32. Referuar indeksit të përqendrimit HHI rezulton se nëntregu i prodhimit dhe shitjes së produktit çimento gri 32.5R me thasë është një treg shumë i përqendruar, për faktin se janë vetëm 4 ndërmarrje të cilat prodhojnë këtë produkt. HHI për vitet 2021-2022 paraqet një nivel shumë të përqendruar tregu (HHI për vitin 2021 është 4,188 dhe për vitin 2022 është 4,695), tregues i cili përgjatë gjithë periudhës hetimore mbetet shumë i lartë, pasi dhe numri i ndërmarrjeve në këtë treg është shumë i vogël dhe i pandryshuar. Në lidhje me treguesit (CR3; CR4), vërehet se pesha specifike e tre dhe katër ndërmarrjeve më të mëdha në këtë treg është përkatësisht rreth 95 % dhe 100%. Pra treguesi i fuqisë së tregut të 3 ndërmarrjeve më të mëdha mbetet i njëjtë për të gjithë periudhën hetimore si pasojë e numrit të vogël të ndërmarrjeve të cilat zotërojnë këtë treg.
33. Për periudhën hetimore, për sa i përket nëntregut të çimentos gri 42.5R me thasë, vërehet se operojnë 6 ndërmarrje ku ndërmarrja xxx zotëron mbi xxx të tregut, ndërmarrja xxx me xxx të tregut, ndërmarrja xxx për vitet 2019 – 2021 ka zotëruar afërsisht xxx të tregut, ndërsa në vitin

2022 ka pësuar ulje për sa i përket pjesës së tregut në xxx. Ndërmarrjet e tjera zotërojnë një pjesë më të vogël se xxx të tregut.

34. Nëntregu i prodhimit dhe shitjes së produktit çimento gri 42.5R me thasë është një treg shumë i përqendruar, për faktin se janë vetëm një numër i vogël ndërmarrjesh të cilat prodhojnë këtë produkt. HHI për vitet 2021-2022 paraqet një nivel shumë të përqendruar tregu (HHI për vitin 2021 është 4,081 dhe për vitin 2022 është 4,730), tregues i cili përgjatë gjithë periudhës hetimore mbetet shumë i lartë, pasi dhe numri i ndërmarrjeve në këtë treg është shumë i vogël dhe i pandryshuar. Në lidhje me treguesit e fuqisë së tregut të 3 ose me shumë ndërmarrjeve, për vitin 2019 vërehet se 3 prej ndërmarrjeve zotërojnë rreth 97-99% të tregut të prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri 42.5R me thasë tregon një treg me shkallë të lartë përqendrimit, tregues të cilët janë në të njëjtat nivele për të gjithë periudhën hetimore.
35. Për periudhën hetimore, për sa i përket nëntregut të çimentos gri 42.5R rifuxho, vërehet se operojnë 6 ndërmarrje. Gjatë viteve 2019 – 2020, ndërmarrja xxx zotëron pjesën më të madhe të tregut të shitjes me mbi xxx, në vitin 2021 ndërmarrja xxx zë rreth xxx të tregut, ndërsa ndërmarrja xxx zë rreth xxx të tregut. Në vitin 2022, ndërmarrja xxx zë rreth xxx të tregut, ndërsa ndërmarrja xxx ka pësuar ulje për sa i përket pjesës së tregut në xxx. Ndërmarrjet xxx, xxx, xxx, kanë pësuar rritje të pjesëve të tregut për vitet 2019 – 2022, duke zënë deri xxx të tregut.
36. Nëntregu i prodhimit dhe shitjes së produktit çimento gri 42.5 R rifuxho është një treg shumë i përqendruar, për faktin se janë vetëm një numër i vogël ndërmarrjesh të cilat prodhojnë këtë produkt. HHI për vitet 2021-2022 paraqet një nivel shumë të përqendruar tregu (HHI për vitin 2021 është 3,165 dhe për vitin 2022 është 3,112), tregues i cili përgjatë gjithë periudhës hetimore mbetet shumë i lartë, pasi dhe numri i ndërmarrjeve në këtë treg është shumë i vogël dhe i pandryshuar. Në lidhje me treguesit e fuqisë së tregut të 3 ose me shumë ndërmarrjeve, për vitin 2019 vërehet se 3 prej ndërmarrjeve zotërojnë rreth 97-99%% të tregut të prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri 42.5 R rifuxho tregon një treg me shkallë të lartë përqendrimit, tregues të cilët janë në të njëjtat nivele për të gjithë periudhën hetimore.
37. Referuar strukturës dhe përqendrimit të tregut sipas produkteve çimento 32.5 R me thasë, 42.5 R me thasë dhe 42.5R rifuxho, konstatohet se tregu i shitjes me shumicë të çimentos paraqitet me karakteristikat e një tregu oligopolistik, ku operojnë një numër i vogël ndërmarrjesh (4-6 ndërmarrje), produkti është homogjen dhe treguesit e përqendrimit janë të lartë përgjatë gjithë periudhës hetimore.
38. Sa më sipër konstatohet se struktura e tregut të prodhimit dhe shitjes së çimentos gri ka karakteristika e një tregu oligopol si: numër i vogël ndërmarrjesh, barriera të larta për hyrje, fuqi të vendosjes së çmimeve nga një ndërmarrje me pozitë dominuese e cila mund të luajë rolin e një lideri dhe ndërvarësia e firmave për të përshtatur sjelljen e tyre si ndjekës të liderit.

Nivelet e larta të përqendrimit dhe barrierat në hyrje në tregjet oligopol nënkuptojnë se ndërmarrjet mund të aplikojnë përqendrim të njëanshëm të fuqisë në treg (unilateral market power). Fuqia e njëanshme e tregut dhe niveli i lartë i përqendrimit të tregut nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me pozicionin e një ndërmarrje të vetme. Një treg me një numër të vogël ndërmarrjesh të cilat mbrohen nga barrierat e larta në hyrje (një treg oligopol), mund të karakterizohet nga fuqia e konsiderueshme e tregut. Një mekanizëm me të cilin kjo fuqi tregu (unilateral market power) mund të shfaqet është sjellja e koordinuar. Megjithatë, fuqia e njëanshme e tregut mund të gëzohet nga një numër ndërmarrjesh edhe kur ato veprojnë në mënyrë të pavarur, megjithëse të vetëdijshme për praninë e njëra-tjetrës — të ashtuquajturat “*oligopole të pakoordinuara*”¹.

39. Referuar strukturës dhe përqendrimit të nëntregjeve të produkteve çimento gri 32.5 R me thase, 42.5 R me thasë dhe 42.5 rifuxho, si dhe treguesit të përqendrimit HHI, tregu i shitjes me shumicë të çimentos gri ka karakteristikat e një tregu oligopolistik.

III.3 Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve

40. Gjatë procedurës së hetimit, një nga pjesët kryesore të evidentimit të ndonjë shkelje të pretenduar të ndërmarrjeve, është dhe realizimi i inspektimeve të njëkohshme (të befasishme). Inspektimet down raids u realizuan në të njëjtën kohë në 4 (katër) prej ndërmarrjeve me pjesë më të mëdha tregu: Antea Cement SHA, Colacem Albania SHPK, Fushe Kruja Cement Shpk, Eurotech Cement Shpk, të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të çimentos. Në vazhdim u kryen inspektimet në ndërmarrjet e tjera që ushtrojnë veprimtari në këtë treg.
41. Gjatë realizimit të inspektimeve, u administruan të gjitha evidencat ekonomike të ndërmarrjeve si dhe u kërkua për evidenca të qarta të kohës së ndryshimit të çmimit të shitjes së produktit çimento, për të cilin u iniciua ky hetim. Në ndërmarrje u realizua dhe procesi i intervistimit të administratorëve. Pyetjet në procesverbale ishin të njëjta për të gjitha ndërmarrjet, për të pasur një koordinim në këtë proces. Në dosjen hetimore, janë administruar proces verbalet përkatëse të inspektimeve dhe intervistimit të administratorëve.
42. Në përfundim të inspektimeve u konstatua se: ndërmarrja xxx ka rritur çmimin e shitjes së produktit të çimentos në datën xxx; ndërmarrja xxx ka rritur çmimin e shitjes së produktit të çimentos në datën xxx; ndërmarrja xxx ka rritur çmimin e shitjes së produktit të çimentos në datën xxx. Ndërmarrja xxx ka rritur çmimin e shitjes së produktit të çimentos më datë xxx (menjëherë pas përfundimit të remontit të fabrikës i cili ka zgjatur xxxxxxx). Kjo sjellje e

¹ Komisioni i Konkurrencës i Britanisë së Madhe (2014) “Hetimi i tregut të çimentos dhe betonit të gatshëm” https://assets.publishing.service.gov.uk/media/552ce1d5ed915d15db000001/Aggregates_final_report.pdf

ndërmarrjeve u verifikua nga analiza e faturave të shitjes së produktit çimento të administruara nga ndërmarrjet gjatë procedurës hetimore.

43. Sa më sipër, mund të konstatojmë se ndërmarrja xxx paraqitet si një ndërmarrje lider në këtë treg dhe ndërmarrjet e tjera ndjekëse duke e rritur e para çmimin e shitjes në datën xxx dhe ndërmarrjet e tjera e kanë ndjekur këtë sjellje në vijim: xxx në datën xxx, xxx në datën xxx, dhe xxx pas përfundimit të remontit të fabrikës në datën xxx .
44. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento, janë analizuar faturat e shitjes dhe blerjes së të gjitha ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë aktivitet në këtë treg. Nga analiza e diferencës së çmimeve mesatare mujore të shitjes së çimentos gri midis ndërmarrjeve, për periudhën janar 2019 – mars 2023 konstatohet se: për produktin çimento 32.5 R e paketuar në thasë, ku nga 306 çmime të analizuar, janë identifikuar vetëm 16 raste ku çmimet kanë një diferencë më të vogël se +/- 0.5 cent, së produktit çimento 42.5 R e paketuar në thasë, ku nga 376 çmime të analizuar, janë identifikuar vetëm 17 raste, ku çmimet kanë një diferencë më të vogël se +/- 0.5 cent, produktit çimento 42.5R rifuxho , ku nga 664 çmime të analizuar, janë identifikuar vetëm 69 raste, ku çmimet kanë një diferencë më të vogël se +/- 0.5 cent. Pavarësisht se ndërmarrjet nuk kanë aplikuar çmime të përafërta ajo që vihet re nga trendi i rritjes së çmimeve është që çmimet e shitjes për produktet çimento 32.5 R e paketuar në thasë, çimento 42.5R e paketuar në thasë dhe çimento 42.5R rifuxho kanë pësuar rritje të madhe në muajin mars 2022, rritje e cila është vërehet tek të gjitha ndërmarrjet.
45. Nga krahasimi i çmimeve mesatare mujore të ndërmarrjes Antea Cement SHA me ndërmarrjet e tjera që operojnë në tregun përkatës rezulton se: për produktin çimento gri 32.5R me thasë ndërmarrja Antea Cement SHA duke filluar nga muaji mars 2022 deri më shkurt 2023, ka aplikuar çmime mesatare mujore të shitjes më të larta se ndërmarrjet e tjera; për produktin çimento gri 42.5R me thasë, pavarësisht se çmimet kanë filluar të rriten në muajin mars 2022, ndërmarrja Antea Cement SHA, për periudhën shtator 2022 deri më shkurt 2023, ka aplikuar çmime mesatare mujore të shitjes më të larta se ndërmarrjet e tjera; për produktin çimento gri 42.5R rifuxho ndërmarrja Antea Cement SHA, duke filluar nga muaji mars 2022 deri më dhjetor 2022, ka aplikuar çmime mesatare mujore të shitjes më të larta se ndërmarrjet e tjera.
46. Nga analiza e kostove mesatare të ndërmarrjeve prodhuese Antea Cement SHA, Colacem Albania SHPK, Fushë Kruja Cement SHPK dhe Elbasan Cement SHPK për produktin çimento 32.5 R me thasë dhe kostot mesatare të produkteve 42.5R me thasë dhe 42.5R rifuxho për ndërmarrjet Antea Cement SHA, Colacem Albania SHPK, Fushë Kruja Cement SHPK vërehet se kostot midis ndërmarrjeve janë të ndryshme nga njëra – tjetrës dhe vihet re se të gjitha ndërmarrjet kanë pësuar rritje të konsiderueshme të kostos mesatare, duke filluar në vitin 2022 kur ka ndodhur dhe rritja me e madhe e kostos. Ndërmarrja Antea Cement SHA paraqitet me vlera të kostos më të vogël së ndërmarrjet e tjera gjatë periudhës nën hetim.

47. Nga analiza individuale e kostove të ndërmarrjeve prodhuese konkudohet se:

- Për ndërmarrjen xxx pjesën më të madhe të kostos totale të prodhimit e kanë zërat: karburant furre, energji elektrike, lëndët e para dhe aditivët, shpenzime zhvlerësimi dhe kosto të tjera (administrative, shpërndarje, etj.) nga viti 2019 deri në periudhën janar – mars 2023, është rritur ndjeshëm pesha specifike që zë kosto e ndryshueshme e prodhimit në koston totale, nga xxx në vitin 2019 në xxx në vitin 2022. Zërat e kostos së ndryshueshme të prodhimit që kanë patur ndikim në rritjen e kostos totale janë energjia elektrike, e cila ka pësuar rritje të ndjeshme nga viti 2021 dhe e në vazhdim dhe lëndët e para dhe aditivët, të cilat kanë pësuar rritje në periudhën janar – mars 2023. Energjia elektrike zinte xxx të kostos totale në vitin 2019, xxx në vitin 2020, xxx në vitin 2021 dhe xxx në vitin 2022, ndërsa lëndët e para dhe aditivët nga rreth xxx të kostos totale për vitet 2019-2022, në 3 mujorin e parë të vitit 2023 zënë xxx të kostos totale.
- Për ndërmarrjen xxx vihet re se klinkeri zë mbi xxx të kostos së prodhimit, energjia xxx dhe pagat e punonjësve mbi xxx.
- Për ndërmarrjen xxx vihet re se qymyri i linjit zë rreth xxx të kostos së prodhimit, energjia elektrike xxx dhe pagat e punonjësve xxx. Për produktet e paketuara materiali i paketimit zë xxx të kostos të prodhimit.
- Për ndërmarrjen xxx vihet re se klinkeri zë rreth xxx të kostos së prodhimit, energjia elektrike xxx dhe pagat e punonjësve rreth xxx. Për produktet e paketuara materiali i paketimit zë xxx të kostos të prodhimit.

48. Nga analiza e kostos së blerjes me çmimin e shitjes për ndërmarrjet importuese vërehet se:

- Produkti çimento gri rifuxho 52.5R, importohet vetëm nga ndërmarrja xxx. Ky produkt zë një pjesë prej xxx të sasisë së shitur nga ndërmarrja, krahasuar me të gjithë totalin e produkteve çimento sipas llojeve të kësaj ndërmarrje. Në periudhën hetimore vërehet se çmimi i shitjes së produktit çimento gri 52.5 R rifuxho ka të njëjtin trend dhe ritëm ndryshimi me çmimin e blerjes së produktit. Nisur nga sa më sipër mund të themi se nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes xxx lidhur me shitjen e produktit çimento gri 52.5 rifuxho nuk vërehen shenja të cilat mund të sjellin kufizim të konkurrencës në treg.
- Referuar produktit çimento gri 42.5R rifuxho, ndërmarrja xxx ka zënë pjesën prej xxx gjatë periudhës hetimore sipas sasisë së shitur të produktit çimento gri 42.5R rifuxho. Në periudhën hetimore vërehet se çmimi i shitjes së produktit çimento e çimento gri 42.5R me rifuxho ka të njëjtin trend dhe ritëm ndryshimi me çmimin e blerjes së produktit. Nisur nga sa më sipër mund të themi se nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes xxx lidhur me shitjen e produktit çimento gri 42.5R rifuxho nuk vërehen shenja të cilat mund të sjellin kufizim të konkurrencës në treg.

49. Referuar produktit çimento gri 42.5R thasë, ndërmarrja xxx për vitin 2019 ka zënë pjesën prej xxx dhe për vitin 2020 pjesën xxx sipas sasisë së shitur të produktit çimento gri 42.5R me thasë.

Gjatë periudhës që kjo ndërmarrje ka importuar këtë produkt vërehet se çmimi i shitjes së produktit çimento gri 42.5R me thasë është në të njëjtat nivele të ritmit të rritjes me çmimin e blerjes së produktit. Në periudhën hetimore vërehet se çmimi i shitjes së produktit çimento e gri 42.5R me thasë ka të njëjtin trend dhe ritëm ndryshimi me çmimin e blerjes së produktit. Nisur nga sa më sipër mund të themi se nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes xxx lidhur me shitjen e produktit çimento gri 42.5R rifuxho nuk vërehen shenja të cilat mund të sjellin kufizim të konkurrencës në treg.

50. Duke qenë se importit i produktit të çimentos së bardhë dominohet nga ndërmarrja xxx, në këtë pjesë është analizuar sjellja e kësaj ndërmarrje. Në periudhën hetimore vërehet se çmimi i shitjes së produktit çimento e bardhë 52.5R me thasë ka të njëjtin trend dhe ritëm ndryshimi me çmimin e blerjes së produktit. Nisur nga sa më sipër mund të themi se nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes xxx lidhur me shitjen e produktit çimento e bardhë 52.5R me thasë nuk vërehen shenja të cilat mund të sjellin kufizim të konkurrencës në treg.
51. Në periudhën hetimore vërehet se çmimi i shitjes së produktit çimento gri 42.5R rifuxho dhe 42.5 R me thasë ka të njëjtin trend dhe ritëm ndryshimi me çmimin e blerjes së produktit. Nisur nga sa më sipër mund të themi se nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes xxx lidhur me shitjen e produktit çimento gri 42.5R rifuxho nuk vërehen shenja të cilat mund të sjellin kufizim të konkurrencës në treg.
52. Sa më sipër nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes xxx vërehet se nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 9 pasi: çmimi i shitjes me shumicë për çimenton e bardhë është në të njëjtin trend me çmimin e blerjes, tregu i importit është një treg i lirë për ndërmarrjet që importojnë çimento, pra nuk ka barriera në hyrje. Gjithashtu nuk vërehet vendosja e kushteve të padrejta të tregtimit.
53. Nga të dhënat mbi shitjet e ndërmarrjes xxx lidhur me klientët më të mëdhenj të saj për sa i përket volumeve të shitjeve, vlerës së shitjeve dhe çmimit mesatar të shitjes së produkteve çimento 32.5 R me thasë, çimento 42.5R me thasë dhe çimento 42.5R rifuxho për vitet 2019 – 2022, rezulton se:
- Për produktin çimento 32.5 R me thasë, klientët më të mëdhenj janë xxx me mbi xxx të sasisë së blerë, xxx me mbi xxx të sasisë së blerë dhe xxx me mbi xxx të sasisë së blerë.
 - Për produktin 42.5R me thasë, klientët më të mëdhenj janë xxx me mbi xxx të sasisë së blerë, xxx me mbi xxx të sasisë së blerë dhe xxx me mbi xxx të sasisë së blerë.
 - Për produktin 42.5R rifuxho rezulton se klientët më të mëdhenj janë xxx me mbi xxx të sasisë të blerë, xxx me mbi xxx të sasisë të blerë, xxx me mbi xxx të sasisë të blerë, xxx me mbi xxx të sasisë të blerë
 - Ndërmarrja xxx ofron çmime të ndryshme për ndërmarrje të ndryshme, si dhe vihet re se çmimi i shitjes ka ardhur në rritje nga viti 2019 deri në fund të periudhës hetimore.

- Nga të dhënat mbi shitjet e ndërmarrjes xxx lidhur me klientët më të mëdhenj të saj për sa i përket volumeve të shitjeve dhe çmimit mesatar të shitjes rezulton se klienti më i madh i ndërmarrjes xxx është xxx deri në vitin 2021. Vihet re se është rritur volumi i shitjeve ndërmarrjes xxx, e cila për vitin 2022 zë rreth xxx të shitjeve totale të ndërmarrjes xxx . Gjithashtu vihet re se çmimi i shitjes ka ardhur në rritje nga viti 2019 deri në periudhën janar – mars 2023. Ndërmarrja xxx ofron çmime të ndryshme për ndërmarrje të ndryshme dhe vihet re se çmimi i ofruar ndërmarrjes xxx është më i ulët se çmimi i ofruar ndërmarrjeve të tjera.
 - Nga të dhënat mbi shitjet e ndërmarrjes xxx lidhur me klientët më të mëdhenj të saj për sa i përket volumeve të shitjeve dhe çmimit mesatar të shitjes rezulton se klientët më të mëdhenj të ndërmarrjes Elbasan Cement Factory janë xxx dhe xxx. Vihet re se çmimi i shitjes ka ardhur në rritje nga viti 2019 deri në periudhën janar – mars 2023. Ndërmarrja xxx ofron çmime të përafërta për ndërmarrje të ndryshme dhe vihet re se çmimi i ofruar ndërmarrjes xxx është më i ulët se çmimi i ofruar ndërmarrjeve të tjera.
54. Ndërmarrjet prodhuese dhe tregtuese të çimentos gri kanë si klientë kryesorë ndërmarrjet që prodhojnë beton, ndërmarrjet që realizojnë ndërtime dhe ndërmarrjet që shesin çimenton në nivelin tjetër të tregtimit. Nga analiza e klientëve rezultojnë se 3-4 klientë realizojnë blerje të çimentos te ndërmarrjet prodhuese.
55. Nga analiza e xhirove të realizuara për periudhën 2019-2022 konstatohet se:
- ndërmarrja xxx për vitet 2019-2022 ka patur një rritje të vazhdueshme të xhiros totale, e cila për vitin 2022 është dyfishuar krahasuar me vitin 2019. Një ritëm të lartë rritje të xhiros totale vërehet edhe në ndërmarrjen xxx e cila për vitin 2022 është tre-fishuar krahasuar me vitin 2019.
 - Ndërmarrja xxx ka pasur një rritje të xhiros vjetore për periudhën hetimore e cila për vitin 2022 është dyfishuar krahasuar me vitin 2019.
 - Ndërmarrja xxx për vitin 2020 ka pasur një dyfishim të xhiros totale vjetore krahasuar me vitin 2019, xhiro të cilën e ka mbajtur në të njëjtat nivele edhe për vitin 2021, ndërsa për vitin 2022 ka pësuar një rënie të lehtë.
 - Ndërmarrja xxx ka vijuar në rënie të xhiros nga viti 2020 në vitin 2022 ndërsa ndërmarrja importuese xxx paraqitet me rritje të xhiros totale e cila përmirësohet vit pas viti duke u dyfishuar në vitin 2022 krahasuar me vitin 2019.
56. Nga analiza e pasqyrave financiare dhe e treguesve kryesorë të përfitueshmërisë vihet re se:
- Ndërmarrja me fitimin më të madh është Antea Cement SHA që nga viti 2019 (me rritje 200% të fitimit duke krahasuar vitin 2022 me 2019 dhe 42% rritje duke krahasuar vitin 2022 me vitin 2021) ndjekur nga ndërmarrja xxx me një fitim relativisht më të vogël. Ndërsa pjesa tjetër e ndërmarrjeve kanë rezultuar me humbje të mëdha. Gjatë dy viteve në vazhdim ndërmarrjet që ishin me rezultat negativ kanë pësuar një ndryshim pozitiv ekonomik duke dale ndërmarrje me fitim përvec rastit të xxx. xxx rezulton se ne periudhën 2019-2022 ka pasur një fitim te

konsiderueshëm ku kulmin e ka arritur ne vitin 2020 me një rezultat prej 1,060,551,000 Leke dhe një norme prej 13.9%. Për vitin 2022 të gjitha ndërmarrjet përjashtuar xxx kanë pasur rritje të konsiderueshme të fitimit. Fitimin neto më të madh nga të gjitha ndërmarrjet per katër vitet e marra në analizë e ka ndërmarrja Antea Cement SHA.

- ROA si një nga treguesit e përfitueshmërisë paraqet kthimin nga totali i aktiveve. Pra sa fitim do të gjenerojë ndërmarrja nga aktivet e saj. Sa më e lartë që të jetë ROA aq më eficiente është ndërmarrja në gjenerimin e të ardhurave nëpërmjet përdorimit të aktiveve të saj. Duke analizuar ndërmarrjet e marra në shqyrtim vihet re një luhatshmëri në vlera për ndërmarrjet xxx, xxx, xxx që variojnë nga negative në pozitive apo edhe e kundërta për periudhën 2019-2022. xxx rezulton me një ROA tepër të lartë për vitin 2020 me 7 %. Ndërmarrjet me trend rritës pozitiv dhe të sigurt për periudhën katër vjeçare janë xxx (nga 2.2 % për vitin 2019 në 6.8% në vitin 2022) dhe xxx (nga 9.4 % për vitin 2019 në 14.5 % në vitin 2022).
- ROE si një nga treguesit e përfitueshmërisë paraqet kthimin nga kapitali. Pra sa fitim do të gjenerojë ndërmarrja nga kapitali i saj. Sa më e lartë që të jetë ROE aq më mirë është një ndërmarrje në konvertimin e financimit të kapitalit të saj në fitime. Duke marre ne analize ndërmarrjet xxx dhe xxx rezulton një luhatshmëri shumë e madhe në vlerat përkatëse për katër vitet e marra në shqyrtim. Një ROE me një luhatshmëri të tillë flet për një paqëndrueshmëri ekonomike të këtyre ndërmarrjeve. xxx rezulton me një ROE tepër të lartë për vitin 2020 me 17.1%. Ndërmarrjet me trend rritës pozitiv dhe të sigurt për periudhën 2019-2022 janë xxx (nga 7.1 % për vitin 2019, në 14.2 % për vitin 2022) dhe xxx (nga 17 % për vitin 2019, në 51.3 % për vitin 2022).

III.4 Vlerësimi i pozitës dominuese për ndërmarrjen Antea Cement SHA

57. Në analizën tonë është bërë vlerësimi i pozitës dominuese të ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun përkatës, për të parë nëse ndonjë ndërmarrje zotëron ose jo pozitë dominuese në tregun përkatës, vlerësim i cili është bërë bazuar në nenin 8, të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Sipas ligjit nr. 9121/2003, nuk është e ndaluar pozita dominuese nga një ose disa ndërmarrje në treg, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjeve një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të këtij ligji. Ky detyrim i ndërmarrjeve me pozitë dominuese në treg rezulton edhe nga përcaktimet e bëra në nenin 673, të Kodit Civil, sipas të cilit “Një ndërmarrje që zë një pozitë dominuese në treg, është e detyruar të kontrakttojë me cilindo që kërkon një detyrim, i cili bën pjesë në objektin e veprimtarisë së saj, në përputhje me ligjet e zakonet e mira tregtare. Përfundimi i një kontrate, nuk mund të refuzohet pa një arsye të ligjshme”.

58. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të nr. 9121/2003 janë: pjesët e tregut përkatës, pengesat në hyrje në tregun përkatës, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes, varësia ekonomike e

furnizuesve dhe blerësve, fuqia kundërvepruese e blerësve; zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së ndërmarrjeve, si dhe karakteristika të tjera të tregut përkatës.

59. Një nga kriteret kryesore, që përcaktojnë pozitën dominuese në treg është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun përkatës. Përvoja e vendeve të Bashkimit Evropian udhëzon, që pozita dominuese nuk është e mundur nëse pjesa e tregut përkatës të ndërmarrjes është më e vogël se 40%. *Ekspertiza sugjeron se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrja zotëron një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit.*
60. *Çështja United Brands², e njohur gjithashtu si Rasti 27/76 i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED), është një vendim historik në ligjin e konkurrencës të BE-së që përfshin United Brands Company (UBC), e njohur kryesisht për markën e saj të bananeve Chiquita, e cila ishte furnizuesja kryesore e bananeve në Evropë. Komisioni Evropian (KE) akuzoi UBC-në për abuzim me pozitën e saj dominuese në treg duke shkelur nenin 86 të Traktatit të Romës (tani neni 102 i TFEU), i cili ndalon një abuzim të tillë. KE identifikoi disa praktika kundër konkurrencës nga UBC: ...ndër të tjera UBC fiksoi çmimet e bananeve çdo javë, duke ngarkuar çmime më të larta në shtete të ndryshme anëtare. UBC vendosi çmime të padrejta për klientët në Bashkimin Ekonomik Belgo-Luksemburg, Danimarkë, Holandë dhe Gjermani. GJED ra dakord me gjetjet e KE. GJED hodhi poshtë pretendimin e UBC se tregu i produktit përkatës duhet të konsiderohet si "tregu i frutave të freskëta në tërësi". Në vend të kësaj, për shkak të karakteristikave unike dhe elasticitetit të kryqëzuar të kërkesës për banane, tregu u përcaktua në mënyrë specifike si tregu i bananeve. UBC zotëronte rreth 40-45% të tregut të bananeve të BE-së, të cilin GJED e konsideroi të mjaftueshme për të përbërë një "pozicion dominues". Ky rast konsiderohet **si një nga më të rëndësishmit në të drejtën evropiane të konkurrencës**, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së konkurrencës së ndershme dhe pasojat e abuzimit me pozicionin dominues në treg. Ai vendosi një precedent për mënyrën se si dominimi i tregut dhe praktikant antikorruese vlerësohen brenda BE-së.*
61. Ndërmarrja Antea Cement SHA zotëron nga xxx të tregut të prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri brenda vendit, referuar tre llojeve të çimentos (32.5 R me thasë, 42.5 R me thasë dhe 42.5 R rifuxho), përkatësisht xxx për vitin 2019, xxx për vitin 2020, xxx për vitin 2021 dhe xxx për vitin 2022, duke qenë ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut të shitjes me shumicë të çimentos brenda vendit për vitet 2019 - 2022. Edhe për 3 mujorin e parë të vitit 2023, pjesa e tregut të shitjes me shumicë brenda vendit të kësaj ndërmarrje mbetet e lartë me xxx, mbi kufirin 40% i cili është një nga treguesit e një ndërmarrje me pozitë dominuese në treg.

² <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A61976CJ0027>

62. Për sa i përket sasisë së shitur të çimentos gri brenda vendit sipas nën tregjeve, rezulton se ndërmarrja Antea Cement SHA zotëron një pjesë tregu më të lartë se xxx në shitjet e produktit çimento gri 32.5 R me thasë, përkatësisht xxx për vitin 2019, xxx për vitin 2020, xxx për vitin 2021 dhe xxx për vitin 2022, duke qenë ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut të shitjes me shumicë të çimentos gri 32.5 R me thasë brenda vendit për vitet 2019 – 2022. Përsa i përket shitjeve të produktit çimento 42.5 R rifuxho, ndërmarrja Antea Cement SHA zotëron pjesë tregu prej xxx për vitin 2021 dhe xxx për vitin 2022.
63. Tregu i prodhimit të çimentos në Shqipëri ka barriera ligjore në hyrje të tilla si vështirësitë e marrjes së lejeve përkatëse minerare për shfrytëzimin e mineraleve ndërtimore të cilët përdoren si lëndë e parë për prodhimin e çimentos, lejet mjedisore për instalimet e tyre, të cilat mund të ndikojnë në shkarkimet dhe ndotjen, etj. Ndërsa për sa i përket importit, përveç lejes mjedisore, nuk ka barriera të tjera ligjore në hyrje.
64. Gjithashtu, për ndërmarrjet që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit të çimentos ka barriera ekonomike në formën e investimeve të larta në fabrikat e prodhimit të çimentos.
65. Për sa i përket konkurrencës potenciale, ashtu siç e kemi përmendur edhe më sipër, ndërmarrja Antea Cement SHA është ndërmarrja që zë pjesën më të madhe në prodhimin dhe tregtimin e çimentos gri brenda vendit dhe veçanërisht në shitjen e çimentos gri 32.5 R me thasë. Megjithatë në tregun e shitjes me shumicë operojnë edhe ndërmarrje të tjera me pjesë tregu të konsiderueshme si xxx, etj. Ekzistenca e ndërmarrjeve të tjera në treg bën që të ketë konkurrencë potenciale. Megjithatë, në raste të caktuara, siç është rasti i mbylljes së përkohshme të aktivitetit të ndërmarrjes xxx në vitin 2022, mungon konkurrenca potenciale.
66. Për sa i përket fuqisë kundërvepruese të blerësve një ndërmarrje me pjesë të madhe tregu nuk mund të veprojë e pavarur nga klientët që zotërojnë fuqi të mjaftueshme tregu. Një fuqi e tillë kundërvepruese, blerëse mund të vijë si rezultat: i numrit të klientëve ose rëndësisë së tyre tregtare për ndërmarrjen me pozitë dominuese; i aftësisë së tyre për të kaluar drejt furnizuesve të tjerë konkurrentë. Në rastin tonë klientët kanë mundësi për të kaluar drejt furnizuesve të tjerë konkurrentë. Dhe në këtë rast, në kushtet e mungesës së konkurrencës potenciale, në raste të caktuara, (xxxxxxxxxx) , blerësit nuk kanë fuqi të lartë kundërvepruese.
67. Për sa i përket fuqisë ekonomike dhe financiare, referuar të dhënave ekonomike të ndërmarrjes Antea Cement SHA rezulton se nga viti 2019 në vitin 2022 ka patur rritje të të ardhurave dhe të fitimit të ndërmarrjes, me një normë fitimi nga 7.1% në vitin 2019 në 11.9% në vitin 2022. Këto norma fitimi janë më të larta se të ndërmarrjeve të tjera në treg për periudhën e hetimit.
68. Produktet që ndërmarrja Antea Cement SHA prodhon dhe tregon janë homogjene me produktet e ndërmarrjeve të tjera që operojnë në treg.

69. Duke marrë parasysh pjesën e tregut të ndërmarrjes Antea Cemen SHA, barrierat për hyrjen në treg, fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes, konkurrencën potenciale, fuqinë kundërvepruese të blerësve dhe homogjenitetin e produkteve, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja Antea Cement SHA, vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e shitjes me shumicë të çimentos gri brenda vendit, përkatësisht për çimento 32.5 R me thasë, për vitet 2019-2022, dhe çimento 42.5 R rifuxho, për vitet 2021-2022.
70. Në lidhje me ndërmarrjet me pozitë dominuese, neni 9 “Abuzimi me pozitën dominuese në treg”, i ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, parashikon se:
1. *Ndalohet çdo abuzim me pozitën dominuese nga një ose më shumë ndërmarrje, që e zotërojnë këtë pozitë në treg.*
 2. *Mund të përbëjnë abuzim me pozitën dominuese veçanërisht:*
 - a) *vendosja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;*
 - b) *kufizimi i prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;*
 - c) *zbatimi i kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
 - ç) *vendosja e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.*

III.5 Sjellja e ndërmarrjes Antea Cement SHA

71. Nga të dhënat mbi shitjet e ndërmarrjes Antea Cement SHA lidhur me klientët më të mëdhenj të saj për sa i përket volumeve të shitjeve, rezulton se klientët më të mëdhenj të ndërmarrjes Antea Cement SHA janë xxx dhe xxx. Klientë të tjerë janë xxx, xxx, xxx, xxx, etj.
72. Volumi i shitjeve ndërmarrjes xxx është rritur nga viti 2019 në vitin 2022, nga rreth xxx të shitjeve në vitin 2019 në rreth xxx të shitjeve totale të ndërmarrjes Antea Cement SHA për vitin 2022, duke qenë klienti më i madh i saj. Çmimi i shitjes së çimentos ka ardhur në rritje nga viti 2019 deri në periudhën janar – mars 2023, ku rritja më e madhe e çmimeve ka ndodhur në vitin 2022.
73. Vihet re se çmimi i ofruar ndërmarrjes xxx është më i ulët se çmimi i ofruar ndërmarrjeve të tjera për të gjithë periudhën hetimore, përkatësisht rreth xxx më i ulët për vitin 2019, rreth xxx më i ulët për vitin 2020, rreth xxx më i ulët për vitin 2021 dhe rreth xxx më i ulët për vitin 2022. Ndërmarrja xxx zë rreth xxx të shitjeve totale të çimentos gri të ndërmarrjes Antea

Cement SHA, për vitet 2019-2022. Uljet e kushtëzuara (skonto) janë ulje që i jepen klientëve për ti shpërblyer ata për forma të veçanta të sjelljes blerëse.³

74. Ndërmarrja Antea Cement SHA ofron çmime të ndryshme për ndërmarrjet e tjera, por këto çmime janë të përafërta, (me një diferencë nga 0.2 në 1.5 euro / ton) për vitet 2019-2021. Në vitin 2022 dhe periudhën janar - mars 2023 ka një diferencë më të madhe ndërmjet çmimeve mesatare të shitjes të ndërmarrjeve. Kjo sjellje e ndërmarrjes Antea Cement SHA duke zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me klientët e saj, i vendos ato në kushte të pafavorshme konkurrence, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 9, pika 2, gërma c), të ligjit nr. 9121/2003.
75. Nga vlerësimi i kontratave të administruara, që Antea Cement SHA ka lidhur me klientët e saj për shitjen me shumicë të çimentos, vihet re se kjo ndërmarrje përgjithësisht operon duke ju përmbajtur kushteve të përgjithshme të kontratave, si për nga objekti, forma, qëllimi i marrëdhënies juridike si dhe në vendosjen e çmimit sipas vlerës së tregut. Përfundim të Kontrata e Shitjes, e datës 01.06.2022, lidhur ndërmjet Antea Cement SHA dhe xxx, sipas së cilës ndërmarrja Antea Cement SHA në çdo moment ka të drejtën ekskluzive të ndryshojë në mënyrë të njëanshme dhe pa miratimin e xxx çmimin e shitjes së çimentos apo edhe termat e tjera tregtare të kontratës. Bazuar në nenin 9, pika 2, gërmat a) dhe c) të ligjit nr. 9121/2003, vendosja në mënyrë të njëanshme e kushteve të padrejta të tregtimit dhe kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët e tjera, e vendos ndërmarrjen xxx në kushte të pafavorshme konkurrence.
76. Lidhur me këtë sjellje kontraktore, nga të dhënat mbi shitjet e çimentos gri, rezulton se ndërmarrja xxx zë rreth xxx të shitjeve totale të çimentos së ndërmarrjes Antea Cement SHA për vitin 2019, rreth xxx të shitjeve totale për vitin 2020, rreth xxx për vitin 2021 dhe rreth xxx të shitjeve totale të ndërmarrjes Antea Cement SHA për vitin 2022, duke qenë klienti më i madh i ndërmarrjes Antea Cement SHA nga viti 2020 e në vazhdim. Çmimi që ndërmarrja Antea Cement SHA aplikon për ndërmarrjen xxx, për vitet 2019-2021, është i përafërt me çmimin e klientëve të tjerë. Për vitin 2022 dhe periudhën janar - mars 2023 ka një diferencë më të madhe ndërmjet çmimeve mesatare të shitjes të ndërmarrjeve.
77. Nga të dhënat mbi volumin e prodhimit dhe të shitjeve të çimentos të ndërmarrjes Antea Cement SHA vihet re se për produktin çimento gri 32.5 R me thasë volumi i prodhimit dhe i shitjeve të produktit ka ardhur në rënie nga viti 2019 në vitin 2022; për produktin çimento gri 42.5 R me thasë volumi i prodhimit dhe i shitjeve është rritur nga viti 2019 në vitin 2020 dhe

³ Udhëzimi (2014) “Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese”. Miratuar me VKK nr.332/2014.

https://caa.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Udhezimi_per_poziten_dominuese.pdf

më pas ka pësuar rënie nga viti 2020 në vitin 2022; ndërsa për produktin 42.5 R rifuxho volumi i prodhimit dhe i shitjeve ka ardhur në rritje nga viti 2019 në vitin 2022.

78. Kosto totale e prodhimit të produkteve çimento gri 32.5 R me thasë, çimento gri 42.5 R me thasë dhe çimento gri 42.5 R rifuxho përbëhet nga shuma e kostove të ndryshueshme të prodhimit dhe kostove fikse të prodhimit. Ndër zërat e kostos variabël që zënë pjesën më të madhe të kostos totale të prodhimit janë karburant furre, energji elektrike dhe lëndët e para e aditivët, ndërsa nga zërat e kostos fikse që zënë pjesën më të madhe të kostos totale të prodhimit janë shpenzimet e zhvlerësimit, kosto të tjera (administrative, shpërndarje, etj.) dhe pagat dhe shpenzime të ngjashme.
79. Për ndërmarrjen Antea Cement SHA pjesën më të madhe të kostos totale të prodhimit e zënë zërat: karburant furre, energji elektrike, lëndët e para dhe aditivët, shpenzime zhvlerësimi dhe kosto të tjera (administrative, shpërndarje, etj.).
80. Gjatë periudhës së hetimit, në nën tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento gri 42.5 R rifuxho, nga viti 2019 deri në periudhën janar – mars 2023, është rritur ndjeshëm pesha specifike që zë kosto e ndryshueshme e prodhimit në koston totale, nga xxx në vitin 2019 në xxx në vitin 2022. Zërat e kostos së ndryshueshme të prodhimit që kanë patur ndikim në rritjen e kostos totale janë energjia elektrike, e cila ka pësuar rritje të ndjeshme nga viti 2021 dhe e në vazhdim dhe lëndët e para dhe aditivët, të cilat kanë pësuar rritje në periudhën janar – mars 2023. Energjia elektrike zinte xxx të kostos totale në vitin 2019, xxx në vitin 2020, xxx në vitin 2021 dhe xxx në vitin 2022, ndërsa lëndët e para dhe aditivët nga rreth xxx të kostos totale për vitet 2019-2022, në 3 mujorin e parë të vitit 2023 zënë xxx të kostos totale.
81. Gjatë periudhës së hetimit, në nën tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento gri 42.5 R me thasë, nga viti 2019 deri në periudhën janar – mars 2023, është rritur ndjeshëm pesha specifike që zë kosto e ndryshueshme e prodhimit në koston totale, nga xxx në vitin 2019 në xxx në vitin 2022. Zërat e kostos së ndryshueshme të prodhimit që kanë patur ndikim në rritjen e kostos totale janë energjia elektrike, e cila ka pësuar rritje të ndjeshme nga viti 2021 dhe e në vazhdim dhe lëndët e para dhe aditivët, të cilat kanë pësuar rritje në periudhën janar – mars 2023. Energjia elektrike zinte xxx të kostos totale në vitin 2019, xxx në vitin 2020, xxx në vitin 2021 dhe xxx në vitin 2022, ndërsa lëndët e para dhe aditivët nga rreth xxx të kostos totale për vitet 2019-2022, në 3 mujorin e parë të vitit 2023 zënë xxx të kostos totale.
82. Gjatë periudhës së hetimit, në nën tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento gri 32.5 R me thasë, nga viti 2019 deri në periudhën janar – mars 2023, vihet re se është rritur ndjeshëm pesha specifike që zë kosto e ndryshueshme e prodhimit në koston totale, nga xxx në vitin 2019 në xxx në vitin 2022 për CEM II 42.5 R rifuxho, nga xxx në vitin

2019 në xxx në vitin 2022 për CEM II 42.5 R me thasë dhe nga xxx në vitin 2019 në xxx në vitin 2022 për CEM II 32.5 R me thasë. Zërat e kostos së ndryshueshme të prodhimit që kanë patur ndikim në rritjen e kostos totale janë energjia elektrike, e cila ka pësuar rritje të ndjeshme nga viti 2021 dhe e në vazhdim dhe lëndët e para dhe aditivët, të cilat kanë pësuar rritje në periudhën janar – mars 2023. Energjia elektrike zinte xxx të kostos totale në vitin 2019, xxx në vitin 2020, xxx në vitin 2021 dhe xxx në vitin 2022, ndërsa lëndët e para dhe aditivët nga rreth xxx të kostos totale për vitet 2019-2022, në 3 mujorin e parë të vitit 2023 zënë rreth xxx të kostos totale.

83. Nga krahasimi i kostos mesatare mujore të prodhimit me çmimin mesatar mujor të shitjes për ndërmarrjen Antea Cement SHA vërehet se kosto mesatare mujore e prodhimit për produktet çimento gri 32.5 R me thasë, çimento gri 42.5 R me thasë dhe çimento gri 42.5 R rifuxho ka luhatje të vazhdueshme gjatë periudhës së hetimit, ndërsa çmimi mesatar mujor i shitjes luhatet më pak. Gjithashtu vërehet se ka diferencë të konsiderueshme midis çmimit mesatar mujor të shitjes sipas tipeve të çimentos dhe kostos totale mesatare mujore të prodhimit të çimentos.
84. Përkatësisht, diferenca midis çmimit mesatar vjetor të shitjes së çimentos me koston mesatare vjetore të prodhimit të çimentos, për vitet 2019-2022, rezulton të jetë nga 34% - 64% për produktin çimento gri 32.5 R me thasë, nga 30 % - 62 % për produktin çimento gri 42.5 R me thasë dhe nga 40 % -75 % për produktin çimento gri 42.5 R rifuxho.
85. Nga të dhënat mbi çmimet e shitjes dhe kostot mesatare të prodhimit për produktet çimento gri 32.5 R me thasë, çimento gri 42.5 R me thasë dhe çimento gri 42.5 R rifuxho rezulton se marzhi i fitimit për tre tipet e çimentos për vitet 2019 dhe 2020 është mbi 40%, marzhi i cili është eksisiv. Ai ka një rritje të ndjeshme nga viti 2019 në vitin 2020, ndërsa pas vitit 2020 deri në mars të vitit 2023 marzhi i fitimit paraqitet në rënie, por mbetet mbi 20% për të gjithë periudhën e hetimit.
86. Referuar nenit 9, pika 1 dhe 2, gërma a, të ligjit nr. 9121/2003, përcaktohet qartë se vendosja e çmimeve të padrejta apo kushteve të tjera të padrejta të tregtimit përbën shkelje të këtij neni, duke abuzuar me pozitën dominuese në treg. Termit “çmime të padrejta” i është referuar Gjykata Europiane e Drejtësisë dhe Komisioni Europian, në rastin e çmimeve eksensive (diferenca eksensive midis kostos totale të produktit dhe çmimit përfundimtar të shitjes). Referuar rasteve të trajtuara nga Komisioni Europian dhe Gjykata Europiane e Drejtësisë, çmim eksisiv është çmimi që nuk ka lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit⁴.

⁴ Rasti 27/76 United Brands vs. KE [1978] ECR 207, paragrafi 250: “Në këtë rast vendosja e një çmimi “i cili është eksisiv sepse nuk ka lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit të ofruar do të përbente një abuzim”

87. Për tre produktet e marra në analizë në tregun përkatës (çimento gri 32.5 R me thasë, çimento gri 42.5 R me thasë dhe çimento gri 42.5 R rifuxho), vërehet se çmimi mesatar vjetor i shitjes së produkteve vjen në rritje nga viti 2019 deri në mars të vitit 2023. Ndërkohë kosto mesatare e prodhimit të çimentos sipas llojeve ka pësuar rënie në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, ndërsa në vitet në vijim kosto mesatare e prodhimit ka vijuar rritjen. Rritja më e madhe e kostos së prodhimit dhe e çmimit të shitjes së çimentos ka ndodhur në vitin 2022 krahasuar me vitin e mëparshëm.
88. Në vitin 2020 vërehet se megjithëse kosto mesatare e prodhimit të produkteve çimento gri 32.5 R me thasë, çimento gri 42.5 R me thasë dhe çimento gri 42.5 R rifuxho pëson rënie, çmimi mesatar i shitjes së produktit është rritur. Për vitet 2021 dhe 2022, krahasuar me vitet paraardhës, vërehet rritje e kostos mesatare të prodhimit dhe çmimit mesatar të shitjes së produkteve, por rritja e çmimit mesatar të shitjes është më e vogël se rritja e kostos mesatare të prodhimit. Gjatë vitit 2022, pothuajse e gjithë madhësia e rritjes së kostos është reflektuar në rritjen e çmimit të shitjes.
89. Nga krahasimi i çmimeve mesatare të shitjes brenda vendit dhe çmimeve të eksportit për produktet çimento gri 32.5 R me thasë, çimento gri 42.5 R me thasë dhe çimento gri 42.5 R rifuxho vihet re se për periudhën e hetimit, ndërmarrja Antea Cement SHA aplikon çmime më të ulëta për shitjen e çimentos jashtë vendit, sesa brenda vendit. Për produktin çimento gri 32.5 R me thasë çmimi i eksportit është rreth 10-14 % më i ulët se çmimi i shitjes brenda vendit. Për produktin çimento gri 42.5 R me thasë çmimi i eksportit është rreth 10-16 % më i ulët se çmimi i shitjes brenda vendit. Për produktin çimento gri 42.5 R rifuxho çmimi i eksportit është rreth 6-19 % më i ulët se çmimi i shitjes brenda vendit.
90. Gjithashtu për hetimin e thelluar janë marrë në analizë treguesit e përfitueshmërisë për Antea Cement SHA në nivel rajonal. Sipas ndarjes territoriale që ka bërë Antea Cement SHA, Shqipëria bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve Titan Cement Group të Europës Juglindore e cila është një ndërmarrje me emer në tregjet ndërkombëtare e themeluar në Greqi që në vitin 1902. Ndërmarrjet e tjera përbërëse të grupit janë në shtetet si Serbia, Bullgaria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Pas marrjes në analizë të pasqyrave financiare të të gjithë këtyre vendeve (raporte të cilat mund të gjendeshin publikisht) janë evidentuar fitimet neto si tregues i përfitueshmërisë për të gjitha këto shtete. Titan Group në të cilën bën pjesë Antea Cement SHA është e shpërndarë në të gjithë botën, konkretisht Europa Juglindore, Mesdheu Lindor, Greqi dhe Europa lindore, Amerikë dhe Brazil. Pjesë e analizës së bërë do jetë vetëm Europa Juglindore.
91. Nga analiza e treguesve të përfitueshmërisë së grupit Titan Cement Group, ku bën pjesë Antea Cement SHA, vihet re se për periudhën hetimore (nga viti 2019 deri në vitin 2022) Antea Cement SHA ka rritur 200 % treguesin e fitimit. Për periudhën nga viti 2021 në vitin 2022 (vit

i cili përkon me rritjen e çmimeve) Antea Cement SHA ka rritur 42 % treguesin e fitimit, ndërkohë që Maqedonia e Veriut e ka pasur këtë tregues negativ dhe Serbia 18 %.

92. Sa më sipër, nga analiza e çmimeve të shitjes së ndërmarrjes Antea Cement Albania SHA për produktet çimento gri 32.5 R me thasë dhe 42.5 R rifuxho, krahasimi i çmimit mesatar të shitjes me koston mesatare të prodhimit dhe krahasimi i çmimeve mesatare të shitjes së produkteve brenda dhe jashtë vendit rezulton se: ndërmarrja Antea Cement Albania SHA aplikon çmime ekseseive të cilat nuk kanë lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit, pasi ka diferencë të konsiderueshme midis çmimit mesatar mujor të shitjes sipas tipeve të çimentos dhe koston mesatare mujore të prodhimit të çimentos; në vitin 2020, çmimi mesatar i shitjes së produktit është rritur, megjithëse kosto mesatare e prodhimit të çimentos pëson rënie; çmimi i shitjes së çimentos jashtë vendit është më i ulët se çmimi i shitjes brenda vendit; ndërmarrja Antea Cement SHA ka aplikuar çmim më të ulët për ndërmarrjen xxx në raport me klientët e tjerë, për periudhën nën hetim; për ndërmarrjen xxx ka vendosur në mënyrë të njëanshme kushte të padrejta dhe të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me klientët e saj duke i vendosur ato në kushte të pafavorshme konkurrence, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 9, pika 2, germa a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 4, 8, 9, nenin 24 shkronja d), nenin 26, nenin 43, pika 5, nenin 74, pika 1, germa a) dhe nenin 75, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun prodhimit dhe shitjes së çimentos gri dhe të bardhë.
- II. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri.
- III. Gjorbitjen e ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 9, pika 2, gërmat germa a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003, në shumën 97,700,736 (nëntëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) Lekë .
- IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Antea Cement SHA, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1092 , Datë 11. 07. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, HONEST BEER SHPK, NGA ORTAKËT THEMELUES TË SAJ, Z. SOKOL KRAJA DHE Z. ADNAND HOXHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola Delija	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 07. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, HONEST BEER SHPK nga ortakët themelues të saj z. Sokol Kraja dhe z. Adnand Hoxha.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, HONEST BEER SHPK nga ortakët themelues të saj z. Sokol Kraja dhe z. Adnand Hoxha.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi, në lidhje me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, HONEST BEER SHPK, nga ortakët themelues të saj z. Sokol Kraja dhe z. Adnand Hoxha.

Referuar dokumenteve të depozituara, palët në transaksion janë:

Pala 1: z. Sokol Kraja, person fizik, shtetas shqiptar, i cili zotëron: 100% të shoqërisë CAPITAL RESOURCES SHPK dhe 100% të shoqërisë Astral SHPK.

CAPITAL RESOURCES SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti prodhimin e produkteve të tjera ushqimore; prodhimin e sheqerit; prodhimin e kakaos, çokollatës dhe ëmbëlsirave; përpunimin e çajit dhe kafes; tregtia me shumicë e pijeve; kryerja e aktivitetit të punimeve civile, industriale e të tjera; tregtia me shumicë e qumështit dhe nënprodukteve të tij.

Astral SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti veprimtari në fushën e ndërtimit, prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit, import, eksporti i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë dhe të të tretëve; ndërtime të ndryshme civile, industriale, social-kulturore të të gjitha llojeve; import, eksport dhe tregtim i artikujve ushqimorë në përgjithësi, lëndëve të para për prodhimin e tyre; veprimtari me shitje – blerjen e pasurive të paluajtshme, dhënien e marrjen e tyre me qira; veprimtari në fushën e turizmit etj.

Pala 2: z. Adnand Hoxha, person fizik shtetas shqiptar, i cili zotëron 100% të shoqërisë IDEL SHPK dhe 25% të shoqërisë PERLA- S12 SHPK.

IDEL SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti projektim dhe zbatim i veprave ndërtimore si vijon: ndërtime me karakter civil dhe ekonomik, punime/ gërmime dhe sistemime dheu, tarracime, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndërtime rrugësh, asfaltime; prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë të materialeve inerte si beton, asfalto - beton; shtrim rrugësh dhe riparime me beton ose materiale të tjera të përdorura për këtë qëllim; ndërtim dhe shtrirje të rrjeteve të gazit natyror; zhvillimi dhe ndërmjetësimi i projekteve për rikonstruksionin e ndërmarrjeve industriale etj.

PERLA - S12 SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ndërtim i “Kompleksit Turistik” në vendin e quajtur Gjiri i Lalëzit Durrës.

Ndërmarrje e Përbashkët (JV): HONEST BEER SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti marrjen, përfitimin apo prodhimin e produkteve të së drejtës intelektuale dhe tregtimin apo dhënien në përdorim të tyre palëve të treta etj. Për arritjen e objektivave të saj, shoqëria do të ketë gjithashtu mundësinë të zhvillojë të gjitha operacionet tregtare, industriale, me të luajtshme e të paluajtshme, që do të konsiderohen të nevojshme, të dobishme nga organi administrativ.

II. Transaksioni

Më datë [.....], z. Sokol Kraja (pala e parë), shoqëria CAPITAL RESOURCES SHPK (pala e dytë), z. Adnand Hoxha (pala e tretë) dhe shoqëria IDEL SHPK (pala e katërt) kanë nënshkruar “Kontratë Bashkëpunimi”, nëpërmjet të cilës Palët dëshirojnë të përcaktojnë kushtet e përgjithshme që do të zbatohen për rregullimin e marrëdhënies ndërmjet tyre, me qëllim për të rritur sasinë dhe cilësinë e shitjeve në Shqipëri, për të forcuar më tej prezencën e brandit që tregton

Bitburger Broungruppe, shfrytëzimin e rrjetit të kompanisë CAPITAL RESOURCES SHPK për të mbuluar distribucion në të gjithë vendim.

Kjo kontratë bashkëpunimi është finalizuar me nënshkrimin nga z. Sokol Kraja dhe z. Adnand Hoxha, të statutit të shoqërisë HONEST BEER SHPK, në datë 30 tetor 2023. Referuar nenit 4 të statutit, shoqëria ka për objekt të saj: Marrja, përftimi apo prodhimi i produkteve të së drejtës intelektuale dhe tregtimi apo dhënia në përdorim të palëve të treta; Për arritjen e objektivave të shoqërisë, shoqëria do të ketë gjithashtu mundësinë të zhvillojë të gjitha operacionet tregtare, industriale.

Shoqëria do të jetë me pronësi të barabartë në kapital, ku 50% e kapitalit do të zotërohen nga z. Sokol Kraja dhe 50% të kapitalit nga z. Adnand Hoxha.

Më datë 06 shkurt 2024, Biburger Braugruppe GmbH (Bitburger), CAPITAL RESOURCES SHPK (Distributori) dhe HONEST BEER SHPK (i licencuari) kanë nënshkruar “Marrëveshje Ekskluzive Distribucioni”.

Referuar kësaj marrëveshje, Bitburger i jep të drejtën ekskluzive të distribucionit shoqërisë HONEST BEER SHPK, për të shitur produktet: 1. Birrën Bitburger, 2. Birrën Benediktiner dhe 3. Birrën Köstritzer. I licencuari do ta ushtrojë këtë të drejtë nëpërmjet distributorit, shoqërisë CAPITAL RESOURCES SHPK, i cili do të shpërndajë produktet e mësipërme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Distributori do të vendosë në dispozicion të gjithë infrastrukturën e tij, mjetet logjistike, magazinat, Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit, Departamentin e Prokurimeve, Departamentin e Logjistikës, Grupin komercial, me automjetet e tyre dhe të gjitha pajisjet e tjera elektronike në mënyrë që të realizohet një proces sa më i mirë distribucioni.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të klasifikohet tregu i përfitimit dhe prodhimit të produkteve të së drejtës intelektuale dhe tregtimi apo dhënia në përdorim e tyre palëve të treta dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, HONEST BEER SHPK, nga ortakët themelues të saj z. Sokol Kraja dhe z. Adnand Hoxha.

Ndërmarrja e përbashkët (JV), HONEST BEER SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt të veprimtarisë: marrja, përfitimi apo

prodhimi i produkteve të së drejtës intelektuale dhe tregtimi apo dhënia në përdorim e tyre palëve të treta.

Ndërmarrja e përbashkët, HONEST BEER SHPK, do të jetë përfaqësuese ekskluzive e Bitburger Braugruppe GmbH në Shqipëri. Ajo do t'i japë të drejtën ekskluzive të distribucionit kompanisë CAPITAL RESOURCES SHPK për të shpërndarë produktet (birrën Bitburger, birrën Benediktiner dhe birrën Köstritzer), brenda territorit shqiptar.

Shoqëria IDEL SHPK ka qenë përfaqësuese ekskluzive e kompanisë Bitburger Braugruppe GmbH në Shqipëri, me të drejtë shpërndarje ekskluzive të produkteve të kësaj kompanie brenda territorit shqiptar dhe siç rezulton nga të dhënat e DPD për vitin 2022 ndërmarrja IDEL SHPK ka importuar 0.3% të birrës në vend, e cila i përket markave Bitburger, Benediktiner dhe Köstritzer.

Gjatë vitit 2023, IDEL SHPK ka importuar 0.4% të volumit të birrës të markave Bitburger, Benediktiner dhe Köstritzer dhe 0.1% e ka importuar CAPITAL RESOURCES SHPK. Të dyja ndërmarrjet së bashku kanë importuar 0.5% të volumit të birrës gjatë vitit 2023.

Duke patur parasysh numrin e konkurrentëve në treg, si dhe pjesët e tyre të tregut, praninë e prodhuesve vendas dhe atyre të huaj me markat më të njohura të birrës në nivel global, transaksioni i njoftuar nuk sjell shqetësime për konkurrencën në treg.

Pjesa e tregut e birrave të markave Bitburger, Benediktiner dhe Köstritzer është shumë e vogël.

Shoqëritë e kontrolluara nga ortakët e ndërmarrjes së përbashkët, HONEST BEER SHPK operojnë në tregje të ndryshme nga tregu i shitjes së birrës dhe për këtë arsye, nuk konstatohet të mbivendoset aktiviteti i ndërmarrjes së përbashkët me aktivitetet e shoqërive të tjera.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, HONEST BEER SHPK, nga ortakët themelues të saj z. Sokol Kraja dhe z. Adnand Hoxha.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1093 , Datë 11. 07. 2024

“MBI MIRATIMIN E UDHËZUESIT “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 9121/2003 “PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS” PËR MARRËVESHJET KOLEKTIVE NË LIDHJE ME KUSHTET E PUNËS SË PERSONAVE TË VETËPUNËSUAR”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 07. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi miratimin e Udhëzuesit “Për zbatimin e Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së personave të vetëpunësuar””.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft-Udhëzuesit “Për zbatimin e legjislacionit të konkurrencës për marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së personave të vetëpunësuar”

VËREN SE:

1. Udhëzimi “Për zbatimin e Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së personave të vetëpunësuar”, ka për qëllim të përcaktojë parimet për vlerësimin sipas nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003) të marrëveshjeve midis ndërmarrjeve, vendimeve të bashkimit të ndërmarrjeve dhe praktikave të bashkërenduara (të referuara si

“marrëveshje”) të arritura si rezultat i negociemeve kolektive ndërmjet personave të vetëpunësuar dhe një ose disa ndërmarrjeve (“pala/ët”), në lidhje me kushtet e punës së personave të vetëpunësuar.

2. Neni 4 i Ligjit nr. 9121/2003 ndalon marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve që kufizojnë konkurrencën brenda tregut të brendshëm, veçanërisht kur ato caktojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi çmimet e blerjes ose të shitjes ose ndonjë kusht tjetër tregtimi.
3. Ndalimi i nenit 4 zbatohet për 'ndërmarrjet', i cili është një koncept i gjerë që mbulon çdo subjekt të angazhuar në një aktivitet ekonomik, pavarësisht nga statusi i tij ligjor dhe mënyra në të cilën financohet. Prandaj, personat e vetëpunësuar, edhe nëse janë individë që punojnë vetë, në parim janë ndërmarrje sipas kuptimit të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003, pasi ata ofrojnë shërbimet e tyre me pagesë në një treg të caktuar dhe kryejnë veprimtaritë e tyre si operatorë ekonomikë të pavarur.
4. Ky Udhëzim zbatohet për të gjitha format e negociemeve kolektive të kryera në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare, duke filluar nga negociemet përmes partnerëve socialë ose shoqatave të tjera deri tek negociemet e drejtpërdrejta nga një grup personash të vetëpunësuar ose përfaqësuesit e tyre me palën/t e tyre apo shoqatat e këtyre palëve. Udhëzimi mbulon gjithashtu rastet kur personat e vetëpunësuar, individualisht ose si grup, dëshirojnë të mbulohen nga një marrëveshje kolektive ekzistuese (“të bëhen palë”) e lidhur ndërmjet palës të tyre dhe një grupi punëtorësh/personash të vetëpunësuar.
5. Kushtet e punës të personave të vetëpunësuar përfshijnë çështje të tilla si pagesa, shpërblimet dhe shtesat, koha e punës dhe struktura e punës, pushimet, lejet, hapësirat fizike ku zhvillohet puna, shëndeti dhe siguria, sigurimet shoqërore e shëndetësore, dhe kushtet nën të cilat personat e vetëpunësuar kanë të drejtë të pushojnë së ofruari shërbimet e tyre ose nën të cilat pala ka të drejtë të pushojë së përdoruri shërbimet e tyre.
6. Negocimi dhe lidhja e marrëveshjeve kolektive para-supozon një shkallë të caktuar koordinimi midis palëve të shumta në secilën anë negociuese para negociemeve dhe lidhjes së marrëveshjes kolektive. Një koordinim i tillë mund të marrë formën e një marrëveshjeje, ose shkëmbimi informacioni, ndërmjet palëve në secilën palë negociuese, me qëllim që të vendoset për një qasje të përbashkët për çështjen (kushtet e punës) dhe/ose formën e negociemeve (p.sh., shumëpalëshe ose përmes emërimit të përfaqësuesve). Deri në masën që një koordinim i tillë është i nevojshëm dhe proporcional për negociimin ose lidhjen e marrëveshjes kolektive, ai do të trajtohet për qëllim të këtij Udhëzimi në të njëjtën mënyrë si marrëveshja kolektive me të cilën është i lidhur (ose do të ishte i lidhur në rast të negociemeve të pasuksesshme).

7. Ky Udhëzim nuk mbulon vendime të shoqatave apo marrëveshje ose praktika të bashkërenduara midis ndërmarrjeve jashtë kontekstit të negociemeve (ose përgatitjeve për negocieme) midis personave të vetëpunësuar dhe palës/ve të tyre për të përmirësuar kushtet e punës së personave të vetë-punësuar. Në veçanti, nuk mbulon marrëveshje që tejkalojnë rregullimin e kushteve të punës ose përcaktojnë kushtet (në veçanti, çmimet) nën të cilat shërbimet i ofrohen konsumatorëve nga personat e vetëpunësuar apo pala/ët, ose të cilat kufizojnë lirinë e ndërmarrjeve për të punësuar ofruesit e punës që u nevojiten.
8. Gjithashtu në këtë Udhëzim përcaktohen dhe kategoritë e marrëveshjeve kolektive që përfshijnë persona të vetëpunësuar, për të cilat sipas Autoriteti i Konkurrentes konsiderohen se janë jashtë objektit të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003, dhe përcakton kategoritë e marrëveshjeve kolektive në lidhje me për të cilat Autoriteti i Konkurrencës nuk do të ndërhyjë.
9. Ky Udhëzim shpjegon se si Autoriteti i Konkurrencës do të zbatojë Ligjin nr. 9121/2003, pa paragjykuar zbatimin e rregullave ose parimeve të tjera të kuadrit ligjor shqiptar, si dhe sqaron kushtet në të cilat disa persona të vetëpunësuar të vetëm dhe palët e tjera mund të hyjnë në negociata dhe marrëveshje kolektive pa rrezikuar të shkelin nenin 4 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Miratimin e Udhëzuesit “Për zbatimin e Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së personave të vetëpunësuar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 1094, Datë 11. 07. 2024

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME POGRADEC SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.07.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 205/6 prot., datë 21.06.2024, informon Autoritetin e Konkurrencës se me projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 16 prot., datë 16.05.2024, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjiellës dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas themelimit të ndërmarrjes rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA më datë 26.07.2022, bazuar në VKM nr. 302,

datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA”, rezultoi se:
3. Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë (FU), të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura (KUN) dhe tarifën fikse të shërbimit.
4. Ndërmarrja rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA aktualisht ushtron aktivitetin e saj sipas tarifave të miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese. Konkretisht sipas tarifave të miratuara sipas vendimit të KKRR nr. 99, datë 20.08.2020 për bashkinë Pogradec, Vendimin e KKRR nr. 75, datë 19.10.2018 për Bashkinë Prrenjas. Kjo ndërmarrje e riorganizuar në nivel rajonal synon ndryshimin e tarifave aktuale në një nivel të ri tarifor, me qëllimin e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar nivelin e kostove dhe përcaktimin e objektivave të treguesve kryesorë të performancës që ndërmarrja duhet të arrij në fund të vitit 2025 deri në 2027, për të ofruar një shërbim më cilësor tek konsumatori dhe që të përballoj kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes në nivelin 100% dhe të siguroj qëndrueshmërinë financiare.
5. Ndërmarrja rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që nuk arrijnë të mbulojnë 100% kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, kërkojnë të kenë një qëndrueshmëri financiare orë të përballuar investimet për rrjetin rural dhe urban të infrastrukturës përkatëse, përmirësimi i këtij treguesi është objektiv kryesor i ndërmarrjes për periudhën 2025 deri 2027. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon një nivel tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN, të cilat aplikohen jo në mënyrë uniforme për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga secila UK ekzistuese, por që tashmë janë pjesë e ndërmarrjes rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA.
6. Ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA propozon ndryshim të tarifave si rezultat i nevojës për përmirësim dhe qëndrueshmërinë e performancës financiare dhe mbulimin e kostove operationale në nivelin 100%; për shkak të rritje së çmimeve të materialeve; reduktimi i ujit pa të ardhura; përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ujit, rritjen e vazhdimësisë së furnizimit me ujë; realizimi i të ardhurave për përballimin e kostove shtesë.

7. Ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA ka kërkuar ndryshimin e tarifave, për shërbimin e FU dhe KUN referuar vlerësimit dhe analizës së kostove për ofrimin e këtij shërbimi.
8. Bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, të përcaktuara në Vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021 lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2025 deri në vitin 2027 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar reduktimin e humbjeve teknike dhe administrative, rritjen e qëndrueshmërisë financiare si edhe rritjen e mundësisë për përfitime të investimeve në shërbimet e ofruar.
9. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA pas miratimit të ndryshimit të tarifave do të ketë një nivel mbi 100% të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes totale, që varion nga 92.42% për vitin 2023 me një rritje deri në 126.1% në fund të vitit 2027. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara të FU dhe KUN si rezultat i investimeve të parashikuara. Tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësave, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit. Nevoja për të ardhura synon përmirësimin e nivelit të mbulimit total të kostove O&M, i cili parashikohet të jetë në nivelin 36.3% në fund të vitit 2027.
10. ERRU bazuar në projekt vendimin e miratimit të tarifave gjykon se ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA duhet ti kushtojë vëmendje të duhur për përmbylljen sa më parë të instalimit të matësave në prodhim dhe atyre familjare të parashikuara, për të gjithë klientët e zonës së shërbimit në mënyrë që të arrijë objektivin e vendosur nga ERRU për treguesit e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve; Të kryej vlerësimin e “Ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përfitohet dhe me pa ujëmatës; Të organizoj taks-forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Pogradec, për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit dhe abuzuesit kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zota rurale; Të trajtojnë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit me të dhënat sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më të saktë, për të patuar situatën reale mbi UPA dhe të bëhen korrigjimet përkatëse për vitin 2024 të Bilancit të ujit; Për aplikimin tarifor të radhës (jo më vonë se qershor 2027), duke qenë se shoqëria në fund të periudhës rregullatorë 2025-2027 do të arrijë të mbulojë 100% të kostos O&M, në këtë aplikim të prishëm shoqëria do të aplikojë sipas metodës “Çmimi tavan” të metodologjisë së tarifave, i cili kërkon që të jetë i detyrueshëm i shoqëruar me Planin e Biznesit 5 vjeçar i aprovuar paraprakisht nga ERRU. Për këtë qëllim shoqëria duhet të ketë parasysh që brenda vitit 2027 të ketë hartuar plan biznesin duke përdorur

si vit bazë të dhënat e certifikuara të vitit 2026, i cili duhet të shoqërohet me planet përkatëse të veprimit të mbështetura me projekte dhe me burimet e financimit; Të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara në të në mënyrë që të evitohen vjetrimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme për të zvogëluar humbjen nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet dhe çarjet.

11. Në aspektin ekonomik, ERRU gjykon se ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA duhet të mirëmbaj sistemet e informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara për t'u realizuar në vitin 2026 si dhe një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e radhës. Të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të asetëve sipas kërkesave të ERRU referuar ndarjes për këtë qëllim që ka bërë në këtë model aplikimi në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimit të parashikuar për t'u realizuar në vitin 2025-2027; Të hartojë një organigramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri; Treguesi i efikasitetit të stafit që lidhet me një nga elementët e rëndësishëm të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumente mbështetëse. Për këtë duke hartuar urgjentisht një organigramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numërin e punonjësve në shoqëri. Duke qenë se shoqëria në vitin e parë 2025 të periudhës rregullatore arrin të mbulojë rreth 108% të kostove të O&M, vlera 8% ose rreth 19.7 milion lekë e të ardhurave mbi mbulimin e 100% të kostove O&M duhet me prioritet të përdoret detyrimisht se pari për të shlyer vlerën prej 14.3 milion lekë detyrime të pagesave të huave të kredive me donatorë të huaj, më tej pjesa që mbetet (rreth 5.4 milion lekë) të përdoret për investimet e parashikuara që shoqëria planifikon ti mbulojë me të ardhurat e veta. Deficiti prej 8.1 milion lekë për të mbuluar totalisht investimet e parashikuara me investimet e veta duhet të mbulohet me burime të tjera financiare nga të tretë ose subvencione nga qeveria qendrore. Në aplikimin e radhës do të kërkohen dokumentet përkatëse mbështetëse që vërtetojnë përdorimin e tyre të cituar më sipër. Ti kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të këtyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi efikasitetin e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë. Për qytetin e Pogradecit, me një aktivitet intensiv turistik gjatë sezonit të verës, ku një pjesë e madhe e klientëve përbëhet nga pushues me shtëpi të dyta, në aplikimin e radhës shoqëria rekomandohet fuqimisht të aplikojë me tarifa me blloqe si mundësi e justifikuar për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të saj dhe planifikimin ku 30% e kostove të planifikohen të përballohen nga tarifat fikse.
12. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) bazuar në pikën 1/b të nenit 14 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë edhe të largimit të përpunimit të ujërave të ndotura”, ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe

kushtet e shërbimit, të ofruar nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësive të qeverisjes vendore. KKRR me anë të Vendimit nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, ka miratuar rregullat, procedurat, politikën tarifore dhe metodologjinë e vendosjes së tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura.

13. Mbështetur në nenet 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive dhe për arsye të interesit të përgjithshëm, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ.
14. Propozimet për ndryshim të tarifa të shërbimit nga ndërmarrja e Ujësllës Kanalizimeve janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit:
 - a. Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.
 - b. Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjellës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e: Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve; Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ; Tarifës së shërbimit.
 - c. Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
 - d. Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.
 - e. Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të

cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.

15. Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar disa vendime të marra nga ERRU për miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit nga ndërmarrje të Ujësjetllës Kanalizimeve.
16. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” SHA, i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 - a. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për Ndërmarrjen Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 - b. ERRU të kërkoj nga Ndërmarrjen Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 - c. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëj transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
17. Nga analiza e konkurrencës rezulton se ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, në kuptim të nenit 9 pika 1 e Ligjit nr. 9121/2003 ka detyrimin e mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar ERRU, si autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifave, orientimin e çmimeve të shërbimit drejt kostos për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA.
18. Në aplikimin për ndryshimin e tarifës për FU dhe KUN, ERRU, e gjen të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifor për tarifat variabël dhe fikse të FU dhe KUN për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA, por jo në nivelet që propozon Ndërmarrja. ERRU e ka bazuar analizën e përcaktimit të tarifave në Vendimin nr. 539, datë 30.12.2021” Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjetllës kanalizime” duke analizuar të dhënat që përcaktojnë tarifat (kostot operationale, vëllimet e faturave dhe numrin e klientëve) të realizuar në vitin bazë (viti 2023) dhe duke aplikuar koeficientin tarifor për përcaktimin e tarifave për kategoritë e klientëve jo familjarë.

19. Procedura e miratimit të tarifave nga ERRU, bazuar në pikën 1 të nenit 13 të Metodologjisë së miratimit të tarifave sipas Vendimit të KKRR nr. 539/2021 përmban dhe aprovimin e prezantimit për në Seancën Dëgjimore me Publikun të tarifave dhe zhvillimin e tyre. Sipas verifikimit të faqes zyrtare të web-it të Bashkisë Pogradec, Prrenjas si edhe të Ndërmarrjes Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA, konstatohet se seanca dëgjimore në lidhje me propozimin për ndryshim tarife kundrejt konsumatorëve familjarë, publik dhe jo familjarë, nuk janë publike, madje këshilli bashkiak Prrenjas ka votuar kundër këtij propozimi të UK Pogradec SHA.
20. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot për të dy shërbimet e ofruara, duke zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (b).
21. Konstatohet se vetëm vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, germa (d) e (f); 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

II. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.

3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec, ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA seancat e zhvilluara të dëgjesës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1095, Datë 11 .07. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, NGA SHOQËRITË GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB - STAR SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 07. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nga shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB - STAR SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nga ortakët themelues të saj, shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB - STAR SHPK dhe shitja e 34% të kuotave të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK të zotëruara nga shoqëria ALB-STAR SHPK tek shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nga shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB - STAR SHPK.

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 1075, datë 26.04.2024 “Mbi fillimin e procedurave të kontrollit të përqendrimeve për rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nga ortakët themelues të saj, shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB-STAR SHPK, si dhe transaksionin e shitjes së kuotave të shoqërisë ALB-STAR SHPK tek shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA, vendosi: 1. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga ortakët themelues të saj, shoqëria GR ALBANIA SHPK, shoqëria AGNA SHA dhe shoqëria ALB-STAR SHPK dhe 2. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi transaksionin e shitjes së kuotave të shoqërisë ALB-STAR SHPK tek shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Pala 1: AGNA SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: import-export të mallrave industriale e ushqimore, materiale ndërtimi, prodhime bujqësore dhe blegtorale, prodhim e shitje pije alkoolike; në fushën e investimit në ndërtim, në fushën e shitblerjes së trojeve për ndërtim, për turizëm, fshatra turistike, moteleri dhe hoteleri; tregtim import - eksport i produkteve dhe nënprodukteve të duhanit; shitblerje, marrje ose dhënie me qera të pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme; veprimtari trajnuese dhe certifikuese të punonjësve të administratës publike, punonjësve të institucioneve arsimore; auditimi, mbikëqyrja dhe certifikimi i zbatimit të standardeve ndërkombëtare për institucionet në përgjithësi dhe/ose personelin e tyre në veçanti etj.

Shoqëria AGNA SHA kontrollohej në vitin 2017 nga z. Kosta Sotiri me 32.5% të aksioneve, z. Vasil Naci me 32.5% të aksioneve, z. Kristo Naci me 30% të aksioneve dhe z. Aleksandër Naci me 5% të aksioneve.

Sipas të dhënave të QKB, shoqëria AGNA SHA në vitin 2017, ishte zotëruese e kuotave në shoqëritë: *HIDROBEGAJ SHPK, HYDROBORSH SHPK, ENERGO-SAS SHPK, ENERGI GRUP SHPK* dhe *The PLAZA Tirana SHPK*.

Pala 2: GR ALBANIA SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: 1. konsulencë mjedisore, përgatitja e studimeve dhe vlerësimeve mjedisore; monitorim dhe auditim i mjedisit; laborator testues për monitorimin e ujit, ajrit, tokës, zhurmave dhe verbimeve; 2. projektim, ndërtim, mbikëqyrje, kolaudim i impianteve të prodhimit të energjisë dhe prodhimi i saj nga uji, dielli (fotovoltaik), burimet termike, burime gjeotermale, era, biogazi, nafta dhe qymyri, për vete ose për të tretet; 3. menaxhimi i partneriteteve publike private, etj.

Shoqëria GR ALBANIA SHPK në vitin 2017 zotërohej nga Gentjan Filaj 38%, Realdo Mansaku 37%, Elton Kuka 13% dhe Henri Aleksis 12%.

Sipas të dhënave të QKB, shoqëria GR ALBANIA SHPK në vitin 2017 ishte zotëruese e kuotave

në shoqëritë: *EURUS SHPK*, *SolPower Albania SHPK* dhe *SHUSHICA HYDROPOWER SHPK*.

Pala 3: ALB-STAR SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ndërtim civile, industriale, tregti import - export; transport i mallrave për të tretë me qira dhe për llogari të vet brenda vendit; tregti me shumicë e ujit të pijshëm dhe e ujit industrial; menaxhim i mbetjeve jo të rrezikshme (aktivitet grumbullim dhe transport i mbetjeve jo të rrezikshme); hapja dhe menaxhimi i hoteleve "Strukturë Akomoduese 4 ose 5 yje", e godinave dhe ambienteve në të cilat ushtrohet aktivitetet hotelier, etj.

Shoqëria ALB-STAR SHPK, në vitin 2017, zotërohej 100% nga ortaku i vetëm FINMAN SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e organizuar si një shoqëri holding, e cila do të jetë zotëruese e kuotave në disa shoqëri të tjera dhe do të ofrojë asistencë për shoqëritë e zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga vetë shoqëria apo ortakët e saj.

Sipas të dhënave të QKB, shoqëria ALB-STAR SHPK në vitin 2017 ishte zotëruese e kuotave në shoqëritë: SHUSHICA HYDROPOWER SHPK dhe ECOCLEAN SHA.

Ndërmarrja e përbashkët (JV): GRABOVA HYDROPOWER SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ndërtimin e Hidrocentralit mbi Lumin Grabovë, të tipit BOT, (Ndërto-Opero-Transfero); prodhim, transmetim dhe shitje të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-i mbi Lumin Grabovë; shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e kaskadës si më sipër gjatë periudhës koncesionare.

Shoqëria GRABOVA HYDROPOWER SHPK nuk ka aktivitet dhe nuk ka gjeneruar të ardhura deri aktualisht.

II. Transaksioni

Më datë [.....], shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB-STAR SHPK kanë nënshkruar "Marrëveshje për bashkimin e përkohshëm të shoqërive" për pjesëmarrje në përzgjedhjen konkurruese në Dhënie me Koncesion të ndërtimit të Hidrocentralit Grabova 1.

Referuar kësaj kontrate, shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB-STAR SHPK, vendosën të konkurronin për ftesën për ofertë (me anë të një bashkimi të përkohshëm), të organizuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, për të marrë pjesë në përzgjedhjen konkurruese për Dhënie me Koncesion të Ndërtimit të "Hidrocentralit Grabova 1".

Marrëveshja parashikonte se nëse oferta e bashkimit të shoqërive, palë në këtë marrëveshje, do të rezultonte fituese, të tre shoqëritë do të themelonin një shoqëri të re brenda 1 muaji nga data e shpalljes së vendimit nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë në lidhje me konkurrimin publik. Duke qenë se oferta rezultoi fituese, palët themeluan shoqërinë e re, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, e cila u finalizua me nënshkrimin e statutit të saj më datë 20.09.2017, ku shoqëria GR ALBANIA SHPK zotëron 33% të aksioneve, shoqëria AGNA SHA zotëron 33% të aksioneve dhe shoqëria ALB – STAR SHPK zotëron 34% të aksioneve.

Më datë 20 nëntor 2017, shoqëria GRABOVA HYDROPOWER SHPK ose koncesionari (Subjekt për qëllime të veçanta) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues), kanë nënshkruar Kontratë Koncesioni e formës BOT (ndërtim – operim – transferim) për ndërtimin e Hidrocentralit “Grabovë 1”.

Afati i veprimtarisë së koncesionit do të jetë për një periudhë prej 35 vitesh, duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate prej palëve.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit, krijimi i ndërmarrjes GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, GR ALBANIA SHPK dhe ALB-STAR SHPK, nuk është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e konkurrencës

Ndërmarrja e përbashkët, GRABOVA HYDROPOWER SHPK është një shoqëri e themeluar për zbatimin e kontratës së Koncesionit, mes saj dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, Autoriteti Kontraktues (e ndryshuar) për Ndërtimin e Hidrocentralit mbi Lumin Grabovë, të tipit BOT, (Ndërto-Opero-Transfero); Prodhim, transmetim dhe shitje të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-i mbi Lumin Grabovë.

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë: tregun përkatës të produktit dhe tregun përkatës gjeografik.

Referuar objektit të aktivitetit të shoqërisë së përbashkët, gjykojmë *se tregu përkatës i produktit* do të konsiderohet tregu i energjisë elektrike. Referuar analizave të mëparshme në raste të ngjashme, Autoriteti i Konkurrencës e ka segmentuar këtë treg në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. *Treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i energjisë elektrike rregullohet me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, i cili përmban rregulla të përgjithshme për furnizimin e energjisë elektrike për konsumatorët, përmes krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë. Sistemi elektroenergjetik në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga: Prodhimi, Transmetimi, Shpërndarja e energjisë elektrike dhe Tregtimi me qëllim furnizimin e klientëve të energjisë elektrike.

Vlerësimi i konkurrencës në tregun e energjisë elektrike është mbështetur mbi treguesit ekonomik të sistemit energjetik të vitit 2017.

Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike në vend, gjatë vitit 2017, është realizuar tërësisht nga burime hidrike dhe prodhuesi më i madh ka qenë shoqëria publike KESH SHA. Subjektet private të licencuara në këtë aktivitet janë klasifikuar si: prodhuesit me përparësi, prodhuesit e pavarur dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike. Prodhuesit me përparësi dhe prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike janë subjekte të licencuara në vite nga ERE që shfrytëzojnë centralet ekzistuese apo të reja, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të privatizimit, marrëveshjeve të koncesionit apo kontratave për shfrytëzimin dhe administrimin e impianteve prodhuese të energjisë elektrike.

Prodhimi total neto vendas i energjisë elektrike, i realizuar për vitin 2017, ka qenë 4,525,173MWh, ku 65% e tij prodhohet nga centralet prodhuese hidro të KESH sh.a (prodhimi publik) dhe pjesa tjetër, 35% nga prodhuese hidro të tjerë.

Palët në transaksion nuk ushtrojnë drejtpërdrejtë aktivitet në tregun e prodhimit të energjisë elektrike, por referuar listës së subjekteve të licensuar nga ERE si prodhues të energjisë elektrike, u konstatua se, në vitin 2017, vetëm shoqëria AGNA SHA zotëronte ndërmarrje të licencuara, prodhuese të energjisë elektrike dhe konkretisht: shoqërinë HYDROBORSH SHPK, për prodhimin e energjisë nëpërmjet hidrocentralit në lumin Fterë, Sarandë dhe shoqërinë ENERGO SAS SHPK, për prodhimin e energjisë nëpërmjet hidrocentralit në ujërat e burimeve të Tatzatit, pjesa e sipërme e lumit të Kalasës, Sarandë.

Sipas Raportit vjetor të vitit 2017 nga ERE, konstatohet se në fashën e prodhimit të energjisë, në lidhjen 220 kv deri në 6kv⁵, ushtrojnë aktivitetin 98 subjekte dhe prodhimi i energjisë prej tyre ka qenë 1,608,181 MWh, ku pjesa e tregut që zotërojnë 2 ndërmarrjet e mësipërme ka qenë 1.52% e prodhimit. Në totalin e energjisë së prodhuar nga burimet hidrike, pjesa e tregut e dy shoqërive të kontrolluara nga shoqëria AGNA SHA është 0.54% e prodhimit në vend.

Kontrata e koncesionit e shoqërisë target GRABOVA HYDROPOWER SHPK, ka patur disa shtesa në vite dhe me shtesën e kontratës së koncesionit, datë 15 maj 2024, shoqëria koncesionare dhe Autoriteti Kontraktues ka rënë dakord për shtyrjen për 12 muaj të afatit për pajisjen më lejet e nevojshme për fillimin e punimeve të ndërtimit të HEC “Grabova1”.

Projekti është ende në fazën e ndërtimit të hidrocentralit dhe shoqëria target GRABOVA HYDROPOWER SHPK nuk ka filluar aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

Transmetimi i energjisë elektrike

Transmetimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) SHA, e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore. OST SHA është certifikuar dhe licencuar për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Në tregun e transmetimit, për vitin 2017, janë regjistruar 44 subjekte për ushtrim aktiviteti, zotërues të 77 licencave, nga të cilët 27 licenca i përkasin aktivitetit të furnizimit, 40 licenca janë

⁵ Prodhuesit me përparësi dhe prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike.

dhënë për aktivitetin e tregtimit, 11 licenca për aktivitetin e prodhimit dhe 1 licencë për atë të shpërndarjes.

Referuar listës së subjekteve të licencuar nga ERE, u konstatua se asnjë nga shoqëritë e kontrolluara nga palët në marrëveshjen e krijimit të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nuk është licencuar për aktivitetin e furnizimit, tregtimit, prodhimit apo shpërndarjen e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit.

Shpërndarja e energjisë elektrike

Shpërndarja e energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) SHA, e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore dhe është licencuar për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Shoqëritë e kontrolluara nga AGNA SHA, prodhuese të energjisë elektrike, prodhimin e realizuar e shesin nëpërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Në përfundim të analizës së konkurrencës, u konstatua se krijimi i ndërmarrjes së përbashkët, me funksione të plota GRABOVA HYDROPOWER SHPK, është ende në fazën e ndërtimit të hidrocentralit dhe nuk është pajisur me licencë specifike për prodhimin e energjisë elektrike.

Transaksioni i krijimit të një shoqërie të përbashkët me funksione të plota, e cila pritet të jetë aktive në tregun e energjisë elektrike (në prodhimin e energjisë) do të sjellë përfitime për konkurrencën pasi do të këtë për rrjedhojë hyrjen e një konkurenti të ri në treg.

Vetëm shoqëria AGNA SHA, njëra nga palët në krijimin e shoqërisë së përbashkët, ka prezencë juridike dhe realizon të ardhura në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet shoqërisë HYDROBORSH SHPK dhe ENERGO SAS SHPK, të licencuara në prodhimin e energjisë elektrike në tensionin 35 KV.

Pjesa e tregut që kanë zotëruar këta dy prodhues gjatë vitit 2017, përbënte vetëm 1.52% të prodhimit nga Subjektet private të licencuara/koncesionar dhe 0.54% të prodhimit në vend të energjisë elektrike.

Prezenca në tregun e prodhimit të energjisë elektrike e shoqërive të kontrolluara nga shoqëria AGNA SHA, nuk do të sjellë shqetësime për konkurrencën, pasi pjesa e tregut që ato zotërojnë është shumë e vogël dhe për më tepër nuk krijohet mbivendosje e pjesëve të tregut nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në transaksion apo ndërmarrjet e lidhura mes tyre.

Për sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nga shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB - STAR SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1096, Datë 11 . 07. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET SHITBLERJES SË 34% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË GRABOVA HYDROPOWER SHPK NGA SHOQËRIA GJOKA KONSTRUKSION SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 07. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 34% të kapitalit të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nga ortakët themelues të saj, shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB - STAR SHPK dhe shitja e 34% të kuotave të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK të zotëruara nga shoqëria ALB-STAR SHPK tek shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e shitjes së 34% të kuotave të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK, të zotëruara nga shoqëria ALB - STAR SHPK tek shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA.

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 1075, datë 26.04.2024 “Mbi fillimin e procedurave të kontrollit të përqendrimeve për rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nga ortakët themelues të saj, shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB-STAR SHPK, si dhe transaksionin e shitjes së kuotave të shoqërisë ALB-STAR SHPK tek shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA, vendosi: 1. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga ortakët themelues të saj, shoqëria GR ALBANIA SHPK, shoqëria AGNA SHA dhe shoqëria ALB-STAR SHPK dhe 2. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi transaksionin e shitjes së kuotave të shoqërisë ALB-STAR SHPK tek shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Pala Blerëse: GJOKA KONSTRUKSION SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti prodhimin e materialeve të ndërtimit, inerteve, betonit të markave të ndryshme, të parafabrikateve të betonit, prodhimin të asfaltit; importimin dhe/ose eksportimin e karburanteve, të lëndëve djegëse për përdorim familjar ose industrial, të vajrave dhe / ose lëndëve lubrifikuese; ngritjen dhe funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante; zhvillimi dhe kryerja e aktivitetit të shërbimeve, konsulencës dhe studimeve e projekteve të çdo lloji etj.

GJOKA KONSTRUKSION SHA në vitin 2021 zotërohej nga aksionari i vetëm z. Rrok Gjoka.

Sipas të dhënave të QKB, shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA në vitin 2021, ishte zotëruese e kuotave në shoqëritë: DITEKO SHPK, Gjoka Konstruksion – ENERGI SHPK, GJOKA 87 SHPK dhe Bondcom Energy Point SHPK (kjo e fundit në Kosovë).

Pala Shitëse: ALB-STAR SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ndërtime civile, industriale, tregti import - export; transport i mallrave për të tretë me qira dhe për llogari të vet brenda vendit; tregti me shumicë e ujit të pijshëm dhe e ujit industrial; menaxhim i mbetjeve jo të rrezikshme (aktivitet grumbullim dhe transport i mbetjeve jo të rrezikshme); hapja dhe menaxhimi i hoteleve "Strukturë Akomoduese 4 ose 5 yje", e godinave dhe ambienteve në të cilat ushtrohet aktivitetet hotelier, etj.

Shoqëria ALB-STAR SHPK, zotërohet 100% nga ortaku i vetëm FINMAN SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e organizuar si një shoqëri holding, e cila do të jetë zotëruese e kuotave në disa shoqëri të tjera dhe do të ofrojë asistencë për shoqëritë e zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga vetë shoqëria apo ortakët e saj.

Shoqëria Target: GRABOVA HYDROPOWER SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ndërtimin e Hidrocentralit mbi Lumin Grabovë, të tipit BOT, (Ndërto-Opero-Transfero); prodhim, transmetim dhe shitje të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-i mbi Lumin Grabovë; shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e kaskadës si më sipër gjatë periudhës koncesionare.

Në vitin 2021, shoqëria GRABOVA HYDROPOWER SHPK kontrollohej bashkërisht nga shoqëritë AGNA SHA 33%, GR ALBANIA SHPK 33% dhe ALB – STAR SHPK 34%.

Shoqëria GRABOVA HYDROPOWER SHPK nuk ka aktivitet dhe nuk ka gjeneruar të ardhura deri aktualisht.

II. Transaksioni

Më datë [.....], ndërmjet shoqërive GJOKA KONSTRUKSION SHA (blerësi) dhe ALB – STAR SHPK (shitësi) është nënshkruar “Kontratë Shitblerje Kuote”.

Shitësi është ortak i shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK dhe zotërues i 1 (një) kuote, që i korrespondon 34% të kapitalit të saj.

Shitësi dhe njëherazi ortak i shoqërisë, i ka shitur blerësit kuotën që ai zotëron në shoqërinë GRABOVA HYDROPOWER SHPK, përkundrejt çmimit të shitjes.

Shitja e kuotave është njoftuar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues), e cila ka miratuar transferimin e 34% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë koncesionare “Grabova Hydropower” SHPK të zotëruara nga shoqëria ALB - STAR SHPK në favor të shoqërisë GJOKA KONSTRUKSION SHA, me kushtin që të ruhet emri i shoqërisë koncesionare GRABOVA HYDROPOWER SHPK, si dhe të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Kontratën e Koncesionit të formës BOT, për ndërtimin e hidrocentralit “Grabovë 1” të ndryshuar, pasi në të kundërt transferimi i pjesëve të kapitalit është i pavlefshëm.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria GRABOVA HYDROPOWER SHPK zotërohet nga GR ALBANIA SHPK 33%, AGNA SHA 33% dhe GJOKA KONSTRUKSION SHA 34%.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe pikës 78 të Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit, krijimi i ndërmarrjes GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, GR ALBANIA SHPK dhe ALB-STAR SHPK, nuk është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e konkurrencës

Ndërmarrja e përbashkët, GRABOVA HYDROPOWER SHPK është një shoqëri e themeluar për

zbatimin e kontratës së Koncesionit, mes saj dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, Autoriteti Kontraktues (e ndryshuar) për Ndërtimin e Hidrocentralit mbi Lumin Grabovë, të tipit BOT, (Ndërto-Opero-Transfero); Prodhim, transmetim dhe shitje të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-i mbi Lumin Grabovë.

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë: tregun përkatës të produktit dhe tregun përkatës gjeografik.

Referuar objektit të aktivitetit të shoqërisë së përbashkët, gjykojmë *se tregu përkatës i produktit* do të konsiderohet tregu i energjisë elektrike. Referuar analizave të mëparshme në raste të ngjashme, Autoriteti i Konkurrencës e ka segmentuar këtë treg në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarja së energjisë elektrike. *Treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i energjisë elektrike rregullohet me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, i cili përmban rregulla të përgjithshme për furnizimin e energjisë elektrike për konsumatorët, përmes krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë. Sistemi elektroenergjitik në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga: Prodhimi, Transmetimi, Shpërndarja e energjisë elektrike dhe Tregtimi me qëllim furnizimin e klientëve të energjisë elektrike.

Analiza e strukturave të tregut është mbështetur në të dhënat ekonomike të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) dhe OST për sektorin e energjisë elektrike për vitin 2021.

Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike, i realizuar për vitin 2021 nga KESH SHA, zë 59.6% të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë rreth 40.4%. Prodhimi nga centralet fotovoltaike ka qenë vetëm 40,756MWh ose 0.5% e prodhimit total të energjisë elektrike.

Palët në transaksion nuk ushtrojnë drejtpërdrejtë aktivitetet në tregun e prodhimit të energjisë elektrike, por referuar listës së subjekteve të licencuar nga ERE si prodhues të energjisë elektrike, u konstatua se, në vitin 2021, janë të pajisur më licencë në tregun e energjisë elektrike shoqëritë e kontrolluara nga shoqëria AGNA SHA; konkretisht HYDROBORSH SHPK, për prodhimin e energjisë nëpërmjet hidrocentralit në lumin Fterë, Sarandë, por nuk evidentohet nga raportet e ERE, prodhim i energjisë elektrike për vitin 2021 dhe ENERGO SAS SHPK, për prodhimin e energjisë nëpërmjet hidrocentralit në ujërat e burimeve të Tatzatit, pjesa e sipërme e lumit të Kalasës, Sarandë dhe shoqëritë e kontrolluara nga GJOKA KONSTRUKSION SHPK në tregun e energjisë elektrike; konkretisht shoqëria Gjoka Konstruksion – ENERGI SHPK, për prodhimin e energjisë nëpërmjet hidrocentralit në lumin Shalë dhe Strelce dhe DITEKO SHPK, për prodhimin e energjisë nëpërmjet hidrocentralit në lumin Zalli i Okshtunit, rrethi Bulqizë.

Referuar të dhënave të ERE-s, volumi total i prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëritë e

kontrolluara nga AGNA SHA dhe GJOKA KONSTRUKSION SHA ka qenë 156,288 MWH, e cila përbënte 4.32 % të prodhimit të energjisë nga Prodhues të Pavarur dhe ata me Përparësi. Ndaj totalit të energjisë së prodhuar, pjesa e tregut e shoqërive të mësipërme është 1.74% e prodhimit në vend.

Transmetimi i energjisë elektrike

Transmetimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) SHA, e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore. OST SHA është çertifikuar dhe licencuar për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Në regjistrin e OST deri në fund të vitit 2021, kanë qenë të regjistruar si palë të tregut të energjisë 46 subjekte me status aktiv, të cilët përmbajnë 73 licenca aktive të rolit të tyre në tregun e energjisë, mes tyre edhe shoqëria DITEKO SHPK.

Shpërndarja e energjisë elektrike

Shpërndarja e energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) SHA, e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore dhe është licencuar për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Referuar subjekteve të licencuara për tregtim, rezulton se shoqëria DITEKO SHPK është pajisur me licencë tregtimi të energjisë elektrike, me afat 30 vjeçar dhe shoqëria Gjoka Konstruksion-ENERGJI SHPK është pajisur me licencë tregtimi të energjisë elektrike, me afat 30 vjeçar.

Në përfundim të analizës së konkurrencës, u konstatua se blerja e 34% të kuotave të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA përbënte një përqendrim, pasi transaksioni ka për pasojë hyrjen e një ortaku kontrollues në shoqërinë target.

Blerësi, shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA, ka prezencë juridike dhe kryen aktivitet në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj, Gjoka Konstruksion-ENERGJI SHPK dhe DITEKO SHPK, mbajtëse të kontratave koncesionare në këtë treg, të licencuara në prodhimin e energjisë elektrike në tensionin 35 KV.

Ndërkohë edhe shoqëria AGNA SHA, njëra nga ortakët e shoqërisë target, ka prezencë juridike në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet shoqërive HYDROBORSH SHPK dhe ENERGO SAS SHPK, të licencuara në prodhimin e energjisë elektrike në tensionin 35 KV.

Transaksioni i blerjes së 34% të kuotave të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA, indirekt, nëpërmjet shoqërive të kontrolluara krijon mbivendosje të aktivitetit të palëve në tregun e prodhimit të energjisë elektrike. Nga të dhënat e ERE-s për prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2021, rezulton se pjesa e kombinuar e tregut e shoqërive të kontrolluara nga shoqëritë AGNA SHA dhe GJOKA KONSTRUKSION SHA përbën 4.32% të prodhimit të energjisë nga Prodhues të Pavarur dhe ata me Përparësi dhe 1.74% e prodhimit total të energjisë së prodhuar në vend.

Shoqëria target, GRABOVA HYDROPOWER SHPK është ende në fazën e ndërtimit të hidrocentralit dhe nuk është aktive në tregun e energjisë elektrike, për pasojë nuk do të ndikojë në pjesën e tregut të shoqërive të kontrolluara nga ortakët e saj.

Për sa më sipër, transaksioni i blerjes së 34% kuotave të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 34% të kapitalit të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1097, Datë 11. 07. 2024

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe GJOKA KONSTRUKSION SHA, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET SHITBLERJES SË 34% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË GRABOVA HYDROPOWER SHPK NGA SHOQËRIA GJOKA KONSTRUKSION SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim Kraja	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 07. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i sjelljes së ortakëve të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 34% të kapitalit të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, nenet 53, nenet 73 dhe 75 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nga shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB - STAR SHPK dhe shitja e 34% të kuotave të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK të zotëruara nga shoqëria ALB-STAR SHPK tek shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA.

VËREN SE :

I. Procedura

Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr. 232 prot. i AK, datë 12.03.2024 “Kërkesë për informacion”, dërguar nga një media televizive, është njoftuar mbi transaksionin e shitjes së

kuotave të shoqërisë ALB-STAR SHPK tek shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA.

Me vendimin nr. 1075, datë 26.04.2024 “Mbi fillimin e procedurave të kontrollit të përqendrimeve për rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nga ortakët themelues të saj, shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB-STAR SHPK, si dhe transaksionin e shitjes së kuotave të shoqërisë ALB-STAR SHPK tek shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA, Komisioni i Konkurrencës vendosi: 1. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga ortakët themelues të saj, shoqëria GR ALBANIA SHPK, shoqëria AGNA SHA dhe shoqëria ALB-STAR SHPK dhe 2. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi transaksionin e shitjes së kuotave të shoqërisë ALB-STAR SHPK tek shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA.

Në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës, me shkresën nr. 232/10 prot., datë 03.06.2024 “Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimit”, shoqëria GRABOVA HIDROPOWER SHPK, dorëzoi dokumentacionin e parashikuar në rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” dhe Sekretariati filloi procedurat e kontrollit të përqendrimeve.

Referuar dokumentacionit të depozituar rezultoi se më datë [.....], ndërmjet shoqërive GJOKA KONSTRUKSION SHA (blerësi) dhe ALB – STAR SHPK (shitësi) është nënshkruar “Kontratë Shitblerje Kuote”.

Shitësi është ortak i shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK dhe zotërues i 1 (një) kuote, që i korrespondon 34% të kapitalit të saj.

Shitësi dhe njëherazi ortak i shoqërisë, i ka shitur blerësit kuotën që ai zotëron në shoqërinë GRABOVA HYDROPOWER SHPK, përkundrejt çmimit të shitjes.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues) ka miratuar transferimin e 34% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë koncesionare “Grabova Hydropower” SHPK të zotëruara nga shoqëria ALB - STAR SHPK në favor të shoqërisë GJOKA KONSTRUKSION SHA, me kushtin që të ruhet emri i shoqërisë koncesionare GRABOVA HYDROPOWER SHPK, si dhe të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Kontratën e Koncesionit të formës BOT, për ndërtimin e hidrocentralit “Grabovë 1” të ndryshuar, pasi në të kundërt transferimi i pjesëve të kapitalit është i pavlefshëm.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria GRABOVA HYDROPOWER SHPK zotërohet nga GR ALBANIA SHPK 33%, AGNA SHA 33% dhe GJOKA KONSTRUKSION SHA 34%.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Njoftimi i përqendrimit në shkelje të afatit ligjor

Bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, një përqendrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

Sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftim: a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim; b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera; c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, në pikën 130 citohet se: Të gjitha përfitimet e kontrollit të përbashkët duhet të njoftohen në mënyrë të përbashkët nga ndërmarrjet përfutuese të këtij kontrolli, aksionarët e rinj dhe ekzistues. Në rastin e blerjes së 34% të kuotave të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA, ortakët e shoqërisë duhet të njoftojnë bashkërisht përqendrimet që shkaktojnë këto ndryshime të situatave të kontrollit të përbashkët.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” kanë patur detyrimin për njoftim shoqëritë GJOKA KONSTRUKSION SHA, AGNA SHA dhe GR ALBANIA SHPK.

Më datë [.....], ndërmjet shoqërive GJOKA KONSTRUKSION SHA (blerësi) dhe ALB – STAR SHPK (shitësi) është nënshkruar “Kontratë Shitblerje Kuote” dhe në zbatim të nenit 12, pika 2 e ligjit, palët kanë patur detyrimin për njoftim sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit, brenda 30 ditëve duke filluar nga data [.....].

Për mos respektim të afatit të përcaktuar, bazuar në nenin 73, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendos gjobë në masën jo më shumë se 1% të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet apo grupimet e ndërmarrjeve nëse nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij Ligji.

Neni 18 i ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, specifikon se: organi që shqyrton kundërvajtjen administrative duhet të marrë parasysh: a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes; b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë; c) rëndësinë e kundërvajtjes; ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

Për të vlerësuar rëndësinë/gravitetin e shkeljen Komisioni i Konkurrencës ka marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Njoftimi është bërë me iniciativën e Autoritetit të Konkurrencës,
- Procedura është kryer pasi ka kaluar 6 muaj nga parashikimi i nenit 12, pika 2 e ligjit,
- Përqendrimi vlerësohet si përqendrim horizontal,

Mbështetur në konkluzionet e vlerësimit të konkurrencës në treg pas përqendrimit është konstatuar

se transaksioni i realizuar nuk ka impakt në konkurrencën në treg, pasi ndërmarrja e përbashkët, GRABOVA HYDROPOWER SHPK ende nuk ka përfunduar projektin e ndërtimit të hidrocentralit dhe nuk është aktive në tregun përkatës të produktit, dhe për pasojë mos njoftimi nuk ka sjellë prishje të konkurrencës në treg.

Referuar nenit 15 të ligjit nr. 9121/2003, rezulton se xhiroja e shoqërive palë në marrëveshje është në vlerën rreth [.....] lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neni 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 34% të kapitalit të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA, vendosjen e gjobës mbi:
 - a) shoqërinë AGNA SHA, në masën [.....] lekë,
 - b) shoqërinë GR ALBANIA SHPK, në masën [.....] lekë,
 - c) shoqërinë GJOKA KONSTRUKSION SHPK, në masën [.....] lekë,
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.
3. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1098, Datë 29 . 07. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L. NGA SHOQËRITË VIKKA VTTI S.P.A. DHE SNAM S.P.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29 . 07. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L. nga shoqëritë VIKKA VTTI S.p.A. dhe SNAM S.P.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L. nga shoqëritë VIKKA VTTI S.p.A. dhe SNAM S.P.A.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L. nga shoqëritë VIKKA VTTI S.p.A. dhe SNAM S.P.A.

Referuar dokumenteve të depozituara nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:

Blerësit:

VIKA VTTI S.p.A (në proces të ndryshimit të emrit në VTTI LNG Italy S.p.A.) është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian, e kontrolluar në mënyrë indirekte nga VTTI B.V.

VTTI B.V. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar private, e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës, e cila zotëron, administron, operon dhe zhvillon asete të infrastrukturës energjetike në nivel kombëtar, me fokus në sigurinë dhe qëndrueshmërinë. VTTI zotërohet në mënyrë indirekte nga Vitol Holding II S.A. dhe IFM Investors Pty Ltd, në cilësinë e saj si këshilltare e Fondit Global të Infrastrukturës IFM.

SNAM S.P.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë, i cili zotëron operatorin kryesor të sistemit të transmetimit të gazit në Itali dhe ka interesa në shoqëri aktive në tregjet e transmetimit, rigazifikimit dhe ruajtjes së gazit edhe në vende të tjera të BE-së. SNAM S.P.A. është e listuar në bursën italiane dhe kontrollohet në mënyrë të tërthortë nga CDP.

SNAM S.P.A. është prezente në Shqipëri, indirekt, nëpërmjet shoqërisë Albanian Gas Service Company SHA, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e krijuar si një shoqëri plotësisht operative, e cila është përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë, mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes për Mirëmbajtjen, që do të lidhet ndërmjet kësaj shoqërie dhe Trans Adriatic Pipeline AG, si edhe çdo veprimtari ndihmëse që mund të jetë e nevojshme ose e dobishme për arritjen dhe ushtrimin e këtij qëllimi.

SNAM S.P.A. zotëron 25% të Albanian Gas Service Company SHA.

VTTI B.V. dhe SNAM S.P.A. nuk janë aktive në tregun e infrastrukturës së importit të gazit, por kanë realizuar të ardhura indirekt për vitin 2023.

Shoqëria Target: TERMINALI GNL ADRIATICO S.R.L. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë, me objekt aktiviteti zotërimi dhe operimi i një terminali rigazifikimi të GNL në detin Adriatik në provincën e Rovigos, Itali. TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L. ofron shërbime të rigazifikimit të GLN-së (përfshirë ngarkimin, depozitimin, fleksibilitetin, matjen dhe shërbimet detare).

TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L. aktualisht kontrollohet nga ExxonMobil Italiana Gas SRL (rreth 70.7%), Qatar Terminal Limited (rreth 22%) dhe SNAM S.p.A. rreth 7.3%.

TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L. është aktive vetëm në Itali.

II. Transaksioni

Më datë [.....], dega e VTTI B.V., VIKKA VTTI S.p.A., ExxonMobil Italiana Gas SRL dhe Qatar Terminal Limited përfunduan “Marrëveshje e shitblerjes së kuotave”, për të blerë pjesëmarrjet përkatëse të ExxonMobil Italiana Gas SRL dhe Qatar Terminal Limited, në shoqërinë target TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L.

Referuar deklarimeve të palës njoftuese në Formularin e thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit,

marrëveshja e mësipërme shkaktoi aktivizimin e së drejtës së parablerjes së SNAM S.P.A., për të rritur pjesëmarrjen e saj në shoqërinë target në 30%, duke dërguar një njoftim blerjeje tek ExxonMobil Italiana Gas SRL dhe Qatar Terminal Limited, me anë të të cilit pranoi termat dhe kushtet e VTTI S.P.A.

Më datë [.....], SNAM S.P.A., ExxonMobil Italiana Gas SRL dhe Qatar Terminal Limited, përfunduan “Marrëveshje e shitblerjes së kuotave”, një marrëveshje e veçantë, duke pasqyruar termat dhe kushtet e Marrëveshjes së shitblerjes së kuotave, datë [.....].

Pas realizimit të transaksionit, VIKKA VTTI S.p.A. dhe SNAM S.P.A. do të përfundojnë “Marrëveshjen e Aksionarëve”, [.....].

Pas përfundimit të transaksionit, VIKKA VTTI S.p.A. do të mbajë një kuotë që përfaqëson 70% të kapitalit të shoqërisë target TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L., ndërsa SNAM S.p.A. do të mbajë një kuotë që përfaqëson 30%-in e mbetur.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim, nëpërmjet përfuturimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë target, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë, është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i infrastrukturës së importit të gazit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfuturimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L. nga shoqëritë VIKKA VTTI S.p.A. dhe SNAM S.P.A.

VIKA VTTI S.p.A kontrollon indirekt nga VTTI B.V.

VTTI B.V. nuk është aktive në Shqipëri. Shoqëria mëmë e saj, Vitol Holding II S.A., është aktive në furnizimin me shumicë të gazit natyror, por në vitin 2023 nuk ka realizuar shitje në Shqipëri. Për vitin 2023, shitjet janë realizuar nga ndërmarrjet e kontrolluara prej saj.

SNAM nuk është aktiv në tregun përkatës në Shqipëri. SNAM kontrollon infrastruktura të ndryshme, duke përfshirë tubacionet dhe terminallet e importit të GNL-së, të përdorura për importimin e gazit natyror në Itali. Ajo është gjithashtu aktive në transmetimin dhe ruajtjen e gazit natyror.

TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L. është aktive në tregun e infrastrukturës për importin e gazit në Itali, por jo në Shqipëri. Aktualisht, nuk ka terminale GNL funksionale në Shqipëri.

Asnjë nga Palët nuk angazhohet në territorin shqiptar, në asnjë nga aktivitetet e gazit natyror si:

prodhim dhe kërkim i gazit natyror; furnizimi me gaz me shumicë; infrastruktura e importit të gazit; magazinimi i tij; tregtimi i gazit në qendrën e gazit etj.

Nga sa më sipër, Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L., nga shoqëritë VIKKA VTTI S.p.A. dhe SNAM S.P.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1099, Datë 29. 07. 2024

**“KËRKESË PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT NGA ANA E
NDËRMARRJES ARLIS ADMINISTRIM SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 07. 2024 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Kërkesë për sigurimin e informacionit nga ana e ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 33 pika 2 dhe pika 3 dhe neni 73 pika 1, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE :

- 1- Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 10 maj 2024.
- 2- Në zbatim të nenit 33, të Ligjit nr. 9121/2003, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, për realizimin e procedurave hetimore për vlerësimin e konkurrencës në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit, me shkresën nr. 23/77 prot., datë 11.06.2024 “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK për sigurimin e informacionit në lidhje me: (a) *Komplekset e pallateve/pallatet që ju administroni për*

periudhën 01 janar 2020 deri në 10 maj 2024 duke specifikuar emrin e tyre, adresat e sakta dhe numrin e hyrjeve që ka secili; (b) Numrin dhe emrin e ndërmarrjeve që ofrojnë shërbimin e internetit në secilin kompleks që ju administroni për periudhën 01 janar 2020 deri në 10 maj 2024; (c) Në komplekset e pallateve/pallatet që ju administroni, cila ndërmarrje ka ndërtuar rrjetin për shërbimin e internetit, deri në pikën e aksesit në infrastrukturën fizike në godinat e banimit? (d) Kontratat e lidhura me operatorët që ofrojnë shërbimin e internetit për periudhën 01 janar 2020 deri në 10 maj 2024, me afat për kthim - përgjigje brenda datës 25.06.2024. Ndërmarrja Arlis Administrim SHPK nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.

- 3- Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 23/105 prot., datë 09.07.2024 “Rikujtesë mbi Kërkesë për informacion nr. 23/77 prot., datë 11.06.2024”, i është drejtuar përsëri ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK për sigurimin e të dhënave të mësipërme brenda datës 23.07.2024. Ndërmarrja Arlis Administrim SHPK nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.
- 4- Komisioni i Konkurrencës, gjykon se informacioni i kërkuar është shumë i rëndësishëm për realizimin e procedurave hetimore, pasi përmban informacion mbi veprimtarinë mes dy ndërmarrjeve për të cilat është hapur dhe procedura hetimore.
- 5- Në zbatim të nenit 33, pika 2 dhe pika 3 të Ligjit nr. 9121/2003, kur ndërmarrja nuk jep të dhënat e kërkuara, brenda periudhës së caktuar në kërkesën e Sekretariatit, Komisioni, kur e vlerëson të nevojshme, i kërkon të dhënat nëpërmjet një vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 33 pika 2 dhe pika 3 dhe nenin 73 pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. T’i kërkojë ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin si më poshtë vijon:
 - (a) *Komplekset e pallateve/pallatet që ju administroni për periudhën 01 janar 2020 deri në 10 maj 2024 duke specifikuar emrin e tyre, adresat e sakta dhe numrin e hyrjeve që ka secili;*

- (b) Numrin dhe emrin e ndërmarrjeve që ofrojnë shërbimin e internetit në secilin kompleks që ju administroni për periudhën 01 janar 2020 deri në 10 maj 2024.*
- (c) Në komplekset e pallateve/pallatet që ju administroni, cila ndërmarrje ka ndërtuar rrjetin për shërbimin e internetit, deri në pikën e aksesit në infrastrukturën fizike në godinat e banimit?*
- (d) Kontratat e lidhura me operatorët që ofrojnë shërbimin e internetit për periudhën 01 janar 2020 deri në 10 maj 2024.*

II. Informacioni i përcaktuar në pikën I, duhet të dorëzohet brenda afatit 15 ditor nga dita që ky vendim është njoftuar.

III. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në dispozitivin I dhe II të këtij vendimi, ndërmarrja Arlis Administrim SHPK ndëshkohet me gjobë në masën jo më shumë se deri në 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar për shkelje të lehtë të konkurrencës në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1100 , Datë 29. 07. 2024

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT
TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DS SMITH PLC NGA SHOQËRIA
INTERNATIONAL PAPER COMPANY”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 07. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DS SMITH PLC nga shoqëria INTERNATIONAL PAPER COMPANY.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë DS SMITH PLC, nga shoqëria INTERNATIONAL PAPER COMPANY.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë DS SMITH PLC, nga shoqëria INTERNATIONAL PAPER COMPANY.

Referuar dokumentit “Marrëveshjes së Bashkëpunimit” dhe dokumentit “Kombinimi i rekomanduar mbi të gjitha aksionet”, nënshkruar më datë [.....], palët në marrëveshje janë:

Ofertuesi: INTERNATIONAL PAPER COMPANY është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Shtetit të New York, e themeluar nga William Augustus Russell dhe Hugh Joseph Chisholm I. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është: të mbajë, drejtojë dhe menaxhojë biznesin e prodhimit, blerjes, shitjes dhe duke përfshirë të gjitha llojet e pulpit dhe letrës, çdo përbërës, produktet dhe komponimet e tyre ose artikuj që përbëhen pjesërisht prej tyre dhe çdo material që do të përdoret në lidhje me ndonjë prodhim të tillë, duke përfshirë çdo fije, të prodhojë lëndë drusore etj.

Shoqëria INTERNATIONAL PAPER COMPANY nuk ka asnjë filial të regjistruar në Shqipëri, por ka gjeneruar të ardhura nëpërmjet shitjeve të eksportit të ambalazhit të valëzuar në Shqipëri.

Target: DS SMITH PLC është një shoqëri publike me përgjegjësi të kufizuar, aksionet e së cilës tregtohen në tregun kryesor të Bursës së Londrës, nën emrin DS SMITH PLC, e themeluar sipas legjislacionit të Anglisë dhe Uellsit.

DS SMITH PLC është shoqëria fundore mëmë e grupit të shoqërive DS SMITH Group, e cila është aktive kryesisht në prodhimin dhe shitjen e ambalazheve të valëzuar në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Zonën Ekonomike Evropiane. DS SMITH Group mbledh gjithashtu letër të përdorur dhe kartonë të valëzuar, për të prodhuar letër të ricikluar për ambalazhim të valëzuar.

Shoqëria DS SMITH PLC nuk ka asnjë filial të regjistruar në Shqipëri, por ka gjeneruar të ardhura nëpërmjet shitjeve të eksportit të ambalazhit të valëzuar.

II. Transaksioni

Më datë [.....], nga Bordi Drejtorëve të shoqërisë INTERNATIONAL PAPER COMPANY (Ofertuesi) dhe DS SMITH PLC (Target), është nënshkruar, “Marrëveshje Bashkëpunimi” dhe dokumenti “Kombinimi i rekomanduar mbi të gjitha aksionet”.

Ofertuesi dhe Target kanë për qëllim që menjëherë pas ekzekutimit të kësaj Marrëveshje, të njoftojnë kombinimin e rekomanduar të aksioneve të Ofertuesit dhe Targetit, me objektin dhe afatet sipas kushteve të përcaktuara në këtë Njoftim.

Kombinimi synohet të realizohet përmes një skeme të rregullimit të shoqërisë DS SMITH PLC, në përputhje me pjesën 26 të aktit të shoqërive (Skema) të vitit 2006 sipas legjislacionit Anglez, shoqëria International Paper Company rezervon të drejtën, sipas Njoftimit dhe kësaj Marrëveshje, për të zgjedhur dhe zbatuar Kombinimin përmes një oferte.

Sipas Marrëveshjes palët bien dakord që: (i) Dokumentet e Prokurës së Ofertuesit do t’u dërgohen aksionerëve të ofertuesit; dhe (ii) Prospekti i Ofertuesit do të publikohet, në secilin rast, në të njëjtën kohë ose afërsisht në të njëjtën kohë kur Dokumenti i Skemës u dërgohet Aksionarëve të shoqërisë Target.

Pas marrjes së miratimeve të nevojshme, Transaksioni i propozuar do të mbetet i kushtëzuar nga plotësimi i kushteve të mbetura, siç përcaktohet në Njoftimin e Ofertës së Përvokueshme, duke

përfshirë miratimet antitrust dhe miratimin e skemës nga gjykatat angleze.

Pas përfundimit të shit-blerjes, aksionarët e DS SMITH PLC do të zotërojnë afërsisht 33.7% dhe aksionarët e International Paper Company do të zotërojnë rreth 66.3% të shoqërisë së shit-blerjes. Në lidhje me shit-blerjen, International Paper Company do të kërkojë gjithashtu një vlerësim të dytë të aksioneve të tij në bursën e Londrës.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu për furnizimin e materialeve të paketimit të valëzuar/ kutive të kartonit të valëzuar/ paketimeve të ambalazhimit të valëzuar, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë të DS SMITH PLC, nga shoqëria INTERNATIONAL PAPER COMPANY.

DS SMITH PLC është shoqëria fundore mëmë e grupit të shoqërive DS SMITH, aktive kryesisht në prodhimin dhe shitjen e ambalazheve të valëzuar. Ai është një ofrues kryesor i zgjidhjeve të qëndrueshme të paketimit, produkteve të letrës dhe shërbimeve të riciklimit në mbarë botën. DS SMITH Group mbledh gjithashtu letër të përdorur dhe kartonë të valëzuar për të prodhuar letër të ricikluar për ambalazhim të valëzuar.

DS SMITH Group nuk ka filial në Shqipëri, por ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri në mënyrë indirekte, nëpërmjet eksportit të produkteve të ambalazhit të valëzuar nga filialet e DS SMITH Group në Maqedoninë e Veriut, Greqi, Itali dhe Serbi drejt Shqipërisë.

INTERNATIONAL PAPER COMPANY është një ofrues global i paketimeve me bazë fibrash të rinovueshme, produkteve të letrës dhe fibrës bimore (pulp) dhe riciklimit përkatës. Ajo u shërben klientëve në mbarë botën, me njësi prodhuese në Amerikën e Veriut, Amerikën Latine, Afrikën e Veriut, dhe Evropë.

INTERNATIONAL PAPER COMPANY nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri, por ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri për vitin 2023 për shkak të shitjeve nëpërmjet eksportit të ambalazhit të valëzuar.

Nga sa më sipër, Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë DS SMITH PLC, nga shoqëria INTERNATIONAL PAPER COMPANY.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1101, Datë 29. 08. 2024

“PËR VAZHDIMIN E PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR MIDIS SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR KARTONIN JESHIL”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana IKONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 08. 2024 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 5, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (ligji nr. 9121/2003), ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil,

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, ka vendosur:

- a. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.
 - b. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
 - i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;
 - ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe bar kodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
 - c. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
 - d. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 623, datë 23.05.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të vendimit nr. 499, datë 15.02.2018 të Komisionit të Konkurrencës për kartonin jeshil”, ka vendosur:
- a. Monitorimin në vazhdimësi të tregut të sigurimeve për shitjen dhe administrimit të kartonit jeshil, në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil” deri në përfundim të marrëveshjes së përjashtuar me kushte dhe detyrime të vendosura deri më 15.02.2020.
 - b. Detyrimin e AMF për të parashtruar pranë Autoritetit të Konkurrencës, çdo rast që pengon, kufizon, apo shtrembëron konkurrencën, në lidhje me tregun e shitjes së policës - kartoni jeshil.
3. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 689, datë 24.04.2020 “Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, ka vendosur:
- a. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil;
 - b. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
 - i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga

- marrja e këtij vendimi;
- ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
 - c. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
 - d. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
4. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 904, datë 29.07.2022 “Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, ka vendosur:
- a. Të vazhdojë përjashtimin nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.
 - b. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
 - i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;
 - ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës.
 - c. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
 - d. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
5. AK ka bashkëpunuar me BSHS dhe ndërmarrjet e sigurimit, duke kërkuar informacion për zbatimin e vendimit nr. 904, datë 29.07.2022 dhe rritjen e konkurrencës në këtë sektor, për të gjithë periudhën e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes.
6. Referuar monitorimit mbi zbatimin e vendimit nr. 904, datë 29.07.2022 të Komisionit të Konkurrencës për kartonin jeshil”, ka rezultuar se, shoqëritë e sigurimit kanë zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 904, datë 29.07.2022 “Për vazhdimin e përjashtimit nga

ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, duke vijuar me tregtimin e produktit të kartonit jeshil përmes operatorëve të licensuar nga AMF dhe çdo policë sigurimi ka të evidentuar qartë elementet identifikues të secilit operator: logo, nr serial, kodi i shoqërisë, vulën dhe nënshkrimin e operatorit, si dhe bar kod të skanueshëm, duke mos kufizuar të drejtën e konsumatorëve dhe klientëve për të zgjedhur produktin dhe duke ofruar shitjen e këtij produkti në të gjitha pikat e shitjes të shoqërisë në degë, ndërmjetës dhe pika të kalimit kufitar ku shoqëritë kanë pika shitje. Shoqëritë e sigurimit e tregtojnë produktin karton jeshil nëpërmjet pikave të shitjes dhe ndërmjetësve të licensuar nga AMF në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe çmimet e shitjes janë ato të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të cilat miratohen çdo vit për çdo shoqëri sigurimi me tabelat e primit të rrezikut për përlogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta, ku përfshihet edhe produkti i kartonit jeshil si dhe AMF miraton nivelin maksimal të komisioneve të ndërmjetësimit për këtë lloj sigurimi.

7. Byroja Shqiptare e Sigurimit me anë të shkresës nr. 87/3 prot., datë 01.02.2024 “Përcjellim informacion në lidhje me VKK nr. 904, datë 29.07.2022”, ka shprehur se shoqëritë e sigurimit, kanë zbatuar kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në pikën 2 të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 904/2022. Të gjitha operatorët emetues të kartonit jeshil, kanë vijuar tregtimin e produktit të kartonit jeshil përmes operatorëve të tyre të licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe cilado policë sigurimi ka të evidentuar qartë elementët identifikues të secilit operator: logo, nr. serial, kodi i shoqërisë, vula dhe nënshkrimi i operatorit, etj.
8. Si përfundim, referuar sa më sipër, ndërmarrjet e sigurimit kanë zbatuar kushtet dhe detyrimet e vendosura nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 904, datë 29.07.2022, lidhur me: tregtimin e produktit kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe policat e sigurimit të cilat përmbajnë logon e ndërmarrjes që e tregton dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
9. Byroja Shqiptare e Sigurimit, duke qenë në përfundim të afatit të parashikuar në VKK nr. 904, datë 29.07.2022, me shkresën nr. 87/10 prot., datë 02.07.2024 “Kërkesë për shtyrjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil në zbatim të Ligjit nr. 9121/2003”, në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka kërkuar zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil, deri në vitin 2029.

II. Palët në marrëveshje

10. Palët në marrëveshje janë të gjitha shoqëritë e sigurimit të cilat e ofrojnë produktin e kartonit jeshil të sigurimit të mjeteve motorike.

III. Përshkrimi i marrëveshjes

11. Objekt i kësaj marrëveshje është vendosja e një marrëdhënie bashkëpunimi mes shoqërive të sigurimit në tregun e sigurimeve të detyrueshme të mjeteve motorike të kartonit jeshil, lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil me qëllim kryesor përmirësimin dhe rritjen e garancisë.

12. Sipas BSHS, marrëveshja lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil parashikon përjashtimin nga ndalimi të disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkëenduara në sektorin e sigurimeve, të cilat kanë për objekt bashkëpunimin në lidhje me:

- i. Vendosjen e tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve;
- ii. Vendosjen e kushteve të policave standarde të përbashkëta për eliminimin e policave false dhe vendosjen e sistemit të kodit unikal-bar kod dhe njoftimin në kohë reale në sistemin e informacionit të AMF-së të çdo police të kartonit jeshil;
- iii. Shlyerja e dëmeve (parashikohet rritja e pagesës së dëmeve dhe marrja përsipër nga shoqëritë e sigurimit të pagesës së dëmeve duke shmangur policat false, të cilat ekspozonin qytetarët që kanë marrë këtë produkt para përgjegjësive penale dhe financiare për dëmet e shkaktuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me mjetet e tyre motorike);
- iv. Testimi dhe pranimi i pajisjeve të sigurisë (sistemi i kodit unikal dhe verifikimi nëpërmjet pajisjeve të sigurisë në pikat e kalimit kufitar për verifikimin e bar-kodit unikal që vlerëson nëse policat e sigurimit të kartonit jeshil është e vlefshme dhe është sipas klasës së mjetit motorik).

13. Qëllimi i marrëveshjes është:

- i. Shitja e policave të kartonit jeshil nëpërmjet një numri të autorizuar operatorësh në pikat e kalimit kufitar dhe degët qendrore të shoqërive të sigurimit;
- ii. Procesi i shitjes të realizohet me anë të shoqërisë së brokerimit të autorizuar nga Byroja, e cila ka stafin teknik, sistemin e shitjes online në kohë reale që mundëson gjenerimin e Kodit Unikal (Nr. serial – bar kod) dhe broker fizik të licencuar.
- iii. Të rrisë garancinë dhe sigurinë e këtij shërbimi në përputhje me standardet COB (Këshillit të Byrove), shmangien e kolapsit për përjashtimin e BSHS nga Sistemi Ndërkombëtar i Kartonit Jeshil;

- iv. Rritjen e garancisë së drejtuesve të mjeteve, të cilët përdorin automjete përtej kufirit të RSH, të cilët duhet të jenë të siguruar kur hyjnë në vende ku një sigurim i tillë është i detyrueshëm;
- v. Forcimin e sigurisë financiare të ofertuesve të këtij sigurimi.

14. Sipas BSHS kjo marrëveshje ka efekte vetëm për produktin karton jeshil, i cili zë një pjesë të vogël të totalit të tregut të sigurimeve dhe i shtrin efektet në zonën gjeografike të territorit të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja nuk kufizon lirinë tregtare dhe lirinë konsumatore për të përzgjedhur produktin dhe shoqërinë sipas kërkesës së tij.

IV. Tregu Përkatës

a. Tregu përkatës i produktit

15. Kartoni Jeshil mbulon përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit motorik, ndaj dëmeve që u shkakton palëve të treta, në përputhje me parashikimin e Ligjit të një prej shteteve anëtare të Këshillit të Byrove, ku ka ndodhur rasti në sigurim. “Kartoni jeshil” është certifikata ndërkombëtare e sigurimit, e cila rregullon marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet zyrave kombëtare të vendeve anëtare të sistemit të kartonit jeshil. Drejtuesi i mjetit motorik, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me një mjet, me regjistrim të huaj, duhet të jetë i pajisur me: a) karton jeshil, të vlefshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) dokument tjetër të vlefshëm, që vërteton ekzistencën e sigurimit të përgjegjësive ndaj palëve të treta, në ato raste kur ka një marrëveshje të veçantë dypalëshe, për mjetet me targë regjistrimi të shtetit tjetër, nënshkruar të kësaj marrëveshjeje.
16. Kjo policë lëshohet në territorin e Shqipërisë vetëm për automjetet me targa shqiptare dhe vepron jashtë territorit të Shqipërisë. Për njohjen e vlefshmërisë së dokumenteve ndërkombëtare të sigurimit, byroja njofton paraprakisht, autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar. Autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar janë të detyruara të kontrollojnë përmbushjen e kërkesave, të parashikuara në ligj.

b. Tregu përkatës gjeografik

17. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Meqenëse produkti (shërbimi) ofrohet në të gjitha pikat e licencuara për tregtimin e kartonit jeshil atëherë si treg gjeografik do të jetë territori i Republikës së Shqipërisë.

V. Analiza e konkurrencës

18. Tregjet e sigurimeve në përgjithësi dhe kartonit jeshil në veçanti janë të rregulluar dhe të mbikëqyrur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bazë të ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.
19. Ndër 3 konkurrentët kryesorë në treg janë: për vitin 2022 Sigal me 24.88%, Eurosig me 24.68%, dhe Sigma me 12.40%; për vitin 2023 Sigal me 24.99%, Eurosig me 24.74%, dhe Sigma me 12.35%; për periudhën janar - maj 2024 ndërmarrjet: Sigal me 24.84%, Eurosig me 24.83%, dhe Sigma me 12.40%.
20. Sipas renditjes në vite ndërmarrja Sigal SHA radhitet e para (2022 – 2023 dhe janar – maj 2024) me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut gjatë gjithë periudhës, ndërmarrja Eurosig SHA renditet e dyta (2022 - 2023 dhe janar – maj 2024) me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut, ndërmarrja Sigma SHA gjithashtu me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut.
21. Nga vlerësimi i indeksit HHI për periudhën 2022-2023 dhe janar - maj 2024, ndërmarrjet kanë ruajtur pothuajse të njëjtën shkallë përqendrimi duke variuar nga 1 756 në 2022 deri në 1 759 në janar - maj 2024, duke qenë një treg me përqendrim të moderuar, por në nivelin e poshtëm të këtij të fundit. Kartoni jeshil për vitin 2023 zë një peshë specifike 11.73% në totalin e tregut të sigurimeve të mjeteve motorike..

VI. Arsyet e përjashtimit nga ndalimi

22. Sektori i sigurimeve është një nga sektorët e tregut financiar ku marrëveshjet mes operatorëve për qëllime të mbulimit të riskut të përbashkët dhe standardizimit të produkteve mund të përfitojnë nga përjashtimi nga ndalimi sipas parashikimeve të nenit 5 dhe neneve 48-52 të ligjit nr. 9121/2003 dhe akteve nënligjore që përfshijnë udhëzimin “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve” dhe “Formularin për njoftimin e marrëveshjeve”.
23. Duke qenë në përfundim të afatit të parashikuar në VKK nr. 904, datë 29.07.2022, BSHS ka kërkuar në mbështetje të nenit 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil, deri në vitin 2029.
24. Sipas BSHS gjatë kësaj periudhe, shoqëritë e sigurimit, anëtare të BSHS, kanë zbatuar kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në pikën 2 të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 904, datë 29.07.2022.

25. BSHS u shpreh se VKK nr. 904/2022 ka patur efektet e tij pozitive mbi tregun në përgjithësi dhe konsumatorët në veçanti, duke përmendur faktin se:
- Gjatë kësaj periudhë nuk ka patur rritje të çmimit të kartonit jeshil.
 - Të gjithë operatorët emetues të kartonit jeshil, kanë vijuar me tregtimin e produktit të kartonit jeshil përmes operatorëve të tyre të licensuar nga AMF, dhe cilado policë sigurimi ka të evidentuar qartë elementët identifikues të secilit operator: logo, nr serial, kodi i shoqërisë, vula dhe nënshkrimi i operatorit etj.
 - Nga ana e BSHS është ngritur sistemi i kontrollit elektronik në kufi të policave të sigurimit të pajisura me QR Code.
 - Në vazhdim të vendimit të Komitetit të Menaxhimit të Këshillit të Byrove, produkti karton jeshil risigurohet nga Shoqëritë e Sigurimit që prej vitit 2014 e në vijim, proces ky që ka sjell avantazhet, lidhur me besimin e Këshillit të Byrove ndaj Byrosë Shqiptare, kushte të njëjta të mbulimit të secilës shoqëri në rast aksidenti, mbulimi i risqeve në rastin e kartonave fallco, falimentin e një anëtar.
 - Ka pasur përmisime të theksuara në drejtim të likuidimit të dëmeve
26. BSHS në vijim të shkresës nr. 87/17 prot., datë 18.07.2024 “Përcjellin informacion mbi zbatimin e VKK nr. 904, datë 29.07.2022”, bën me dije se:
27. Anëtarët e Bordit të Monitorimit, kanë rënë dakord të nxjerrin Byronë Shqiptare të Sigurimit nga Statusi i Monitorimit”. Me citimin e mësipërm, si pjesë të vendimit të datës 8 Dhjetor 2022, Këshilli i Byrove (Institucion përfaqësues i krijuar me anëtarësinë e 47 Byrove të Europës, me seli në Bruksel), në mënyrë unanime ka vendosur daljen e Byrosë Shqiptare të Sigurimit nga Statusi i Monitorimit, status në të cilin ishte vendosur prej vitit 2013.
28. Në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Këshillit të Byrove, datë 8 dhjetor 2022, thuhet se: Statusi “Monitorues” i Byrosë Shqiptare u rivlerësua nga fundi i vitit 2021 deri në shkurt 2022 dhe fokusonte mangësitë e evidentuara gjatë vlerësimit të mëparshëm në vitin 2019. Anëtarët e Bordit ranë dakord: (a) “Të çlirojë Byronë e Shqipërisë nga statusi “Monitorues”; (b) dhe t’i rekomandojë Byrosë së Shqipërisë të mbajë një mbulesë risigurimi të barabartë me atë që ekziston aktualisht dhe fondet e garancisë të depozituara nga anëtarët e Byrosë për shumën minimale prej 1 750 000 euro, nëse (kur) Byroja të lirohet nga statusi “Monitorues”.
29. Nëpërmjet këtij vendimi Këshilli i Byrove njeh zhvillimin e arritur gjatë viteve të fundit; në të njëjtën kohë, beson se janë të nevojshme përpjekjet e vazhdueshme për të ruajtur dhe përmirësuar këtë progres dhe se BSHS dhe autoritetet kombëtare përkatëse do të ndër marrin të gjithë masat e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë.

30. Në Vendimin dhe Anekset e Asamblesë së Përgjithshme nr. 58, të mbajtur në datat 6 dhe 7 qershor në Londër, thuhet se BSHS plotësoi kushtet e përcaktuara në Asamblenë e Përgjithshme 2022 dhe Bordi Mbikëqyrës përdori mandatin të çlirojë nga statusi "Monitorimit" në mbledhjen e 1 dhjetorit 2022. Garancia bankare e vendosur në favor të Këshillit të Byrove u hoq.
31. Në bazë të shkresës nr. 87/11 prot., datë 05.07.2024 "Konfirmimi i marrjes së kërkesës për zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil", drejtuar BSHS, është konfirmuar se dokumentacioni i dorëzuar është i plotë dhe do të nënshtrohet procedurave të parashikuara në nenin 5 dhe nenet 48-52 të seksionit II (Procedura për përjashtimin e marrëveshjeve nga ndalimit) të ligjit 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".
32. Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 87/14, datë 11.07.2024 "Kërkesë për Informacion", i është drejtuar AMF, lidhur me opinionin e saj mbi kërkesën e Byrosë së Shqiptare të Sigurimit për zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil deri në vitin 2029.
33. AMF me shkresën nr. 87/21 prot., datë 23.07.2024 "Përgjigje tuajës nr. 87/14 prot., datë 11.07.2024", ka informuar se në bazë të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, fusha e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikëqyrja e tregut financiar jo bankar, siç është tregu i sigurimeve, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari. Në përmbushje të këtij detyrimi ligjor Autoriteti monitoron situatën në tregun e sigurimit të detyrueshëm përfshirë produktin e kartonit jeshil, për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e kartonit jeshil si dhe kërkesave të tjera të vendosura nga Këshilli i Byrove. Autoriteti në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", miraton çdo vit për çdo shoqëri sigurimi tabelat e primit të rrezikut për përlllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësishë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta, ku përfshihet edhe produkti i kartonit jeshil si dhe miraton nivelin maksimal të komisioneve të ndërmjetësimit për këtë lloj sigurimi. AMF shprehet se vlerëson se stabiliteti dhe konkurrenca e drejtë në produktin e kartonit jeshil janë elemente të rëndësishme për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve si dhe qëndrueshmërisë dhe besueshmërinë e tregut të sigurimeve.
34. Këshilli i Byrove (COB), ka njoftuar në datë 9 shkurt 2024 në faqen zyrtare⁶ se: Kartoni jeshil, mund të pranohet në format elektronik PDF nga fillimi i vitit 2025. Nga 1 janari 2025, shoferët

⁶ <https://www.cobx.org/article/10969/green-cards-accepted-electronic-format-start-2025>

që vizitojnë çdo vend brenda zonës së qarkullimit të kartoni jeshil do të lejohen të japin kartonin jeshil në formatin PDF, për sa kohë që vijnë nga një vend që shpërndan kartonin jeshil në formatin PDF.

VII. Kushtet dhe detyrimet

35. Në bazë të nenit 50, pika 2 e ligjit nr. 9121/2003, vlerësojmë që kjo marrëveshje të jepet me kushte dhe detyrime me qëllim që të ketë konkurrencë të mjaftueshme në tregun përkatës dhe marrëveshja të mos kufizojë produktin apo shitjet, të mos ndajë tregun dhe klientët të mos bien dakord për primet e shitjes, si më poshtë vijon:

i. Afati i marrëveshjes të jetë 2 vjeçar;

ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.

36. Ndryshimet e mësipërme synojnë reduktimin e mundësisë së koordinimit të sjelljes dhe kanë si qëllim të shmangin një ndarje potenciale të pjesëve të tregut mes palëve njoftuese të marrëveshjes dhe në këtë mënyrë respektohen parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 5, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të vazhdojë përjashtimin nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.
2. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
 - i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, dhe hyn në fuqi që nga momenti i depozitimit të kërkesës së BSHS për zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.

- ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
 3. T’i rekomandojë Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe ndërmarrjeve të sigurimit që të marrin masat për përgatitjen e kartonit jeshil në formatit elektronik PDF, sipas rekomandimeve nga Këshilli i Byrove.
 4. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
 5. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
 6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të kryen pagesat e parashikuara në rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1102, Datë 29. 08. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË CURA DOMO HOLDING GMBH NGA SHOQËRIA MAVIE NEXT GMBH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 08. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Cura Domo Holding GmbH nga shoqëria Mavie Next GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë shoqërisë Cura Domo Holding GmbH nga shoqëria Mavie Next GmbH.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë Cura Domo Holding GmbH nga shoqëria Mavie Next GmbH.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Amenduese e Marrëveshjes Kuadër të Pjesëmarrjes, datë [.....], palët në marrëveshje janë:

Investitori: Mavie Next GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas

legjislacionit të Austrisë. Mavie Next GmbH është një ofruer gjithëpërfshirës i kujdesit shëndetësor në fushat e plakjes aktive, kujdesit parësor dhe shëndetit mendor, si dhe në fushën e marrëdhënies prind-fëmijë. Zgjidhjet e saj bazohen në shërbimin e parandalimit dhe rehabilitimit. Ajo synon të ofrojë zgjidhje që mbështesin njerëzit gjatë gjithë jetës së tyre, si në ruajtjen ashtu edhe në përpjekjet drejt shëndetit optimal.

[.....]

UNIQA Group është e pranishme në Shqipëri nëpërmjet tre filialeve:

- SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SHA, shoqëri e krijuar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Sigurimi i jetës;

- SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA, shoqëri e krijuar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Sigurimin ndaj dëmeve dhe risigurimet, në përputhje me ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”, si dhe çdo objekt tjetër të lejuar nga legjislacioni dhe që nuk vjen në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimeve, etj., dhe;

- SIGAL UNIQA INVEST – Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SHA, shoqëri e krijuar sipas legjislacionit shqiptar, e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve, në përputhje me dispozitat e ligjit për fondet e pensionit privat, si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së rrezikut (diversifikim), për ofrimin e përfitimeve të pensionit për personat që bashkohen në fondin e pensionit, etj.

Target: Cura Domo Holding GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Austrisë me aksionar aktual: Z. R. Pozdena, Znj. A. Pozdena-Tomberger dhe shoqërinë Mavie Next GmbH.

Cura Domo Holding GmbH është një biznes familjar austriak i mesëm. Ajo ofron shërbime në fushën e kujdesit 24-orësh në shtëpi, shtëpive të kujdesit (jetës së asistuar) dhe menaxhimit të objekteve.

Shoqëria target Cura Domo Holding GmbH nuk ka filial në Shqipëri dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Themeluesi 1. Z. R. Pozdena është person fizik.

Themeluesi 2. Znj. A. Pozdena-Tomberger është person fizik.

Z. R. Pozdena dhe Znj. A. Pozdena-Tomberger janë themeluesit e shoqërisë target Cura Domo Holding GmbH.

II. Transaksioni

Më datë [.....], është nënshkruar “Marrëveshje Amenduese e Marrëveshjes Kuadër të

Pjesëmarrjes”, ndërmjet shoqërisë Mavie Next GmbH në cilësinë e investitorit, Z. Robert Pozdena dhe Znj. Angelika Pozdena-Tomberger, në cilësinë e themeluesve, lidhur me pjesëmarrjen në shoqërinë target.

Palët kanë nënshkruar një “Marrëveshje Kuadër Pjesëmarrje” më datë [.....] dhe synojnë të ndryshojnë këtë Marrëveshje nëpërmjet kësaj Marrëveshje Amenduese.

Themeluesit, kanë renë dakord në marrëveshje që ti japin Investitorit, në mënyrë të pakthyeshme, opsionin për të blerë dhe zotëruar 15.5% të kuotave të zotëruara nga Themeluesi 1 dhe 15.5 % të kuotave të zotëruara nga Themeluesi 2, që përkojnë me një kapital në vlerën 6,200 euro të secilit.

[.....]

Transaksioni i ndryshimit të kontrollit të shoqërisë Cura Domo Holding GmbH, përbën një përqendrim, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu për ofrimin e shërbimeve të kujdesit për të moshuarit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Cura Domo Holding GmbH nga shoqëria Mavie Next GmbH.

Mavie Next GmbH është një ofruer gjithëpërfshirës i kujdesit shëndetësor aktiv në fushat e plakjes aktive, kujdesit parësor dhe shëndetit mendor, si dhe në fushën e marrëdhënies prind – fëmijë.

Mavie Next GmbH është filial i Grupit UNIQA. UNIQA Group është i pranishëm në Shqipëri nëpërmjet tre filialeve: SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SHA, e cila ushtron veprimtarinë e sigurimit të jetës; SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA, e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj sigurimin ndaj dëmeve dhe risigurimet dhe operon në tregun e sigurimit të jo-jetës; SIGAL UNIQA INVEST – Shoqëria administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SHA, e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve.

Cura Domo Holding GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila ofron shërbime në fushat e kujdesit 24-orësh në shtëpi, shtëpive të kujdesit (jetesës së asistuar) dhe menaxhimit të objekteve.

Cura Domo Holding GmbH nuk ka filial në Shqipëri dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Asnjë nga palët nuk është aktive në ndonjë nga tregjet përkatëse në Shqipëri. Duke qenë se aktivitetet e target, në tregjet përkatëse, janë të kufizuara ekskluzivisht në Austri, transaksioni i propozuar nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Nga sa më sipër, transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Cura Domo Holding GmbH nga shoqëria Mavie Next GbmH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1103 , Datë 29 . 08. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË IMMEDICA PHARMA HOLDING AB NGA SHOQËRITË KKR DHE IMPILO NO 4 AB”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 08. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Immedica Pharma Holding AB nga shoqëritë KKR dhe Impilo No 4 AB.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Immedica Pharma Holding AB nga shoqëritë KKR dhe Impilo No 4.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Immedica Pharma Holding AB nga shoqëritë KKR dhe Impilo No 4.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:

Pala blerëse: Poseidon Bidco AB (Goldcup 35050 AB U.N.C) është një shoqëri private e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Suedisë. Objektivat e shoqërisë janë që, drejtpërdrejt

dhe tërthorazi, të zotërojë dhe menaxhojë aksione dhe letra me vlerë në filialet dhe shoqëritë e lidhura, si dhe të kryejë veprimtari biznesi të pajtueshme me to.

Poseidon Bidco AB zotërohet indirekt nga fondet e investimeve, mjetet dhe/ose të drejtuara dhe menaxhuara nga filiale të ndryshme të KKR & Co.Inc., (KKR & Co. dhe së bashku me filialet e saj KKR), një firmë investimesh globale që ofron menaxhim të aseteve alternative dhe tregjeve të kapitalit.

KKR nuk ka filiale në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet shitjeve të realizuara nga shoqëritë me portofol të kontrolluar dhe menaxhuara nga filiale të ndryshme të KKR & Co.

Pala shitëse: Impilo No 4 AB është një kompani investimesh e themeluar sipas ligjeve të Suedisë, e fokusuar ekskluzivisht në investime në kompani që operojnë në industrinë farmaceutike, teknologjinë mjekësore, shërbimet shëndetësore dhe industri të tjera të lidhura me shëndetin.

Shoqëria Target: Immedica Pharma Holding AB është një shoqëri private e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Suedisë. Objektivi i biznesit të shoqërisë është të investojë në shoqëri të fokusuar në mirëqenie dhe ndërmarrje të tjera të lidhura me shëndetin, për të zotëruar, menaxhuar dhe zhvilluar veprimtarinë në këto lloj shoqërish, si dhe fusha të tjera biznesi të përputhshme.

[.....]

II. Transaksioni

Më datë [.....] është lidhur “Marrëveshje shitblerje aksionesh” ndërmjet shitësve dhe blerësit Goldcup 35050 AB U.N.C. (Poseidon Bidco AB), në lidhje me kapitalin aksionar të shoqërisë Immedica Pharma AB.

Sipas kushteve të kësaj Marrëveshje shitësit dëshirojnë të shesin dhe blerësi dëshiron të blejë të gjithë kapitalin aksionar të shoqërisë.

Palët kanë parashikuar që pas përfutimit të kontrollit të shoqërisë Immedica Pharma Holding AB nga shoqëria Poseidon Bidco AB, pjesët e Impilo No 4 AB në shoqërinë target do të shkëmbehen me pjesë në shoqërinë Poseidon Bidco AB duke sjellë përfutimin e kontrollit të përbashkët në shoqërinë target. Përqindjet e sakta të pjesëmarrjes në Poseidon Bidco AB të mbajtura nga pala shitëse dhe pala blerëse, mjete dhe/ose llogaritë e këshilluara dhe të menaxhuara nga KKR aktualisht nuk janë të njohura, por pritet të jenë mes 40 – 49% përkatësisht.

Më datë 06 gusht 2024, shoqëritë Poseidon Super TopCo S.a.r.l, Impilo No 4 AB (së bashku “Mbajtësit e Titujve Institucionalë”) dhe Goldcup 101331 AB (Shoqëria) kanë nënshkruar “Marrëveshja e Mbajtësve të Titujve të Goldcup 101331 AB (i cili do të riemërohet Poseidon JVCo 2 AB).

Referuar marrëveshjeve të mësipërme dhe deklarimeve të palëve në Formularin e thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit, pas mbylljes së transaksionit, Poseidon Bidco AB dhe Immedica Pharma

Holding AB do të kontrollohen në mënyrë të përbashkët nga Impilo No 4 AB dhe KKR.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i komercializimit të barnave për sëmundjet e rralla dhe specifike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar ka për pasojë përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Immedica Pharma Holding AB nga shoqëritë KKR, nëpërmjet Poseidon Bidco AB, dhe Impilo No 4 AB.

Poseidon Bidco AB zotërohet tërësisht, në mënyrë indirekte, nga fondet e investimeve, mjetet dhe/ose drejtuar dhe menaxhuar nga filiale të ndryshme të KKR & Co. Inc. KKR nuk ka filiale në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet shitjeve të realizuara nga shoqëritë me portofol të kontrolluar dhe menaxhuara nga filiale të ndryshme të saj.

[.....]

Nga sa më sipër, Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Immedica Pharma Holding AB nga shoqëritë KKR dhe Impilo No 4 AB.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1104, Datë 29. 08. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SEASIDE RESIDENCE V SHPK NGA SHOQËRIA BOLV-OIL SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 08. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SEASIDE RESIDENCE V SHPK nga shoqëria BOLV-OIL SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë SEASIDE RESIDENCE V SHPK nga shoqëria BOLV-OIL SHA.”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë SEASIDE RESIDENCE V SHPK

Referuar dokumenteve të depozituara, palët në transaksion janë:

Pala Blerëse: Shoqëria BOLV-OIL SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti tregti me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të saj, operacione të ndryshme portuale, investime kapitale në fushën e ndërtimit, ndërtime të rrugëve, kanalizimeve dhe objekteve civile dhe industriale, import, eksport dhe tregtim me shumicë i

materialeve të ndërtimit, transport rrugor kombëtar e ndërkombëtar i naftës, gazit, nënprodukteve, lëndë djegëse, furnizim me karburant për anije të ndryshme në porte, etj.

Shoqëria BOLV -OIL SHA zotërohet 100% nga Z. Behar Çukaj.

Z. Behar Çukaj direkt dhe indirekt nëpërmjet shoqërisë BOLV OIL SHA zotëron 100% të kapitalit në shoqëritë:

- **OLSI SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti tregti me shumicë e pakicë të karburanteve, lëndëve djegëse për popullatën; bar restorant, hoteleri, bar-kafe, servis automjetesh, lavazh; transport me shumicë e pakicë të artikujve industrial dhe ushqimor; agjenci Turistike.
- **Porto-Romano OIL SHA**, një shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti import-eksport, tranzitim, përpunim, transport, tregti me shumicë i naftës gazit dhe n/produkteve. Hapje e agjencive doganore për llogari të vet dhe për të tretë. Veprimtari shërbimi që lidhen me studimin, projektimin, kërkimin, eksplorimin, nxjerrjen, zhvillimin, prodhimin, transportimin dhe marketimin e hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre, si dhe të makinerive e pajisjeve teknike e teknologjike që i shërbejnë kësaj veprimtarie. Punime gërmime toke, punime civile dhe industriale, rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasadash, ndërtime rruge, autostrada, mbikalime, punime nëntokësore, ura dhe vepra arti, punime për prishjen e ndërtimeve, ndërtime impiante teknologjike, termik dhe të kondicionimit, ndërtime impiante të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij, shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë. Kërkim, zhvillim dhe shërbime në zonat naftëmbajtëse dhe të gazit natyror. Veprimtari në fushën e industrisë së naftës, gazit e ujit teknologjik si dhe atë minerare që lidhen me: studime, projektme, kërkime, zbulime e konturime, nxjerrje dhe zhvillime, shërbime e supervizime.
- **Albdrilling SHA**, një shoqëri aksionare me objekt aktiviteti gërmime, shpime për ekstraktim gurësh, rërash dhe dherave, nxjerrja e naftës bruto, gazit natyror, rërës. Veprimtari në fushën e industrisë së naftës, gazit e ujit, si dhe në atë minerare që lidhen me: studime, projektme, kërkime, zbulime e konturime, nxjerrje dhe zhvillime, shërbime e supervizime. Eksporte, importe dhe prodhimin e makinerive e pajisjeve, transportin, grumbullimin, përgatitjen dhe tregtimin. Prodhimin e nënprodukteve dhe tregtimin e tyre me shumicë. Studime, projektme, zbatime e supervizime në fushën e mjedisit, etj.
- **AUTOVISION SHA**, një shoqëri aksionare me objekt aktiviteti blerjen dhe shitjen e automjeteve të tipit IVECO dhe mjete rrugore të tjera. Tregtimin e pjesëve të këmbimit për automjetet e tipit IVECO dhe import-eksportin e tyre. Tregtimin e karburanteve dhe lubrifikanteve dhe import - eksportin e tyre. Servis automjetesh të ndryshme, pajisje dhe makineri të ndryshme, si dhe çdo gjë që ka të bëjë me servisën e automjeteve dhe jo vetëm të tipit IVECO; tregtimin e auto gomave të ndryshme dhe import eksportin e tyre; transportin e mallrave dhe të lëndëve djegëse dhe import eksportin e tyre; tregtimin e

dyerve të çelikut, për përdorim shtëpiak, zyrave, etj., duke kryer edhe transportimin e tyre; tregtimin e pajisjeve elektro shtëpiake dhe import - eksportin e tyre, etj.

Pala shitëse: Shoqëria GREEN COAST SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt parësor të veprimtarisë projektim, ndërtim, vënia në shfrytëzim e një kompleksi turistik, një strukture hotelerie dhe e objekteve turistike sezonale në Palasë. Shitja e objekteve me destinacion rezidencial veror dhe/ose administrimi i tyre, si dhe ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit në zonën e Palasës, si dhe çdo veprimtari tjetër plotësuese që lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e sipërpërmendur, etj.

Shoqëria Target: SEASIDE RESIDENCE V SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti projektim dhe ndërtimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë, veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkte apo indirekte të lidhura me to, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Gjithashtu shoqëria mund të kryej çdo lloj veprimtarie apo transaksioni tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimtarive tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarë do lloji dhe natyre, të nevojshëm ose të dobishëm për arritjen dhe/ose plotësimin e objektit të shoqërisë.

Shoqëria SEASIDE RESIDENCE V SHPK zotërohet 100% nga shoqëria GREEN COAST SHPK.

II. Përqendrimi

Më datë [.....], shoqëritë GREEN COAST SHPK, në cilësinë e shitësit dhe BOLV-OIL SHA, në cilësinë e blerësit, kanë nënshkruar “Marrëveshje për blerje kuote”.

Referuar marrëveshjes, Shitësi shet, transferon dhe dorëzon pronësinë e plotë dhe zotërimin e kuotës e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë SEASIDE RESIDENCE V SHPK dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që ai gëzon si ortak, tek Blerësi, i cili pranon t`i blejë.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria SEASIDE RESIDENCE V SHPK do të zotërohet tërësisht nga shoqëria BOLV-OIL SHA.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i përfuturit të kontrollit të vetëm të shoqërisë SEASIDE RESIDENCE V SHPK nga shoqëria BOLV OIL SHA, përbën një përqendrim, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e Konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit

do të konsiderohet tregu i projektimit, ndërtimit dhe menaxhimit të objekteve civile apo industriale për vete dhe për të tretë, dhe veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkte apo indirekte të lidhura me to. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar u konstatua se aktiviteti kryesor i shoqërisë BOLV-OIL SHA është fokusuar në shitjen me shumicë të karburantit (naftë dhe benzinë). Rreth 88% e të ardhurave për vitin 2023 janë realizuar nga shitja e karburantit. Referuar raporteve hetimore në tregun e karburanteve, konstatohet se shoqëria BOLV-OIL SHPK zotëron rreth 5% të tregut të shitjes me shumicë të karburanteve (naftë dhe benzinë)⁷.

Shoqëria BOLV OIL SHA është e integruar vertikalisht në tregun e magazinimit, importit, tregtimit me shumicë dhe pakicë të karburanteve, nëpërmjet shoqërive Porto-Romano OIL SHA dhe OLSI SHPK.

Shoqëria AUTOVISION SHA, ka realizuar të ardhura nga shitja e mjeteve/kamionë, nga shitja e vajrave, pjesëve të këmbimit dhe shërbime servisi, ndërkohë që shoqëria Alodrilling SHA realizon të ardhura nga aktiviteti i shitjes së punimeve dhe shërbimeve të sondave në industrinë e nxjerrjes së naftës dhe pjesa me e madhe e të ardhurave (rreth 75%) janë të ardhura nga shërbimet e ofruara për shoqërinë Bankers Petroleum.

Shoqëria Target, SEASIDE RESIDENCE V SHPK, operon në fushën e projektit dhe ndërtimit të objekteve civile apo industriale; menaxhimit e zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë; në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkte apo indirekte të lidhura me to, por nuk ka realizuar asnjë të ardhur për vitet 2021, 2022, dhe 2023.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim konglomerat pasi shoqëria BOLV-OIL SHA dhe shoqëritë e zotëruara prej saj, operojnë në tregje të ndryshme nga tregu i shoqërisë target.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në strukturën e tregut të prekur nga përqendrimi në Shqipëri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

⁷ Raport i hetimit paraprak në tregun e tregtimit me shumicë të karburantit naftë dhe benzinë/2022

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SEASIDE RESIDENCE V SHPK nga shoqëria BOLV-OIL SHA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1105 , Datë 29. 08. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË VITA RES DOO NGA SHOQËRIA RAUCH FRUCHTSÄFTE GMBH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 08. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë VITA RES DOO nga shoqëria RAUCH Fruchtsäfte GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë VITA RES DOO nga shoqëria RAUCH Fruchtsäfte GmbH”.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë VITA RES DOO nga shoqëria RAUCH Fruchtsäfte GmbH.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Shitje Blerje Aksionesh me Kompensim”, nënshkruar më datë [.....], palët në marrëveshje janë:

Blerësi: Rauch Fruchtsäfte GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjisllacionit të Austrisë, me ortak të vetëm shoqërinë Rauch Beteiligungs GmbH.

Rauch Fruchtsäfte GmbH është pjesë e grupit Rauch, i cili fokusohet në prodhim dhe shitje të pijeve, shitje e koncentrateve të lëngjeve të frutave dhe produkteve gjysmë të gatshme tek blerësit ndërkombëtarë, si dhe u ofron shërbime prodhuesve të tjerë të pijeve, duke mbushur kanaçe, PET (plastike), shishe qelqi dhe paketime kartoni për lëngje (si Tetra Pak).

Grupi Rauch nuk ka filiale të regjistruara në Shqipëri, por realizon të ardhura kryesisht nga shitja e lëngjeve të frutave nga të tretë.

Shitësit: Z. Toni Kevilovski dhe Z. Ljupço Stojçevski, persona fizik, secili zotërues i 50% të aksioneve (kuotave) në kapitalin e shoqërisë target.

Shoqëria Target: Shoqëri për Prodhim, Tregtim dhe Shërbime VITA RES DOO import-eksport Resnjë (VITA RES DOO), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut, me aksionar aktual Z. Toni Kevilovski dhe Z. Ljupço Stojçevski.

Shoqëria target ka si aktivitet kryesor: Prodhim të lëngjeve nga frutat dhe perimet. VITA RES DOO nuk ka filiale të regjistruara në Shqipëri.

II. Transaksioni

Më datë [.....], është nënshkruar “Marrëveshje Shitje Blerje Aksionesh me Kompensim”, ndërmjet shoqërisë Rauch Fruchtsäfte GmbH në cilësinë e blerësit dhe Z. Toni Kevilovski dhe Z. Ljupço Stojçevski në cilësinë e shitësve.

Objekti i kësaj Marrëveshje është transferimi i aksioneve të shitësve tek blerësi, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë VITA RES DOO.

Aksionarët kanë miratuar paraprakisht një Vendim për pranimin e kushteve të Blerësit për blerjen e 100% të aksioneve të tyre në shoqërinë VITA RES DOO.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i përpunimit të frutave dhe tregu i shitjes së produkteve gjysmë të gatshme, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë VITA RES DOO nga shoqëria RAUCH Fruchtsäfte GmbH.

Grupi RAUCH nuk ka asnjë filial në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet shitjeve të mallrave të gatshëm kryesisht në supermarketete, si Red Bull, lëngje fruta dhe pije të ftohta.

VITA RES nuk ka filiale në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet shitjeve të koncentrat lëng molle, pure molle dhe pure pjeshke te klientët shqiptarë.

Nga sa më sipër, transaksioni i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni nuk pritet të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë VITA RES DOO nga shoqëria RAUCH Fruchtsäfte GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1106, Datë 06. 09. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË PR-TELECOM TÁVKÖZLÉSI KERESKEDELMÍ ÉS SZOLGÁLTATÓ ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG DHE FILIALIT TË SAJ PR-WORK KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA "ANTENNA HUNGÁRIA" MAGYAR MŰSORSZÓRÓ ÉS RÁDIÓHÍRKÖZLÉSI ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06. 09. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë PR-TELECOM Távközlési Kereskedelmi és Szolgáltató Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe filialit të saj PR-WORK Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë PR-TELECOM Távközlési Kereskedelmi és Szolgáltató Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe filialit të saj PR-WORK Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság”.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfundimit të kontrollit të shoqërisë PR-TELECOM Távközlési Kereskedelmi és Szolgáltató Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe filialit të saj PR-WORK Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszórási és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Referuar dokumentit "Marrëveshje shitblerje aksionesh" nënshkruar më datë 4 korrik 2024, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse:

- "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszórási és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság, ("Antenna Hungaria" Zrt) është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, e cila e ushtron aktivitetin e saj, në fushën e ofrimit të shërbimeve të aktivitetit të programimit dhe transmetimit televiziv, transmetimit radiofonik, aktivitetet e telekomunikacionit me kablo dhe pa tela, satelitor dhe aktivitete të tjera të telekomunikacionit në Hungari. "Antenna Hungaria" Zrt zotërohet 76.78% nga shoqëria 4iG Nyilvánosan Működő Részvénytársaság.

- 4iG Nyilvánosan Működő Részvénytársaság, (4iG Nyrt) është një shoqëri aksionare/ publike e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, me objekt veprimtarie: prodhim kompjutera dhe pajisje periferike, prodhim i makinerive dhe pajisjeve të zyrës (përveç kompjuterëve dhe pajisjeve periferike), montimi i makinerive dhe pajisjeve industriale, organizimi i projektit të ndërtimit të objekteve, përgatitja e sipërfaqes së ndërtimit, shërbimet e tregtisë me shumicë të kompjuterëve, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, tregti me shumicë jo e specializuar, shërbimet e tregtisë me pakicë të kompjuterave, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, etj.

4iG Nyrt zotëron indirekt 100% të shoqërisë Albania Telecom Invest AD, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Bullgarisë, e cila zotëron 94.116% të shoqërisë ONE ALBANIA SHA.

ONE ALBANIA SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ndërtimin, zotërimin, operimin dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standartit GSM dhe telefoni fikse; komunikimi bazë i telefonisë celulare në rrjetin lokal bazuar në kanalet radio; komunikim bazë në rrjetin ndër-qytetas që lidhen me transmetimin radio; komunikim ndërkombëtar të çdo lloj transmetimi dhe vale; komunikimi i të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; komunikim multimedia dhe ISDN, komunikim teletekst and videotekst; detar, ajror, hapësinor dhe radio-komunikim satelitor; shërbime me vlerë të shtuar, shërbime komunikimi publik me monedha, karta etj.

Pala shitëse:

Znj. István Fojt, shtetase e huaj, e cila zotëron 7.28% të aksioneve të shoqërisë target PR – TELECOM Zrt., **Z. Zoltán Fojt**, shtetas i huaj, i cili zotëron 14.07% të aksioneve të shoqërisë target, **Znj. Marina Fojt Szunyoghné**, shtetase e huaj, e cila zotëron 14.07% të aksioneve të shoqërisë target, **Z. Norbert Fojt**, shtetas i huaj, i cili zotëron 13.03% të aksioneve të shoqërisë target, **Z. Péter Fojt**, shtetas i huaj, i cili zotëron 13.03% të aksioneve të shoqërisë target, **FOREFCOM Korlátolt Felelősségű Társaság**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, e cila zotëron 38.51% të aksioneve të kapitalit të shoqërisë target.

Shoqëria target:

PR - TELECOM Távközlési Kereskedelmi és Szolgáltató Zártkörűen Működő Részvénytársaság (PR – TELECOM Zrt) është një shoqëri publike e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, e cila ushtron aktivitete biznesi në një sërë fushash në sektorin e telekomunikacionit. Disa nga veprimtaritë ekonomike kryesore të PR- TELECOM janë: a) Shërbime telekomunikacioni; b) Zhvillimi i infrastrukturës së rrjetit; c) Shërbimet e Menaxhuara IT dhe Rrjeti; d) Produkte dhe shërbime konsumatore dhe e) Mbështetja dhe angazhimi i klientit.

PR – WORK Korlátolt Felelősségű Társaság (PR – WORK Kft.) është një filial në pronësi të plotë të shoqërisë PR – TELECOM Zrt. PR – WORK Kft. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, e cila mbështet dhe lehtëson operacionet e PR – TELECOM Zrt. Kjo përshin veçanërisht operimin e infrastrukturës IT dhe të rrjetit GPON.

PR – TELECOM Zrt dhe PR – WORK Kft. nuk kanë realizuar xhiro në Shqipëri për vitin 2023.

II. Transaksioni

Ndërmjet shoqërisë "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszórá és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság (në cilësinë e blerësit) dhe Znj. István Fojt, Z. Zoltán Fojt, Znj. Marina Fojt Szunyoghné, Z. Norbert Fojt, Z. Péter Fojt, FOREFCOM Korlátolt Felelősségű Társaság (në cilësinë e shitësve) dhe PR -TELECOM Távközlési Kereskedelmi és Szolgáltató Zártkörűen Működő Részvénytársaság (Shoqëria) është lidhur “Marrëveshje shitblerje aksionesh”, nënshkruar më datë [.....].

Shitësit janë pronarët e vetëm të Shoqërisë PR – TELECOM Zrt. Shoqëria ka në pronësi të plotë shoqërinë PR – WORK Kft.

Palët kanë rënë dakord që, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, shitësit do të shesin dhe blerësi do të blejë aksionet nga shitësit pa të gjitha pretendimet, tarifat dhe shpenzimet, së bashku me të gjitha të drejtat për to, me çmimin e blerjes, subjekt i të drejtës për shitje.

Shitblerja do të kryhet për të gjithë kapitalin aksionar të emetuar të shoqërisë target dhe filialit të saj, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Pas përmbylljes së Transaksionit, "ANTENNA HUNGÁRIA" Zrt. do të zotërojë plotësisht shoqërinë target PR – TELECOM Zrt dhe filialin e saj PR – WORK Kft.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i komunikimeve elektronike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës geografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të shoqërisë PR-TELECOM Távközlési Kereskedelmi és Szolgáltató Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe filialit të saj PR-WORK Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

"ANTENNA HUNGÁRIA" operon në Shqipëri përmes shoqërisë të zotëruar indirekt prej saj ONE ALBANIA SHA. ONE ALBANIA SHA është një shoqëri shqiptare me aktivitet në tregun e komunikimeve elektronike.

PR-TELECOM dhe filiali i saj PR-WORK nuk janë aktive dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.

PR-TELECOM synon të ofrojë shërbime telekomunikacioni dhe zgjidhje inovative klientëve të saj në Hungari duke mos qenë e angazhuar në asnjë aktivitet biznesi në Shqipëri.

PR-WORK është filial i PR-TELECOM, e cila mbështet dhe lehtëson operacionet e PR-TELECOM.

Nga sa më sipër, transaksioni i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni nuk pritet të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë PR-TELECOM Távközlési Kereskedelmi és Szolgáltató Zártkörűen Működő

Részvénytársaság dhe filialit të saj PR-WORK Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 1107, Datë 06. 09. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË EDISON STOCCAGGIO SPA NGA SHOQËRIA SNAM S.P.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06. 09. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të shoqërisë EDISON STOCCAGGIO SPA nga shoqëria SNAM S.P.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të shoqërisë EDISON STOCCAGGIO SPA nga shoqëria SNAM S.P.A.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfhtimit të kontrollit të shoqërisë EDISON STOCCAGGIO SPA nga shoqëria SNAM S.P.A.

Referuar dokumenteve të depozituara nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:

Pala blerëse: SNAM S.P.A. është një shoqëri aksionare, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve

të Italisë. SNAM S.P.A. është kryesisht aktiv në Itali, duke menaxhuar pjesën më të madhe të rrjetit të shpërndarjes dhe transportit brenda territorit kombëtar, por është gjithashtu aktiv edhe jashtë vendit, duke menaxhuar disa infrastruktura gazi në Greqi, Francë dhe Austri.

[.....]

SNAM S.P.A. kontrollohet në mënyrë të tërthortë nga Grupi CDP, [.....].

Të ardhurat e realizuara në Shqipëri për vitin 2023, janë nëpërmjet ndërmarrjeve të kontrolluara nga CDP.

Pala shitëse: Edison S.p.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit italian, aktiv në sektorin e gazit, menaxhimin e infrastrukturës së importit dhe shitjes së gazit.

Shoqëria target: EDISON STOCCAGGIO SPA është një shoqëri aksionare, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë, aktive ekskluzivisht në Itali në fushën e magazinimit të gazit natyror dhe zgjidhjet e fleksibilitetit për transportuesit që operojnë në kanalin tregtar, duke u ofruar këtyre të fundit shërbime modulimi për të përmbushur kërkesat ditore, sezonale dhe të pikut të konsumit të gazit.

EDISON STOCCAGGIO SPA është një degë në pronësi të plotë të Edison S.p.A., një shoqëri e Grupit EDF, i cili është aktiv në mbarë botën në prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike, si dhe në të gjithë zinxhirin e biznesit të gazit natyror, duke përfshirë nxjerrjen, menaxhimin e importit / infrastrukturat e transmetimit, shpërndarjen dhe shitjet me pakicë të gazit.

EDISON STOCCAGGIO SPA nuk ka asnjë filial, degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri dhe nuk ka realizuar të ardhura në Shqipëri për vitin 2023.

II. Transaksioni

Më datë [.....], Edison S.p.A. (në cilësinë e shitësit) dhe SNAM S.P.A. (në cilësinë e blerësit) kanë lidhur “Marrëveshje Shitblerje e Aksioneve” në lidhje me të gjithë kapitalin aksionar të EDISON STOCCAGGIO SPA.

Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshje, në Datën e Mbylljes shitësi shet dhe transferon tek Blerësi të gjitha aksionet dhe blerësi blen nga shitësi të gjitha aksionet me pagesën e çmimit të blerjes.

Pas përfundimit, pala blerëse SNAM S.P.A. do të marrë kontrollin e vetëm të shoqërisë target EDISON STOCCAGGIO SPA.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë, është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i infrastrukturës së gazit natyror, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë EDISON STOCCAGGIO SPA nga shoqëria SNAM S.P.A.

SNAM S.P.A. nuk është aktiv në tregun përkatës në Shqipëri. SNAM është aktive në menaxhimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror në Itali dhe ka interesa në shoqëri aktive në tregjet e transmetimit, rigazifikimit dhe ruajtjes së gazit edhe në vende të tjera të BE-së. SNAM është transmetuesi kryesor në Itali duke marrë rolin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

EDISON STOCCAGGIO SPA është aktiv ekskluzivisht në Itali, në fushën e magazinimit të gazit natyror dhe zgjidhjet e fleksibilitetit për transportuesit që operojnë në kanal tregtar, duke iu ofruar këtyre të fundit shërbime modulimi për të mbushur kërkesat ditore, sezonale dhe të pikut të konsumit të gazit.

Asnjë nga Palët nuk angazhohet në territorin shqiptar, në asnjë nga aktivitetet e gazit natyror.

Nga sa më sipër, Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë EDISON STOCCAGGIO SPA nga shoqëria SNAM S.P.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1108 , Datë 16. 09. 2024

““MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR REFERIMIN E ÇËSHTJEVE NË LIDHJE ME PËRQENDRIMET””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16. 09. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi miratimin e Udhëzimit “Për referimin e çështjeve në lidhje me përqendrimet”.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft-Udhëzimi “Për referimin e çështjeve në lidhje me përqendrimet”

VËREN SE:

1. Udhëzimi “Për referimin e çështjeve në lidhje me përqendrimet” përafrohet “Njoftimin e Komisionit Evropian për Referimin e Çështjeve në lidhje me përqendrimet (2005/C 56/02)” (“Njoftimi”), i cili ofron një kuadër rregullator për trajtimin e përqendrimeve dhe përfuturit të kontrollit brenda Bashkimit Evropian. Nxjerrë në bazë të Rregullores së Përqendrimeve (Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 139/2004, datë 20 janar 2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve), ky njoftim synon të sigurojë ruajtjen e konkurrencës efektive në tregun e brendshëm. Ai trajton nevojën për një sistem efikas për të rishikuar përqendrimet dhe përfuturit e kontrollit që mund të ndikojnë në konkurrencë, duke theksuar rolin e Komisionit Evropian në parandalimin e pozitës dominuese në treg që mund të dëmtojnë konkurrencën dhe mirëqenien e konsumatorëve.
2. Qëllimi kryesor i Udhëzimit është të qartësojë procedurat dhe kriteret për referimin e

çështjeve në lidhje me përqendrimet ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit Evropian, duke u siguruar që çështjet shqyrtohen nga autoriteti më i përshtatshëm për të thjeshtuar procesin dhe për të shmangur përsëritjen. Për më tepër, ai synon të sigurojë konsistencë në vendimmarrje dhe siguri më të madhe ligjore për ndërmarrjet e përfshira në përqendrime ose përfitim kontrolli duke përshkruar udhëzime dhe procedura të qarta për referimin e çështjeve.

3. Në Udhëzim përfshihen si referimet nga Autoriteti i Konkurrencës te Komisioni Evropian, ashtu dhe referimet nga Komisioni Evropian tek Autoriteti i Konkurrencës. Ai specifikon kriteret dhe kushtet në të cilat mund të referohet një çështje, siç është rëndësia e transaksionit për konkurrencën në tregun e brendshëm ose prania e efekteve ndërkufitare. Kjo siguron që kufijtë e juridiksionit të përcaktohen qartë dhe çështjet t'i caktohen autoritetit të përshtatshëm për mbikëqyrje efektive.
4. Për më tepër, Udhëzimi mbulon aspekte praktike të trajtimit të referimeve, duke përfshirë afatet kohore, protokollet e komunikimit dhe koordinimin ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit Evropian. Duke ofruar një kornizë të qartë dhe efikase për referimin e çështjeve, Udhëzimi përmirëson procesin e kontrollit të përqendrimeve brenda BE-së.
5. Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare ratifikuar me Ligjin Nr. 9590, datë 27 korrik 2006) dhe për arritjen e përafrimit të plotë të kuadrit legjislativ shqiptar të konkurrencës me atë të Bashkimit Evropian, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë përsipër përafrimin e Njoftimit, brenda afateve të parashikuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024-2026.
6. Udhëzimi ofron një kuadër rregullator për trajtimin e përqendrimeve dhe blerjeve brenda Bashkimit Evropian, me qëllim qartësimin e procedurave për referimin e çështjeve ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit Evropian, por nuk është i zbatueshëm në Shqipëri, pasi vendi nuk është ende anëtar i BE-së. Për këtë arsye, Autoriteti i Konkurrencës ka përafuar përmes tij Njoftimin, duke e bërë gati për zbatim në të ardhmen.
7. Udhëzimi do të hyjë në fuqi kur Shqipëria të bëhet një shtet anëtar i BE-së, me kusht që Njoftimi që përafrohet të jetë ende i vlefshëm, duke ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin e tij.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Miratimin e Udhëzimit “Për referimin e çështjeve në lidhje me përqendrimet”.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1109 , Datë 16. 09. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA NGA SHOQËRITË MARCEGAGLIA STEEL S.P.A. DHE MANNI GROUP S.P.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16. 09. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë MARCEGAGLIA STEEL S.P.A. dhe MANNI GROUP S.P.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë MARCEGAGLIA STEEL S.P.A. dhe MANNI GROUP S.P.A.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë MARCEGAGLIA STEEL S.P.A. dhe MANNI GROUP S.P.A.

Referuar dokumenteve të depozituara nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:

Pala 1: MARCEGAGLIA STEEL S.P.A. është një shoqëri aksionare, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë, në pronësi të plotë të Marcegaglia Holding S.r.l, shoqëria mëmë e Marcegaglia Group. Marcegaglia Group është globalisht aktiv në sektorin e prodhimit dhe përpunimit të çelikut, kryesisht në prodhimin e produkteve prej karboni dhe në një masë më të vogël, në prodhimin e produkteve prej çeliku të pandryshkshëm të sheshtë dhe të gjatë dhe prodhimin e fletëve metalike për hekurudha.

Grupi Marcegaglia, nëpërmjet filialeve të saj, Marcegaglia Builtech S.r.l. dhe Marcegaglia Poland Sp.Z.o.O., prodhon dhe tregton: i) barriera të sigurisë rrugore prej çeliku, ii) sisteme skelash për kantieret e ndërtimit, iii) produkte çeliku si dhe iv) panele sanduiç izoluese për çati, mure dhe dyer dhe fletë të valëzuara.

Marcegaglia Builtech S.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë, e cila zotëron një njësi biznesi, me objekt projektimin, prodhimin, montimin dhe tregtimin e paneleve izolues të llojeve të ndryshme dhe për përdorime të ndryshme.

Marcegaglia Poland Sp.Z.o.O. është një shoqëri e regjistruar sipas ligjit polak, e cila zotëron një njësi biznesi, me objekt projektimin, prodhimin, montimin dhe tregtimin e paneleve ekzistues të llojeve të ndryshme dhe për përdorime të ndryshme.

Marcegaglia Group nuk ka filiale, degë apo zyra përfaqësimi në Shqipëri, por ka realizuar xhiro për vitin 2023.

Pala 2: MANNI GROUP S.P.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit italian, e cila kontrollohet drejtpërdrejt nga Gruppo Mani S.r.l., shoqëria holding e Manni Group. Manni Group është aktiv në fushat e biznesit: i) shpërndarjen e produkteve të çelikut inox, të çelikut të karbonit dhe elementeve të tjerë të parapërpunuar dhe sistemeve strukturore për ndërtim; ii) ndërtimit jashtë vendit dhe parafabrikimit të qëndrueshëm dhe iii) inxhinierisë së burimeve të rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë.

Manni Group S.P.A. zotëron: 100% ISOPAN S.P.A., 100% Isopan Spanjë, 99% Isopan Rumani.

MANNI GROUP, nëpërmjet Isopan, prodhon dhe tregton i) panele sanduiç izolues për çati dhe mure (jo për dyer) dhe pak ii) fletë të valëzuara.

Manni Group nuk ka filiale, degë apo zyra përfaqësimi në Shqipëri, por ka realizuar xhiro në Shqipëri për vitin 2023.

ISOPAN S.P.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit italian, me objekt aktiviteti prodhimin e produkteve të tjera minerale jo metalike.

ISOPAN S.P.A. zotëron: 100% Isopan Francë, 100% Isopan Gjermani (Isopan Gjermani zotëron 1% të kapitalit aksionar të *Isopan Republika Çeke*), 99% Isopan Republika Çeke, 50% Manni Store (Manni Sipre S.p.A. dhe Manni Inox S.p.A. mbajnë secila 25% të kapitalit aksionar të Manni Store), 50% të Isopan Meksikë, 1% Isopan Rumani.

Asetet e bizneseve Marcegaglia (ku përfshihen njësitë e Biznesit Marcegaglia Builtech S.r.l. dhe Njësitë e Biznesit Marcegaglia Poland Sp.Z.o.O.) do t'i kontribuohen ISOPAN S.P.A. dhe do të bëhen pjesë e ndërmarrjes së re të përbashkët).

ISOPAN S.P.A. nuk është prezent, por ka realizuar xhiro në Shqipëri.

Ndërmarrja e përbashkët do të operojë në prodhimin dhe tregtimin e paneleve sanduiç dhe prodhimin dhe tregtimin e fletëve të valëzuara. Ndërmarrja e përbashkët do të operojë në një bazë afatgjatë, përmes shitjeve të shoqëritë e palëve të treta. Ajo do të pajiset me të gjitha burimet e nevojshme, duke përfshirë personelin, asetet dhe të gjitha tiparet e nevojshme për të vazhduar aktivitetet e saj aktuale të biznesit mbi një bazë të qëndrueshme.

II. Transaksioni

Më datë 24 korrik 2024, Marcegaglia Builtech S.r.l., Marcegaglia Poland Sp.z.o, Manni Group S.P.A. (Partnerët), ISOPAN S.P.A. (Shoqëria) dhe MARCEGAGLIA STEEL S.P.A. kanë nënshkruar “Marrëveshja e Sipërmarrjes së përbashkët dhe Marrëveshja e Aksionarëve” lidhur me Investimin në ISOPAN S.P.A.

Pas përfundimit të transaksionit, Marcegaglia dhe Manni Group do të zotërojnë secila 50% të kapitalit aksionar të ISOPAN S.P.A.

ISOPAN S.P.A. do të zotërojë aksionet dhe njësitë e biznesit operativ në sektorin e paneleve izoluese që aktualisht i përkasin partnerëve Marcegaglia dhe Manni Group, me përjashtim të Isopan Gjermani.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë, është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe tregimit të (i) paneleve sanduiç me shkumë dhe fibra minerale për çati dhe mure dhe (ii) fletë të valëzuara, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë MARCEGAGLIA STEEL S.P.A. dhe MANNI GROUP S.P.A.

MARCEGAGLIA STEEL S.P.A. është pjesë e Grupit Marcegaglia, aktiv në sektorin e prodhimit dhe përpunimit të çelikut, kryesisht në prodhimin e produkteve të çelikut të karbonit dhe në një masë më të vogël, në prodhimin e produkteve prej çeliku të pandryshkshëm të sheshtë dhe të gjatë dhe prodhimin e fletëve metalike për hekurudha.

Marcegaglia Group dhe Marcegaglia Business Units (Marcegaglia Builtech S.r.l. dhe Marcegaglia Poland Sp.Z.o.O.) nuk kanë prezence juridike në Shqipëri por kanë realizuar të ardhura.

MANNI GROUP, nëpërmjet Isopan, prodhon dhe tregton i) panele sanduiç izolues për çati dhe mure (jo për dyer) dhe pak ii) fletë të valëzuara. MANNI GROUP nuk është prezent, por ka realizuar xhiro në Shqipëri.

Ndërmarrja e përbashkët do të jetë aktive në prodhimin dhe tregtimin e paneleve sanduiç me shkumë dhe fibra mineralë për çati dhe mure dhe, pjesën e mbetur, në prodhimin dhe tregtimin e fletëve të valëzuara.

ISOPAN S.P.A. do të zotërojë aksionet dhe njësitë e biznesit operativ në sektorin e paneleve izoluese që aktualisht i përkasin partnerëve Marcegaglia dhe Manni Group.

Nga sa më sipër, Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë MARCEGAGLIA STEEL S.P.A. dhe MANNI GROUP S.P.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1110 , Datë 20 . 09. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË GERMANI S.P.A. DHE FILIALIT TË SAJ TRASPORTI VECCHI ZIRONI S.R.L. NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A. DHE MEGRANI S.R.L.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20. 09. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë GERMANI S.P.A. dhe filialit të saj TRASPORTI VECCHI ZIRONI S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A. dhe MEGRANI S.R.L.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë GERMANI S.P.A. dhe filialit të saj TRASPORTI VECCHI ZIRONI S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A. dhe MEGRANI S.R.L.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar i përfhtimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë GERMANI S.P.A. dhe filialit të saj TRASPORTI VECCHI ZIRONI S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A. dhe MEGRANI S.R.L.

Referuar dokumenteve të depozituara nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:

Pala blerëse: EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian, e cila për shkak të delegimit të menaxhimit, vepron në emër dhe për llogari të Eurizon Capital SGR S.p.A, si shoqëri administruese e fondit italian të investimeve alternative të rezervuara italiane (AIF) të quajtur “Eurizon Iter” dhe fondit të mbyllur, jo të rezervuar (AIF), të autorizuar nga Banka e Italisë si një Fond Evropian i Investimeve Afatgjatë (Eltif) me emrin “Eurizon Iter Eltif”.

EURIZON CAPITAL REAL ASSET S.G.R S.P.A. është pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo, grup i cili është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA.

INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, objekti i veprimtarisë i së cilës është ofrimi i veprimtarive bankare, veprimtarive financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit.

Pala shitëse: MEGRANI S.R.L. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit italian, me objekt aktiviteti transportin e mallrave për llogari të palëve të treta, si në Itali ashtu edhe jashtë vendit, i çdo lloj mbetjeje urbane, inerte, speciale, toksike dhe të rrezikshme, agjenci dërgimi dhe transporti dhe në përgjithësi çdo veprimtari që lidhet me transportin në rrugë, det, hekurudhë dhe ajër, veprimtari të punishteve mekanike dhe karrocive për riparimin e automjeteve të veta dhe të palëve të treta etj.

MEGRANI S.R.L. është shoqëria holding e Grupit Megrani dhe kontrollohet nga Z. Mauro Ferrari, Arcese Trasporti S.p.A., Z. Daniele Ferrari dhe Fidor S.p.A.

MEGRANI S.R.L. zotëron plotësisht shoqërinë target GERMANI S.P.A.

Grupi Megrani nuk ka filiale, degë ose zyrë përfaqësimi dhe nuk ka realizuar të ardhura në Shqipëri.

Shoqëritë target:

GERMANI S.P.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit italian, aktive në shërbimet e transportit rrugor ekskluzivisht në Itali, kryesisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve (industriale dhe urbane), që përfshijnë i) materiale të asgjësuar që rrjedhin nga pastrimi mjedisor nga ndotja në shkallë të gjerë, infrastruktura dhe punimet e ndërtimit; ii) mbetje të lëngshme, të ngurta (të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) dhe urbane, dhe kategori të tjera, përfshi gazet teknike dhe karburantet.

TRASPORTI VECHI ZIRONI S.R.L. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë, aktiv në sektorin e zgjidhjeve të transportit rrugor, kryesisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve (industriale dhe urbane) dhe kategori të tjera produktesh shumë komplekse dhe ii) transportin intermodal të mbetjeve. TRASPORTI VECHI ZIRONI

S.R.L. kontrollohet nga GERMANI S.P.A., me shumicë kontrolluese.

GERMANI S.P.A. dhe TRASPORTI VECHI ZIRONI S.R.L. (Grupi target) nuk ofrojnë asnjë shërbim dhe nuk gjenerojnë të ardhura në Shqipëri.

II. Transaksioni

Më datë 29 korrik 2024, shoqëritë MEGRANI S.R.L., Arcese Trasporti S.p.A., Z. Marcello Zironi, Z. Gino Braglia (të quajtur në kontratë Riinvestitorët) dhe EURIZON CAPITAL REAL ASSET S.G.R S.P.A. (pala blerëse) kanë nënshkruar “Marrëveshja e Shitblerjes dhe e Riinvestimit”.

Kjo marrëveshje konsiston në blerjen indirekte të të gjitha kapitalit aksionar dhe të të drejtave të votës nga EURIZON CAPITAL REAL ASSET S.G.R S.P.A. në GERMANI S.P.A. dhe filialin e saj TRASPORTI VECHI ZIRONI S.R.L. dhe riinvestimin e njëkohshëm indirekt nga MEGRANI S.R.L. në GERMANI S.P.A. që përfaqëson një interes pakice prej rreth 25% të aksioneve në kapitalin e GERMANI S.P.A.

Draft–Marrëveshja e Aksionarëve do të nënshkruhet në mbyllje, ndërmjet EC Vehicle (Aksioneri Eurizon), MEGRANI S.R.L., Z. Marcello Zironi, Z. Gino Braglia dhe Arcese Trasporti S.p.A. (Aksionarët e Pakicës) dhe me ndërhyrjen e Z. Mauro Ferrari dhe do të rregullojë qeverisjen e Grupit target pas mbylljes së transaksionit.

Në përfundim të transaksionit, shoqëritë target GERMANI S.P.A. dhe TRASPORTI VECHI ZIRONI S.R.L. do të zotërohen përafërsisht 65% nga EURIZON CAPITAL REAL ASSET S.G.R S.P.A., 25% nga MEGRANI S.R.L. dhe rreth 10% nga riinvestitorët minoritarë të tjerë. EURIZON CAPITAL REAL ASSET S.G.R S.P.A. dhe MEGRANI S.R.L. do të kenë kontroll të përbashkët në bazë të së drejtës së vetos, të shoqërive target GERMANI S.P.A. dhe TRASPORTI VECHI ZIRONI S.R.L.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë, është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shërbimit të transportit të mjetëve industriale dhe urbane dhe kategori të tjera, përfshi gazet teknike dhe karburantet, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë GERMANI S.P.A. dhe filialit të saj TRASPORTI VECCHI ZIRONI S.R.L nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET S.G.R S.P.A. dhe MEGRANI S.R.L.

EURIZON CAPITAL REAL ASSET S.G.R S.P.A. operon, me anë të një delegimi menaxhimi, në emër të Eurizon si shoqëri e menaxhimit të fondit italian të investimeve alternative të mbyllura të rezervuara (AIF) dhe e AIF pa rezervë me fond të mbyllur (Eurizon Iter Funds) dhe është një shoqëri nënholding e Divizionit të Menaxhimit të Aseteve të Grupit Intesa Sanpaolo.

Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri përmes shoqërisë INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, aktiv në tregun e shërbimeve bankare.

Grupi Target, shoqëria GERMANI S.P.A. dhe filiali i saj TRASPORTI VECCHI ZIRONI S.R.L., nuk kanë filiale, degë apo përfaqësi në Shqipëri. Grupi Target nuk ka realizuar të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë GERMANI S.P.A. dhe filialit të saj TRASPORTI VECCHI ZIRONI S.R.L nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET S.G.R S.P.A. dhe MEGRANI S.R.L.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1111, Datë 20. 09. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA ECO CLEANING SHPK, NGA ORTAKËT THEMELUES TË SAJ SHOQËRITË ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION SHPK DHE 2T SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20. 09. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota ECO CLEANING SHPK, nga ortakët themelues të saj shoqëritë ALKO-IMPEX General Construction SHPK dhe 2T SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota ECO CLEANING SHPK, nga ortakët themelues të saj shoqëritë ALKO-IMPEX General Construction SHPK dhe 2T SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota ECO CLEANING SHPK, nga ortakët themelues të saj shoqëritë ALKO-IMPEX General Construction SHPK dhe 2T SHPK.

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 1082, datë 06.06.2024 “Mbi fillimin e procedurave të kontrollit

të përqendrimeve për rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët ECO CLEANING SHPK, nga ortakët themelues të saj shoqëritë ALKO-IMPEX General Construction SHPK dhe 2T SHPK”, vendosi: Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët ECO CLEANING SHPK, nga ortakët themelues të saj shoqëria ALKO-IMPEX General Construction SHPK dhe shoqëria 2T SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Pala 1. ALKO-IMPEX General Construction SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Kosovës, me seli në Prishtinë, me aktivitet kryesor: ndërtimi i rrugëve dhe autostradave si dhe veprimtari të tjera.

Shoqëria ALKO-IMPEX General Construction SHPK ka vendosur hapjen e një dege të saj me të njëjtin emër, ALKO-IMPEX General Construction SHPK - Degë e shoqërisë së huaj, me seli në Tiranë dhe me kohëzgjatje të pakufizuar.

ALKO-IMPEX General Construction SHPK - Degë e shoqërisë së huaj është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me formë ligjore si një Degë e shoqërisë së huaj, me objekt aktiviteti: thyerja e gurit dhënia e formës dhe finicioni; ndërtimi i lartë dhe ndërtimi i ulët; ngritja dhe mbulimi i konstruksioneve të kulmeve; ndërtimi i autostradave, rrugëve, aeroporteve dhe objekteve sportive; punime të tjera të specializuara të ndërtimit, vendosja e instalimeve të kanalizimit fekal dhe atmosferik; vendosja e instalimeve elektrike; vendosja e izolatorëve etj. Përfaqësuesit ligjor të shoqërisë së huaj janë Z. Imer Ademi dhe Znj. Fatime Ademi.

Pala 2. 2T SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me ortakë Z.Dritan Troksi (50% të kapitalit) dhe Z.Artan Sako (50% të kapitalit) dhe me objekt aktiviteti në fushën e ndërtimit, projektme, ndërtime civile dhe industriale, ndërtim rruge dhe kanalizime etj. Tregti me shumicë dhe pakicë, import eksport të artikujve të ndryshëm etj. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant, gatimi dhe tregëtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysëm të gatshme, riparimi i pajisjeve motorike dhe motoçikletave, larje dhe pastrim mjetesh motorike. "Leje përdorimi për lëndë plasëse" në funksion të punimeve për ndërtimin e rrugës Qukës – Qaf Plloçë, Segmenti 3, Pogradec, Korçë. Shërbime të ekspertizës dhe profesionale lidhur me pyjet dhe kullotat etj.

Ndërmarrja e Përbashkët - ECO CLEANING SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me Statut të nënshkruar nga dy ortakët ALKO-IMPEX General Construction SHPK dhe 2T SHPK. Shoqëria ka si objekt aktiviteti: shërbim i pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet ndërtimit të impiantit të diferencimit për Qytetin e Kamzës dhe transferimi të Autoritetit Kontraktor.

II. Transaksioni

Më datë 23 maj 2018, Konkensionari shoqëria/bashkim i përkohshëm i shoqërive ALKO-IMPEX

General Construction SHPK - Degë e shoqërisë së huaj dhe 2T SHPK kanë nënshkruar me Autoritetin Kontraktues Bashkia Kamëz, dokumentin “Kontratë për dhënien me koncesion/PPP⁸ të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportimit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane për qytetin e Kamzës”.

Kjo kontratë ka për objekt: shërbim i pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane për Qytetin e Kamzës. Konkensiononi është dhënë për një periudhë 12-vjeçare nga data efektive e kësaj kontrate.

Referuar kësaj kontrate koncesionari dhe shoqëria e re e krijuar do të jenë solidarisht përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë kontratë. Forma e shoqërisë do të jetë “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “shoqëri aksionere”, në funksionim të ligjit “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”. Shoqëria do të themelohet nga vetë Konkensionari.

Më datë 30 maj 2018, shoqëritë ALKO-IMPEX General Construction SHPK dhe 2T SHPK kanë nënshkruar “Kontratë për hartimin e aktit të themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ECO CLEANING SHPK”.

Referuar kësaj kontrate, shoqëritë ALKO-IMPEX General Construction SHPK dhe 2T SHPK kanë vendosur të emërtojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar ECO CLEANING SHPK, me objekt aktiviteti: *shërbim i pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet ndërtimit të impiantit të diferencimit për Qytetin e Kamzës dhe transferimi të Autoritetit Kontraktor*. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje prej 12 vjetësh. Kapitali themeltar i shoqërisë është i ndarë në 2(dy) kuota dhe çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë: tregu përkatës i produktit, dhe tregu përkatës gjeografik.

Referuar objektit të aktivitetit të shoqërisë së përbashkët, gjykojmë se treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet ndërtimit të impiantit të diferencimit për qytetin e Kamzës.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Bashkisë Kamëz.

Me nënshkrimin e kontratës për dhënien me koncesion të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane për qytetin e Kamzës, shoqëria ECO CLEANING

⁸ “Ligji për koncesionet dhe partneritetin publik privat”

SHPK ka fituar një të drejtë ekskluzive për një periudhë 12 vjeçarë dhe është ofruesi i vetëm i këtij shërbimi në qytetin e Kamzes.

Përzgjedhja e shoqërisë koncesionarë është realizuar në zbatim të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, e cila duhet të ketë kaluar nëpër procedurë konkurruese. Kontrata parashikon tarifat e shërbimeve dhe mbikqyrjen e cilësisë së shërbimit nga Njesia e Zbatimit të Projektit.

Bashkia e Kamzës ka rreth 90 mijë banorë dhe renditet në bashkitë e vogla të vendit.

Referuar aktivitetit të shoqërive të tjera të kontrolluara nga shoqëritë 2T SHPK dhe ALKO-IMPEX General Construction SHPK, konstatohet se asnjë prej tyre nuk ushtron aktivitet në të njëjtin treg përkatës dhe për këto arsye transaksioni i krijimi të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota ECO-CLEANING SHPK, nga shoqëritë 2T SHPK dhe ALKO-IMPEX General Construction SHPK, nuk do të krijojë mbivendosje tregu dhe nuk do të ndryshojë pjesën e tregut të ndërmarrjes ECO-CLEANING SHPK në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota ECO CLEANING SHPK, nga ortakët themelues të saj shoqëritë ALKO-IMPEX General Construction SHPK dhe 2T SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr.1112, Datë 20. 09. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË NSOLUTION SHPK NGA Z. ERMAL BEQIRI”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20. 09. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë NSolution SHPK nga Z. Ermal Beqiri.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë NSolution SHPK nga Z. Ermal Beqiri,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë NSolution SHPK nga Z. Ermal Beqiri.

Referuar dokumentit “Kontratë shit-blerje e kuotave të kapitalit të shoqërisë ITirana SHPK” të nënshkruar më datë 05 prill 2024, palët në marrëveshje janë:

Pala Blerëse: Z. Ermal Beqiri, shtetas shqiptar.

Në nenin 10 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” është parashikuar se një përqendrim ndodh kur kemi një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit. Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, në paragrafin 9 citohet se: *Kontrolli mund të përftohet nga një person në rrethanat ku ky person tashmë kontrollon (ose veçmas ose bashkërisht) të paktën një ndërmarrje tjetër ose ndryshe, nga një kombinim i personave (të cilët kontrollojnë një ndërmarrje tjetër) dhe ndërmarrjeve.*

Referuar Formularit të thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit, Z. Ermal Beqiri zotëron 100% të shoqërive SOFT & SOLUTION SHPK; R&D Solution SHPK; IMO Solution SHPK; AL SOFT SHPK (shoqëria është në likuidim e sipër); 5 min.al SHPK (shoqëria është me status “Pezulluar”), si dhe 50% të shoqërive AL-FORENSIC SHPK (shoqëria është me status “Pezulluar”); ALB-RED STONE SHPK (shoqëria është me “Urdhër për sekastro konservative”).

Për këto arsye, ky transaksion bëhet objekt kontrolli nga Autoriteti i Konkurrencës.

SOFT & SOLUTION SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve dhe programeve në fushën e teknologjisë së informacionit; projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e telekomunikacionit si rrjete WAN/LAN, sisteme sigurie web-site, etj.; shërbim akses interneti; shërbime konsulence dhe trajnime profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit; shërbime të dizenjimit, printimit, publikimit, botimit dhe prodhime të ndryshme të shtypshkrimit, etj.

IMO SOLUTION SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë duke u fokusuar kryesisht në ndërmjetësimin për shitje-blerje, dhënie dhe administrim të qirave të pronave të paluajtshme.

R & D Solution SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Identifikimi dhe shqyrtimi i nevojave të tregut; kërkim shkencor dhe teknologjik; zhvillim i produkteve dhe shërbimeve; testim dhe vlerësimi i produkteve; inovacion dhe kreativitet; bashkëpunim shkencor dhe akademik; menaxhimi i risive intelektuale; përmirësimi i proceseve dhe efikasitetit; monitorimi i zhvillimeve në treg dhe kontributi në njohurinë shkencore dhe teknologjike.

Shoqëria është e krijuar rishtazi dhe mendon të zhvillojë idetë inovative në gjetjen e zgjidhjeve nëpërmjet teknologjisë së informacionit.

Pala Shitëse:

Z. Volker Valentin Koch, shtetas i huaj, i cili zotëronte 1 kuotë që përfaqëson X% të kapitalit themeltar të shoqërisë target.

Z. Jochen Mosthaf, shtetas i huaj, i cili zotëronte 1 kuotë që përfaqëson X% të kapitalit themeltar

të shoqërisë target.

Z. Arben Qarkaxhija, shtetas i huaj, i cili zotëronte 1 kuotë që përfaqëson X% të kapitalit themeltar të shoqërisë target.

Shoqëria Target: NSolution SHPK⁹ është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Shërbime në fushën e telekomunikacioneve, rrjeteve kompjuterike, internetit, sistemeve audio e video, programeve kompjuterike. Shërbime specifike të shpërndarjes kabllore e valore të shërbimeve të përcaktuara në pikën a) si dhe kanaleve televizive. Projektim, vlerësim, konsulencë, monitorim të sistemeve teknologjike të telekomunikacionit dhe informatike. Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, pajisje për klinika mjekësore, pajisje elektronike, elektrike, informatike, elektroshtëpiake, pajisje ventilimi dhe kondicionimi.

Para transaksionit, shoqëria zotërohej nga tre ortakët e saj, Z. Volker Valentin Koch, Z. Jochen Mosthaf dhe Z. Arben Qarkaxhija, sipas kuotave respektive të përmendura më sipër.

II. Transaksioni

Më datë 05 prill 2024, është nënshkruar “Kontratë shit-blerje e kuotave të kapitalit të shoqërisë ITirana SHPK”, ndërmjet Z. Ermal Beqiri në cilësinë e blerësit dhe Z. Volker Valentin Koch, Z. Jochen Mosthaf dhe Z. Arben Qarkaxhija në cilësinë e shitësve.

Referuar Nenit II, “Transferimi i Kuotave dhe Çmimi i blerjes”, në bazë të afateve dhe kushteve të shprehura në këtë akt, përfshirë edhe shtojcat, shitësit kanë rënë dakord të shesin, transferojnë dhe të japin kuotat dhe blerësi ka rënë dakord të blejë kuotat nga shitësit.

Bazuar në kontratën për shitblerjen e kuotave, Z. Ermal Beqiri është zotërues i vetëm i kuotave të shoqërisë target NSolution SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Shoqëria NSolution SHPK ushtron aktivitetet në: shërbime në fushën e telekomunikacioneve, rrjeteve kompjuterike, internetit, sistemeve audio e video, programeve kompjuterike. Shërbime specifike të shpërndarjes kabllore e valore të shërbimeve të përcaktuara në pikën a) si dhe kanaleve televizive; projektim, vlerësim, konsulencë, monitorim të sistemeve teknologjike të telekomunikacionit dhe informatike; import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, pajisje për klinika mjekësore, pajisje elektronike, elektrike, informatike, elektroshtëpiake, pajisje ventilimi dhe kondicionimi.

⁹ Me vendimin nr. 3, datë 17.04.2024 “Për ndryshimin e emrit”, Ortaku i vetëm i shoqërisë NSolution SHPK, ka miratuar propozimin për ndryshimin e emrit të shoqërisë ITirana SHPK në emrin NSolution SHPK.

Shërbimet e komunikimeve elektronike përfshijnë:

- Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje të rrjeteve WAN/LAN dhe sistemeve të sigurisë: këto shërbime ofrojnë zgjidhje të ngjashme teknike.
- Shërbime të aksesit në internet: këto shërbime përfshijnë ofrimin e aksesit në internet dhe hostimin e faqeve të aplikacioneve.
- Shërbime specifike të shpërndarjes kabllore e valore dhe kanaleve televizive: konsumatorët mund t'i shohin këto shërbime si të zëvendësueshme për shkak të ngjashmërisë në ofrimin e përmbajtjes dhe shërbimeve.

Shoqëria NSolution SHPK është e licencuar nga AKEP (licencë nr. 2012-APU99-8-17 24.04.2012, për përdorim: A. Rrjete publike të komunikimeve elektronike nëpërmjet rrjeteve publike tokësore fikse dhe B. Shërbime publike të komunikimeve elektronike, për shërbimet e aksesit në internet dhe transmetim te dhënash.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i komunikimeve elektronike në rrjetet fikse. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Sipas raportit vjetor të AKEP¹⁰ për vitin 2023, konstatohet se në telefoninë fikse kanë ushtruar aktivitet rreth 24 operatorë. Operatorët me pjesën më të madhe të tregut fiks kanë qenë: One Albania, e cila zotëron rreth X% pjesë tregu; Vodafone Albania me X% pjesë tregu; ASC me X% pjesë tregu; Abissnet me rreth X% pjesë tregu; Digicom me rreth X% pjesë tregu; Nisatel me X% pjesë tregu; OA (operatorë të tjerë) me X% të tregut.

Në tregun e ofrimit të shërbimeve broadband nga rrjetet fikse ushtrojnë aktivitet 186 operatorë, por vetëm disa nga subjektet kanë shtrirje të gjerë në disa qarqe të vendit. Pjesa më e madhe e tyre konkurrojnë në segmente më të vogla gjeografike, kryesisht janë ofrues lokalë.

Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa të integruara të shërbimeve të aksesit në internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV) janë vlerësuar si shërbime plotësuese (paketë) me qëllim rritjen e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse.

Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV) në fund të vitit 2023 arriti në rreth 295 mijë.

Rreth X% e pajtimtarëve me paketa të integruara kanë akses broadband në rrjete fikse, ndërsa X% e pajtimtarëve me paketa të integruara janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

Sipas të dhënave të AKEP, të ardhurat nga komunikimet elektronike të raportuara nga ofruesit e shërbimeve nga rrjetet fikse për vitin 2023 tejkaluan vlerën prej X miliardë lekë. Më shumë se

¹⁰Burimi: AKEP, https://akep.al/wp-content/uploads/2024/06/R2023_Treguesit-Statistikore-te-Tregut-teKomunikimeve-Elektronike-DTMRr_-003.pdf

X% e të ardhurave të këtij tregu gjenerohen nga 8 operatorë kryesorë, konkretisht: One Albania SHA (X%); Vodafone SHA (X%); ASC (X%); Digicom (X%); Abissnet (X%); Nisatel dhe ATU me nga (X%); FBD (X%); ndërsa operatorët e tjerë (OA) rreth X% të të ardhurave të këtij tregu.

Referuar të dhënave të AKEP, si dhe pasqyrave financiare të shoqërisë NSolution SHPK, konstatohet se xhiroja nga aktiviteti i saj për vitin 2023 përbën X% të të ardhurave të realizuara në tregun e komunikimeve fikse.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë NSolution SHPK nga Z. Ermal Beqiri, i cili zotëron 100% të shoqërisë SOFT & SOLUTION SHPK, një shoqëri me objekt veprimtarie: zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve dhe programeve në fushën e teknologjisë së informacionit; projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e telekomunikacionit si rrjete WAN/LAN, sisteme sigurie web-site, etj.; shërbim akses interneti; shërbime konsulence dhe trajnime profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit; shërbime të dizenjimit, printimit, publikimit, botimit dhe prodhime të ndryshme të shtypshkrimit, etj.

Shoqëria SOFT & SOLUTION SHPK është e pajisur me licencën për ushtrimin e aktivitetit në fushën e trajnimeve profesionale, si dhe është pajisur me licencë Nr. 51, datë 26.11.2021 nga Banka e Shqipërisë si institucion i parasë elektronike, por nuk ka filluar aktivitet në këtë shërbim.

Shërbimet e ofruara nga shoqëria në tregun e teknologjisë së informacionit përfshijnë:

- Integrimin e sistemeve të informacionit për shoqëri dhe individë nëpërmjet produkteve hardware dhe software. Produktet hardware dhe shërbimet software janë plotësues për shkak të karakteristikave dhe qëllimit të përdorimit.
- Regjistrimi dhe administrimi i emrave dhe domain-eve nën .AL dhe domain-eve të tjera specifike: krijimi, regjistrimi dhe administrimi i emrave dhe domain përbën një shërbim programimi dhe mirëmbajtje.
- Programim dhe zhvillim të aplikacioneve web-based: Këto shërbime përfshijnë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e aplikacioneve web.
- Konsulencë dhe mirëmbajtje të shoqëruara me kurse dhe trajnime profesionale: Ofrohen shërbime konsulence dhe trajnime në fusha të ndryshme, përfshirë teknologjinë e informacionit dhe telekomunikacionin.
- Projektim, vlerësim, konsulencë dhe monitorim të sistemeve teknologjike të telekomunikacionit dhe informatike: Këto shërbime përfshijnë vlerësimin dhe monitorimin e sistemeve teknologjike.
- Import-eksport dhe tregtim të mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, pajisje për klinika mjekësore, pajisje elektronike, elektrike, informatike dhe elektroshtepiake.

Referuar të dhënave të depozituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezulton se **prodhimi i programeve kompjuterike** përfshin: aktivitete të programimit informatik, aktivitete të menaxhimit të instalimeve informatike dhe shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit, ku

përfshihet një numër shumë i madh ndërmarrjesh dhe secila prej tyre zë një pjesë shumë të vogël tregu.

Shoqëria SOFT & SOLUTION SHPK ka realizuar të ardhura në tregun e prodhimit të programeve informatike dhe zotëron përkatësisht X% të tregut për vitin 2022 dhe X% për vitin 2023.

Nga analiza e mësipërme rezulton se shoqëria NSolution SHPK ka ushtruar aktivitet në tregun e komunikimeve elektronike nëpërmjet rrjeteve fikse dhe kryesisht në shërbimin e aksesit në internet dhe transmetim të dhënash, ndërkohë që shoqëria SOFT & SOLUTION SHPK ka ushtruar aktivitet në sektorin e teknologjisë së informacionit, kryesisht në prodhimin e programeve informatike.

Shoqëritë në transaksion nuk krijojnë marrëdhënie horizontale apo vertikale mes tyre, pasi ushtrojnë aktivitet në tregje të ndryshme. Për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

3. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë NSolution SHPK nga Z. Ermal Beqiri.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS

2024

BULETINI ZYRTAR



2024